



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 48 Akti

Nr. 161 Vendimi

Tiranë, më 18.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici

Kryesues

Brunilda Bekteshi

Relatore

Lulzim Hamitaj

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në Tiranë, në datën 13 qershor 2019, ora 12:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

“**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në datën 6.6.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues për të cilin, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në datën 26.3.2019 trupi gjykues me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Selita, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit.
6. Në datën 27.3.2019 trupi gjykues u njoh me informacionin “*sekret*” për kriterin e figurës, të ardhur nga DSIK-ja dhe, me vendimin nr. 3, vendosi: (i) rihapjen e hetimit administrativ për kriterin e figurës; (ii) t’i njoftojë subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ kryesisht për të dyja kriteret e tjera: atë të pasurisë dhe të aftësive profesionale.
7. Në datën 28.3.2019, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht, për të dyja kriteret, kriterin e pasurisë dhe kriterin profesional; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, me një afat 20 ditë nga data e njoftimit, (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
8. Në datën 2.5.2019, Komisioni, me vendimin nr. 4, pas vlerësimit të shpjegimeve të dërguara nga subjekti në datën 16.4.2019, vendosi rihapjen e hetimit administrativ duke vijuar me hetime të mëtejshme shtesë për kriterin e pasurisë dhe të aftësive profesionale.
9. Në datën 24.5.2019, Komisioni, me anë të vendimit nr. 5, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Selita, bazuar te rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) njoftoi subjektin e rivlerësimit për: rezultatet shtesë të hetimit pas rihapjes së hetimit për kriterin e pasurisë, të aftësive profesionale dhe atë të figurës; kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të

kundërtën, me një afat prej 7 ditësh nga data njoftimit; për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Në datën 10.6.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni në datën 3.6.2019;
11. Në datën 11.6.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 6 vendosi të ftoj në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Selita, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 13.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
12. Në datën 13.6.2019 u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Selita, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar dhe shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për këtë subjekt rivlerësimi. Trupi gjykues e ndërpreu seancën dëgjimore të datës 13.6.2019, për të rifilluar në datën 18.6.2019 për të shpallur vendimin.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT / HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në "Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, "Vetting"; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin për kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) opinionet e paraqitura nga ONM-ja në Komision, në bazë të nenit B, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; (dh) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra përmes komunikimit elektronik; (e) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (***) me shkresën nr. (***) prot., datë 14.11.2017, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për

subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur, për vlerësimin e pasurisë së subjektit, sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹ rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, datë 27.1.2017. Ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, rezulton se subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, referuar nenit 32/5², të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit z. Kastriot Selita, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi (***)

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur për çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse për të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ sa i përket vlerësimit të pasurisë konsistoi: në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 27.1.2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016

1. Apartament banimi me sip. 124.91 m², me adresë: Rr. “D. H.”, pallati “A.”, k. (***), ap. (***); pasuria nr. (***), z.k. (***), vol. (***), f. (***), sipas kontratës së shitblerjes nr. (***), me kusht kreditimi, datë 15.12.2015; me vlerë 177.370 euro; mobilimi në vlerën 21.354 euro. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i deklaruar i krijimit: vlera 85.000 euro kredi bankare për 25 vjet marrë në “Bankën Kombëtare Tregtare”, përmes kontratës nr. (***), datë 24.12.2015, ku subjekti i rivlerësimit zotëron 50 %; vlera 3.724 euro nga të ardhurat familjare të realizuara gjatë vitit 2015, ku subjekti zotëron 50 %; vlera 110.000 euro të ardhura të bashkëshortes të realizuara nga shitja e apartamentit me sip. 94.6 m², me adresë: Rr. “R. P.”, pallati “U.”, k. (***), ap. (***), Tiranë.

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë në ILDKPKI.

² Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

Pasuria nr. (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) , sipas kontratës nr. (***) , datë 21.10.2015 (pasuri e krijuar para martese, subjekti zotëron 0 %). Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”. Për këtë subjekti ka sqaruar se: Apartamenti me sip. 94.6 m² është blerë për vlerën 61.758 euro, sipas kontratës së shitjes nr. (***) , datë 12.12.2008, nga të ardhurat e bashkëshortes, nga prindërit e saj, pas shitjes së një shtëpie private 2 kat + papafingo më sip. 268.2 m² + truall, me sip. 330 m². Pasuria nr. (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) , Tiranë, shitur për shumën 220.000 euro, sipas kontratës nr. (***) , datë 9.6.2008, me adresë: Rr. “M. K.”, pranë (***) , Q., L., Tiranë.

Për këtë aset, me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti ka paraqitur dokumentet:

- kontratë kredie nr. (***) , datë 24.12.2015 me “BKT”-në (kredi në shumën 85.000 euro);
- kontratë hipotekimi nr. (***) , datë 24.12.2015, i apartamentit me sip. 124.91 m², në favor të “BKT”-së.

Faktet që rezultojnë nga hetimi administrativ

Në deklaratën “Vetting” deklarohet apartament banimi me sip.124.91 m², me vlerë 177.370 euro dhe mobilimi në vlerën 21.354 euro, sipas të dhënave të detajuara në pikën 1, me tri burime krijimi: vlera 85.000 euro kredi bankare marrë në “BKT”; vlera 3.724 euro të ardhurat familjare të realizuara gjatë vitit 2015; vlera 110.000 euro të ardhura të bashkëshortes të realizuara nga shitja e një apartamenti në vitin 2015 (*kjo e fundit pasuri e krijuar para martese, subjekti zotëron 0 %*).

1.1 Burimi i krijimit kredi bankare, marrë në “BKT” në shumën 85.000 euro

1.1.2 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2015 subjekti ka deklaruar si detyrim ndaj “BKT”-së kredinë në shumën 85.000 euro, sipas kontratës nr. (***) , datë 24.12.2015.

1.1.3 Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme me kusht kreditimi me nr. (***) , të datës 15.12.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, kanë blerë apartament me sip. 124.91 m², me nr. pasurie (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) ; vlera e blerjes: 177.370 euro. Në këtë kontratë parashikohej se likuidimi do të bëhej në këtë mënyrë: shuma 92.370 euro do të likuidohej përmes “BKT”-së brenda një jave dhe shuma prej 85.000 eurosh do të likuidohej me kredinë e marrë.

1.1.4 Me nënshkrimin e kontratës së kredisë nr. (***) , datë 24.12.2015, me “BKT”-në, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë përfituar kredi në shumën 85.000 euro; afati i kredisë: 300 muaj; qëllimi i përdorimit: blerje apartamenti sipas kontratës nr. (***) , datë 15.12.2015.

1.1.5 Kredia e mësipërme rezulton se është garantuar me kontratën hipotekore nr. (***) , datë 24.12.2015, me hipotekues: znj. M. K. dhe z. Kastriot Selita, në favor të “BKT”-së, për pasurinë: apartament banimi me sip. 124.91m², pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) .

1.1.6 Nga verifikimi i llogarisë bankare në “BKT” rezultoi se shuma prej 85.000 eurosh ishte disbursuar me ref. (***) në datën 30.12.2015 në llogarinë e personit të lidhur, si dhe ishte përdorur për likuidimin e një pjese të çmimit të apartamentit, provuar me transfertën ref. (***) , datë 30.12.2015, të shumës 85.000 euro nga llogaria në “BKT” të personit të lidhur të subjektit, tek llogaria e noterit publik me përshkrimin: “Sipas kontratës së shitjes nr. (***) , datë 15.12.2015 dhe kontratës së kredisë nr. (***) , datë 24.12.2015”.

1.1.7 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të të ardhurave, administroi dokumentacion si më poshtë:

- Shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2018, si dhe shkresën nr. (***) prot., datë 22.2.2018 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, përmes së cilave Komisioni u informua për transaksionet e personit të lidhur për pasurinë: apartament me sip. 94.6 m², nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***).

- Shkresën nr. (***) prot., datë 16.2.2018 të “BKT”-së, me të cilën Komisioni u informua për nënshkrimin e kontratës së kredisë nr. (***), datë 24.12.2015, me kredimarrës: znj. M. K. dhe z. Kastriot Selita; nënshkrimin e kontratës së hipotekës nr. (***), datë 24.12.2015, me hipotekues: znj. M. K. dhe z. K. K., në favor të “BKT”-së Tregtare”, transfertën ref. (***), datë 15.12.2015, të shumës prej 92.370 eurosh nga personi i lidhur i subjektit, nga llogaria e saj në “BKT” te llogaria e noterit publik; disbursimin e shumës prej 85.000 eurosh në llogarinë e personit të lidhur transfertën e personit të lidhur, ref. (***), datë 30.12.2015, nga llogaria e saj në këtë bankë te llogaria e noterit publik të shumës 85.000 euro, me përshkrimin: “Sipas kontratës së shitjes nr. (***), datë 15.12.2015 dhe kontratës së kredisë nr. (***), datë 24.12.2015³”.

1.1.8 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në rezultatet e hetimit për këtë pasuri, duke pasur parasysh faktet e dala dhe provat lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 85.000 eurosh kredi bankare e marrë në “BKT”, konkludoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe, për rrjedhojë, çmon se deklarimi i tij është i saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

1.2 Burimi i krijimit i shumës 3.724 euro, të ardhura në vitin 2015, përdorur për blerjen e apartamentit me vlerë 177.370 euro dhe mobilim me vlerë 21.354 euro në vitin 2016

1.2.1 Për të vërtetuar burimin e tyre, subjekti në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, në ILDKPKI, ka dorëzuar këto dokumente:

- Shkresën nr. (***) prot., datë 18.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës – vërtetim page për periudhën tetor 2001 – tetor 2002, sipas së cilës subjekti ka përfituar pagën në shumën 3.869.097 lekë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 6.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për dërgim të të dhënave në lidhje me pagesën për periudhën nëntor 2002 – mars 2010, sipas së cilës subjekti ka përfituar pagën në shumën 13.174.981 lekë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 26.1.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit – vërtetim page për periudhën 2013 – 2017, sipas së cilës subjekti ka përfituar të ardhura në periudhën 4.11.2013 – 10.1.2017, në shumën 4.960.873 lekë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 4.3.2016, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor – vërtetim page e vitit 2015, sipas së cilës subjekti ka përfituar të ardhura në periudhën 2015, në shumën 21.391 lekë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 18.1.2017, e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor – vërtetim page e vitit 2016, sipas së cilës subjekti ka përfituar të ardhura në periudhën 2016, në shumën 42.782 lekë.

³ Shihni në shkresën nr. (***)prot., datë 12.2.2018, si dhe me shkresën nr. (***)prot., datë 22.2.2018 të ZVRPP-së Tiranë; materialet shoqëruese: kontratë shitblerjeje nr. (***), datë 15.12.2015, mes palës blerëse M. K. dhe Kastriot Selita dhe palës shitëse S. C. dhe F. C. .

Shihni në shkresën nr. (***) prot., datë 16.2.2018, të “BKT”-së, materiali shoqërues në shkresë dhe CD – llogaria ne euro, transfertat me ref. (***), datë 15.12.2015, me ref. (***), datë 30.12.2015 dhe me ref. (***), datë 30.12.2015; kontratën e kredisë nr. (***), datë 24.12.2015 dhe kontratën e hipotekës nr. (***), datë 24.12.2015.

- Shkresën nr. (***) prot., datë 20.1.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve – vërtetim page për periudhën 2006 – 2017, sipas së cilës personi i lidhur ka përfituar të ardhura nga paga në periudhën 1.4.2006 – 1.1.2017, në shumën 5.131.892 lekë dhe të ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për raport lindjeje në shumën 201.773 lekë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 25.1.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë – konfirmim *pagesa tatim burimi* për periudhën 2012 – 2015, sipas së cilës personi i lidhur i subjektit ka paguar shumën prej 379.773 lekësh në zërin: *Tatim në burim për kontrata qiraje*, dhe shumën prej 10.602 lekësh në zërin: *Tatim për të ardhurat individuale*.⁴
- Faturën tatimore të blerjes së mobilimit të apartamentit, vërtetuar me origjinalin nr. (***) rep., datë 26.1.2017, në vlerën 659.188 lekë dhe 16.542 euro.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

1.2.2 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar burimin e shumës prej 3.724 eurosh si vlerë e përdorur për blerjen e apartamentit me vlerë 177.370 euro në vitin 2015, si dhe shpenzime për mobilimin e tij në vlerën 21.354 euro në vitin 2016.

1.2.3 Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime të ndryshme gjatë muajit dhjetor 2015 për arrendimin dhe mobilimin e apartamentit të blerë (*sipas faturave tatimore që vërtetojnë artikujt shtëpiakë të blerë në këtë vit*), të likuiduara nëpërmjet bankës në shumën 16.542 euro dhe 659.188 lekë.

1.2.4 Sipas llogaritjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2015 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar gjithsej shumën prej 3.042.675 lekësh nga paga (sipas deklarimeve periodike); shumën prej 5.958 eurosh nga qiratë e dy pasurive (*apartamenti në pallatin “U.”, Tiranë, dhe apartamenti në kompleksin “L.” në I. të Durrësit*) – nga të cilat, pas zbritjes së shpenzimeve jetike, si dhe shpenzimeve të deklaruara për blerjet e këtij viti në deklaratën periodike të vitit 2015, rezultoi të kishin krijuar gjendje kursimi *cash* në shumën prej 320.000 lekësh dhe 2.160 eurosh.

1.2.5 Në deklaratën periodike të vitit 2016 subjekti ka deklaruar të ardhurat dhe shpenzimet e këtij viti duke pasqyruar transaksionet e kryera në këtë vit deklarimi, si: shumën prej 130.000 eurosh që personi i lidhur kishte fituar përpara martese nga shitja e apartamentit shtetasit E. A. R.; kalimin i një pjese të kësaj shume babait të bashkëshortes për blerjen e një apartamenti; shpenzime udhëtimi dhe shkollimi, fakte që u konfirmuan nga shkresat e ZVRPP-së Tiranë dhe nga përgjigjet e të gjitha bankave të nivelit të dytë.

1.2.6 Transaksioni i mësipërm, sikurse edhe lëvizjet me shuma për 1,5 milionë lekësh, evidentohen edhe nga informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

1.2.7 Sipas llogaritjeve të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2016 rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar gjithsej: 2.526.415 lekë nga paga (sipas deklarimeve), 130.000 euro nga shitja e pasurisë (apartamenti me sip. 126 m² në pallatin “U.”, Tiranë), nga të cilat, pas zbritjes së likuidimit të kredisë, të shpenzimeve jetike, si dhe shpenzimeve të deklaruara në deklaratën periodike për kontributet ndaj familjarëve dhe blerjet e këtij viti (2016), kanë krijuar gjendje kursimi *cash* në shumën 360.000 lekë.

1.2.8 Komisioni kreu analizën financiare në raport me të ardhurat, në kuadër të verifikimit të aftësive financiare për të blerë pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, bazuar në

⁴ Më hollësisht Shihni në shkresën e ILDKPKI-së nr. extra prot., datë 27.1.2017, “Inventar i dokumentacionit justifikues/shoqëruar të deklaratës së pasurisë së subjektit”, pjesë e akteve të dosjes me nr. indeksi (***)

dokumentacionin zyrtar të ardhur nga institucionet përkatëse për vitin 2015 dhe vitin 2016, pasqyruar në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1

	ANALIZA FINANCIARE	2015	2016
Nr.	Pasuritë	25,439,175	9,235,083
1	Shtesa/pakësime të likuiditeteve	1,024,194	-233,817
2	Apartament me sip. 124.91 m ² , nr. (***), datë 15.12.2015	24,414,981	0
3	Apartament me sip. 29.86 m ² , Rr. “D. H.”, p. “A.”, k. (***), Tiranë	0	6,222,420
4	Garazh, Rr. “D.H.”, p. “A.”, k. (***), Tiranë	0	3,246,480
	Të ardhurat	18,716,725	20,193,668
1	Paga	1,367,835	1,696,638
2	Paga e bashkëshortes	1,242,463	911,930
3	Dhënia me qira e apartamentit me sip. 126 m ²	495,540	0
4	Dhënia me qira e apartamentit, Komuna I.	469,387	0
5	Vlera nga shitja e apartamentit të bashkëshortes para martesë nr. (***), datë 21.10.2015	15,141,500	0
6	Vlera nga shitja e apartamentit në pronësi të bashkëshortes me sip. 115.08 m ²	0	17,585,100
	Detyrimet	11,542,156	-4,455,388
1	Kredi bankare në “BKT”	11,700,250	-4,455,388
2	Shlyerje këste kredie	-158,094	0
	Shpenzime	4,307,622	4,225,530
1	Arredimi i apartamentit të blerë	2,936,194	0
2	Kontribut për prindërit e bashkëshortes	0	2,705,400
3	Interesa për këstet e kredisë	36,547	324,919
4	Paguar tatim qiraje	144,808	0
5	Për arsimin parashkollor për djalit, B. S.	0	104,808
6	Për vajzën, në spitalit “H.”	316,595	33,818
7	Për arsimin e djalit, B. S., në kolegjin “T. O.”	0	364,553
8	Udhëtime jashtë shtetit	323,478	142,034
9	Shpenzime jetike	550,000	550,000
	Rezultati financiar	512,084	2,277,667

1.2.9 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të të ardhurave, administroi këtë dokumentacion marrë nga institucione publike e private:

- Shkresën nr. (***) prot., datë 30.1.2018, drejtuar të gjitha bankare të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera financiare.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 16.2.2018, të “BKT”-së, duke e shoqëruar përgjigjen me materialet e regjistruara në CD.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 2.2.2018, të “Intesa Sanpaolo Bank”, që vërteton pagesën e shumës 130.000 euro nga noteri publik.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 7.8.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Shkresat për të ardhurat e subjektit.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 4.3.2016, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda për të ardhurat e subjektit (bordi drejtues ZABGJ-së);
- Shkresën nr. (***) prot., datë 26.1.2017 të Gjykatës së Apelit.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 20.1.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të ardhurat e bashkëshortes.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjyqësor, në rezultatet e hetimit për burimin e krijimit të shumave 3.724 euro për blerjen e apartamentit dhe 21.354 euro për mobilim, duke pasur parasysh faktet e dala të arsyetuara sa më sipër, si dhe provat dhe analizën financiare të kryer, konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të mjaftueshme për të blerë pasuritë, si dhe për të kryer shpenzimet e deklaruara.

1.3 Burimi i krijimit i shumës 110.000 euro

1.3.1 Për të vërtetuar burimin e tyre, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Kontratë kapari për dorëzim parash me nr. (***), datë 27.5.2008, për shlyerjen e shumës prej 20.000 eurosh. Palë shitëse A. K. .
- Kontratë shitblerjeje me rezervë pronësie (me kusht) të pasurisë së paluajtshme (truall dhe ndërtesë), nr. (***), datë 9.6.2008; palë shitëse A. K., me pëlqimin e bashkëshortes H. K. dhe dy fëmijëve, M. K. dhe F. K. .
- Deklaratë noteriale nr. (***), datë 23.7.2008, midis palëve për shlyerjen përfundimtare të vlerës së shitjes prej 200.000 eurosh.
- Kontratë shitjeje me nr. (***), datë 2.12.2008, për apartament banimi, ndodhur në Rr. “R. P.”, kompleksi “U.”, seksioni (***) , nr. (***) , k. (***) , Tiranë, pasuria (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) , me sip. 94,6 m² (ap) + 11,88 m² (shkalla) = 106,48 m² (sip. totale), në shumën 61.758 euro. Palë shitëse shoqëria “U.” sh.p.k. dhe palë blerëse M. K. .
- Kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 21.10.2015, (për pasurinë e mësipërme) me palë shitëse M. K. dhe palë blerëse Sh. K. . Vlera e shitjes: 110.000 euro.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

1.3.2 Në deklaratën “Vetting” deklarohet duke sqaruar se si burim krijimi për blerjen e apartamentit të banimit me sip. 124.91 m² me vlerë 177.370 euro, kishin shërbyer edhe të ardhurat e bashkëshortes, shuma prej 110.000 eurosh, e përftuar nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. (***) , datë 21.10.2015 (pasuri e krijuar para martesë, subjekti zotëron 0 %).

1.3.3 Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me shumën prej 110.000 eurosh ka synuar saktësinë e deklaramit në deklaratën “Vetting” dhe të deklarimeve periodike pasurore, si dhe

për të përcaktuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur, duke nisur që në origjinë në gjendjen pasurore dhe financiare të familjes së babait të bashkëshortes, z. A. K., në momentin e krijimit të asetit të parë (shtëpi me sip. 268 m² dhe truall me sip. 330 m², në L., Tiranë), i cili, pasi ia ka shitur blerësit A. M., krijoi mjetet financiare për blerjen e apartamentit nga shoqëria “U.” sh.p.k., apartament që më pas iu shit blerësit Sh. K., në shumën 110.000 euro.

1.3.4 Komisioni hetoi aftësinë paguese të personit tjetër të lidhur, z. A. K., si dhe mundësinë e përballimit të kostove për ndërtimin e vilës me dy kate plus papafingo, ndodhur në L., Tiranë, bazuar: (i) në të ardhurat e realizuara nga anëtarët e familjes së tij në periudhën 1999 – 2004; (ii) në deklarinimin para fillimit të detyrës të personit të lidhur/bashkëshortes; (iii) në deklarinimin e subjektit gjatë hetimit administrativ dhe materialeve shoqëruese të sjella nga ai; si dhe (iv) sipas dokumentacionit administrativ gjatë hetimit administrativ.

1.3.5 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2005 (para fillimit të detyrës), personi i lidhur ka deklaruar si pasuri: a) shtëpi banimi dykatëshe + papafingo 268 m², L., Komuna D., Tiranë. Vlera: 5.000.000 lekë. Burimi: shitja e shtëpisë së mëparshme, si dhe të ardhurat e tjera familjare. Pjesa takuese: 25 % së bashku me prindërit dhe vëllanë; b) tokë me sip. 330 m² (për të cilën ndodhet shtëpia me sip. 268 m², L., Komuna D.; nr. pasurisë: (***) ; vlera: 660.000 lekë; nuk deklarohet burim.

1.3.6 Në vijim, rezulton se janë deklaruar të ardhura me burim paga dhe shpërblime, viti 2005, prej shoqërive:

- “B.” sh.p.k. “W. A.”, të ardhura në shumën 1.050.000 lekë;
- “I.”, periudha gusht 2005 – janar 2006, të ardhura në shumën 400.000 lekë;
- Qendra “C. C. A.”, për periudhën 2002 – 2004, të ardhura në shumën 1.980.000 lekë;
- “U.” sh.p.k. për periudhën 1999 – 2000, të ardhura në shumën 960.000 lekë;
- “B.” sh.p.k. për periudhën 2001 – 2004, të ardhura në shumën 1.920.000 lekë.

1.3.7 Gjatë verifikimit të të ardhurave të familjes K. rezulton se bashkëshortja e subjektit dhe prindërit e saj kanë nënshkruar kontratën e privatizimit të një apartamenti banimi me sip. 81 m² në Peshkopi, pasuri e tjetërsuar në datën 17.10.1995, kundrejt shumës 850.000 lekë, fakte që konfirmohen edhe nga ZVRPP-ja Dibër.

1.3.8 Me kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 2.4.2002, të tokës bujqësore – kontratë kjo e lidhur mes shitësve S. D. dhe N. D. dhe blerësit A. K. – rezulton të jetë fituar pronësia e një toke arë me sip. 330 m² kundrejt çmimit 600.000 lekë, shumë e shlyer menjëherë, jashtë zyrës noteriale.

1.3.9 Me kontratën e sipërmarrjes nr. (***) , datë 6.2.2004 – mes porositësit investitor A. K. dhe sipërmarrësit shoqëria “B.”⁵ sh.p.k. – ishte rënë dakord për ndërtim në pronën e porositësit pas zbardhjes së lejes së ndërtimit, në bazë të një aneksi kontrate që do të ishte pjesë e saj. Bashkëlidhur kësaj kontrate rezultoi një preventiv për ndërtimin e banesës me dy kate me sip. 97 m² secili dhe një papafingo me sip. 74.2 m² (në total sip. 268.2 m²), në vlerën 4.754.111,75 lekë. Me vendimin nr. (***) , datë 1.4.2004, të KRRT-së, të Komunës D. dhe lejes së ndërtimit (formulari 4) ishte miratuar ndërtimi i vilës sipas projektit. Me akt-kolaudimin e muajit shtator të vitit 2004 evidentohet se punimet fillonin në datën 1.5.2004 dhe kishin si afat përfundimi datën 1.10.2004. Ndërkohë, u konstatua se nuk evidentohet asnjë pagesë e kryer në funksion të blerjes të tokës apo të pagesës së situacioneve, të vëllimeve apo të zërave të ndërtimit në favor

⁵ NIPT (***)

të shoqërisë “B.” sh.p.k. Faktet e mësipërme rezultojnë nga dokumentacioni i siguruar nga ZVRPP-ja Tiranë.

1.3.10 Për shumën e shpenzuar për blerjen e tokës dhe për ndërtimin e shtëpisë sa më sipër, si dhe për burimin e të ardhurave, përmes postës elektronike, në datën 14.8.2018, subjekti ka deklaruar se shtëpia në Q., L., ishte ndërtuar me të gjitha të ardhurat e realizuara nga familja e z. A. K. deri në vitin 2004 dhe, konkretisht:

- z. A. K., *periudha 1997 – 2004, të ardhura nga paga: 2.675.344 lekë;*
- znj. H. K., *periudha 1997 – 2004, të ardhura nga paga: 1.233.544 lekë;*
- znj. H. K., *periudha 2003 – 2004, të ardhura nga një klinikë për shërbime mjekësore: 400.000 lekë. Nga të ardhurat e mësipërme janë realizuar kursime në shumën 2.400.000 lekë. Të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas aktit noterial të shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. (***) , datë 17.10.1995, për vlerën 850.000 lekë;*
- znj. M. K. *shtator, periudha 1999 – gusht 2001, të ardhura nga paga në shoqërinë “U.” sh.p.k.: 960.000 lekë;*
- znj. M. K., *periudha shtator 2001 – dhjetor 2002, të ardhura nga paga në shoqërinë “B.” sh.p.k.: 800.000 lekë (bashkëngjitur vërtetimi nr. (***) prot., datë 1.11.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore);*
- Të ardhura nga fondacioni “The C.C. A.” me NIPT (***):
 - *viti 2002, me pagesë mujore neto 51.150 lekë [56.834 – (56834 x 10 %)] në shumën neto vjetore 613.800 lekë;*
 - *periudha 2003 – 2004 me pagesë mujore neto 56.925 lekë [63.250 lekë – (63.250 lekë x 10 %)] , pra, në shumën neto totale prej 1.366.200 lekësh.*
- Të ardhura *neto* të deklaruara nga aktiviteti privat “K.”, viti 2003 (person fizik NIPT (***) , në shumën prej 470.000 lekësh.
- Të ardhura *neto* nga aktiviteti privat “K.”, viti 2004 (person fizik NIPT (***) , në shumën prej 355.000 lekësh.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për ndërtimin e kësaj banese ishte shpenzuar vlera prej 4.754.112 lekësh. Shuma prej 4.754.112 lekësh i ishte paguar *cash* shoqërisë sipërmarrëse “B.” sh.p.k. gjatë periudhës 2003 – 2004. Bashkëshortja e tij gjatë gjithë periudhës 1999 – qershor 2004 ka kontribuar me të ardhurat e realizuara prej saj dhe të deklaruara sa më sipër në shumën 4.565.000 lekë në familjen K., me përjashtim të blerjes së një makine tip “Ford Fiesta”, në vitin 2001.

1.3.11 Subjekti i rivlerësimit e ka mbështetur deklarin e tij në materiale të arkivit të ZVRPP-së Tiranë të vitit 2018, në të cilën u konstatua dokumenti si më poshtë:

- Veprim arke, datë 31.7.2008, me referencën (***) në “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin: “Pagesë takse hipoteke për shitje shtëpie 10 % të fitimit kapital...”, që vërteton se babai i personit të lidhur, z. A. K., ka derdhur *cash* në llogarinë: *Tatim taksa të tjera*, shumën prej 1.902.430 lekësh. Bashkëlidhur këtij veprimi arke rezulton edhe një fletë përlllogaritjeje e kësaj takse, nga e cila del se kostoja e ndërtimit të shtëpisë është vlerësuar 27.000 lekë/m²; e sip. 268.2 m²; në vlerën totale prej 7.241.400 lekësh, që, së bashku me vlerën e truallit prej 600.000 lekësh sipas kontratës së shitblerjes, shkojnë në total në shumën 7.841.400 lekë.

1.3.12 Komisioni, bazuar udhëzimin nr. 1, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, i vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”, konstatoi se kostoja e ndërtimit ka qenë

24.446 lekë/m², e cila në raport me sipërfaqen e shtëpisë prej 268.2 m² duhet të ketë kushtuar 6.556.417,2 lekë dhe jo 4.754.112 lekë, sikurse deklarohet nga subjekti.

1.3.13 Komisioni – nisur nga fakti se nuk rezultonte dokumentacion ligjor që të vërtetonte pagesën e shumës prej 4.754.112 lekësh për ndërtimin e shtëpisë, si dhe nga fakti se personi i lidhur në deklaratën periodike ka deklaruar se shtëpia ka kushtuar 5.000.000 lekë si ndërtim dhe 660.000 lekë si blerje toke – i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte vlerën reale të punimeve të ndërtimit, si dhe mënyrën e pagesës së tyre shoqërisë “B.” sh.p.k. Subjekti, ndër të tjera deklaroi: “...shuma prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar në deklaratën e vitit 2003 nga babai i bashkëshortes sime, përbëhet nga shuma 4.754.112 lekë (vlera e ndërtimit), si dhe nga shuma 245.888 lekë, e cila kishte të bënte me pagesat e ndryshme që ishin bërë për projektim (arkitekturor, inxhinierik, elektrik, hidraulik etj.)”. Për këtë ai depozitoi: (i) vërtetimin e datës 14.11.2018 të shoqërisë “B.” sh.p.k., përmes së cilit deklarohet se z. A. K. kishte shlyer *cash* shumën prej 4.754.112 lekësh, sipas kontratës e sipërmarrjes nr. (***) datë 6.2.2004; si dhe (ii) shkresën nr. (***) prot., datë 14.11.2018, të subjektit “Sh. H. A.”, sipas të cilës konfirmoheshin shuma të investuara dhe të arkëtuara nga z. A. K. në marrëdhëniet e tij me shoqëritë huamarrëse: “V.” dhe “K.”.

1.3.14 Për këto fakte, shoqëria ndërtuese “B.”⁶ sh.p.k. depozitoi faturën tatimore nr. 6, datë 30.12.2004, shoqëruar me situacion punimesh nr. 1, në shumën prej 3.188.562 lekësh dhe faturën tatimore nr. (***) datë 9.7.2004, shoqëruar me situacionin përfundimtar në shumën prej 1.565.550 lekësh, duke konfirmuar se e gjithë pagesa e shumave të faturuara ishte shlyer deri në datën 8.7.2004.

1.3.15 Gjatë hetimit administrativ, për burimet e ligjshme të ndërtimit të shtëpisë dykatëshe të banimit me sip. 268 m², subjekti i rivlerësimit deklaroi se në periudhën 1997 – 2004 anëtarët e familjes së z. A. K. kishin realizuar të ardhura *neto* në shumën prej 6.465.888 lekësh nga pagat dhe aktivitetet e tjera profesionale. Prej këtyre të ardhurave, z. A. K. dhe znj. H. K. kishin krijuar kursime në shumën prej 2.400.000 lekësh, shumë të cilës i shtohet vlera prej 4.565.000 lekësh, kontribut nga znj. M. K., si dhe vlera prej 850.000 lekësh e përfutur nga shitja e shtëpisë. Kursimet në total kapin vlerën 7.315.888 lekë, të specifikuara si më poshtë vijon:

- A. K., periudha 1997 – 2004, të ardhura nga paga: 2.675.344 lekë;
- H. K., periudha 1997 – 2004, të ardhura nga paga: 1.233.544 lekë;
- H. K., periudha 2003 – 2004, të ardhura nga aktivitetet: 400.000 lekë;
- M. K., periudha 1999 – 2001, nga shoqëria “U.” sh.p.k.: 960.000 lekë
- M. K., periudha 2001 – 2002, nga shoqëria “B.” sh.p.k.: 800.000 lekë
- M. K., viti 2002, fondacioni “The C. C. A.”: 613.800 lekë
- M. K., periudha 2003 – 2004, fondacioni “The C. C. A.”: 1.366.200 lekë
- M. K., viti 2003, nga aktiviteti si “K.”: 470.000 lekë
- M. K., viti 2004, nga aktiviteti si “K.”: 355.000 lekë
- Shitja a shtëpisë në Peshkopi: 850.000 lekë
- M. K., të ardhura *neto* 5.415.000 lekë.

1.3.16 Komisioni ka konstatuar se në deklaratën periodike të vitit 2005 dhe në deklarimin e burimit të të ardhurave sipas procesverbalit të datës 19.1.2007 në ILDKPKI, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura si dhe burimet përkatëse:

Paga dhe shpërblime, viti 2005, nga shoqëritë

- “B.” sh.p.k. + 2. “W. A.”: 1.050.000 lekë;
- “I.”, periudha gusht 2005 – janar 2006: 400.000 lekë;

⁶ Shkresa e shoqërisë “B.” sh.p.k., datë 7.12.2018.

- Qendra “C. C. A.”, periudha 2002 – 2004: 1.980.000 lekë;
- “U.” sh.p.k., periudha 1999 – 2000: 960.000 lekë;
- “B.” sh.p.k., periudha 2001 – 2004: 1.920.000 lekë;

1.3.17 Prej burimeve të mësipërme, në funksion të hetimit, u morën në konsideratë vetëm të ardhurat nga paga dhe shpërblimet nga fondacioni “C. C. A.”, nga shoqëria “U.” sh.p.k. dhe nga shoqëria “B.” sh.p.k., të cilat, deri në fund të vitit 2004, në total arrinin në shumën *neto* prej 4.860.000 lekësh.

1.3.18 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për aftësitë paguese për blerjen e tokës dhe për ndërtimin e vilës me të ardhurat e deklaruara në DVP-në e vitit 2005 (para fillimit të detyrës), si dhe në deklaratimet e subjektit pranë Komisionit, në datat 14.8.2018 dhe 16.11.2018, të pasqyruara këto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2

ANALIZA FINANCIARE	Periudha 1997 – 2004
Të ardhurat	12,135,052
Pagat e saj në periudhën 1999 – 2004 ⁷	5,985,000
Pagat e z. A. K., babai i M. K. (1997 – 2005)	2,677,807
Pagat e H. K., nëna e M. K. (1997 – 2005)	1,402,411
Gjendje likuiditetit nga shoqëritë piramidale	2.069.834
Pasuritë	5,580,693
Blerë toka bujqësore me sip. 330 m ²	660,000
Ndërtuar vilë me sip. 268 m ² , 2 kate + papafingo	4.754.112
Blerë automjet tip “Ford”	166,581
Shpenzime	2,725,714
Shpenzime jetike për periudhën 1997 – 2002	1,440,000
Shpenzime jetike për periudhën 2003 – 2004	1,285,714
DIFERENCA (të ardhura - pasuri - shpenzime)	3,828,645

1.3.19 Komisioni, në analizën financiare ka marrë në konsideratë dhe, për rrjedhojë, ka përllogaritur:

- Të ardhurat e z. A. K., të znj. H. K. dhe të personit të lidhur, në periudhën 1997 – 2004, bazuar në të dhënat e siguruar nëpërmjet dokumentacionit të ardhur nga Sigurimet Shoqërore (për A. K. dhe H. K.), si dhe të subjekteve tregtare për personin e lidhur, znj. M. K., të pasqyruara në tabelën nr. 3 më poshtë.
- Nuk janë llogaritur të ardhurat e deklaruara në emër të nënës së personit të lidhur, znj. H. K., në shumën prej 400.000 lekësh, me burim nga aktiviteti privat i klinikës për shërbime

⁷ Në periudhën 1999 – 2000, nga shoqëria “U.” sh.p.k., shuma 960.000 lekë.
Në periudhën 2001 – 2004, nga shoqëria “B.” sh.p.k., shuma 1.920.000 lekë.
Në periudhën 2002 – 2004, qendra “C.C.A.”, shuma 1.980.000 lekë.
Në periudhën 2003 – 2004, si “K.” 1.125.000 lekë

Gjithsej 5,985,000 lekë

mjekësore, pasi për këto të ardhura nuk rezultuan prova – nga hetimi administrativ dhe nga subjekti i rivlerësimit – që të provonin burimin e ligjshëm të tyre.

1.3.20 Komisioni kreu verifikimet përkatëse për të ardhurat e personit të lidhur edhe pranë institucioneve kompetente: Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore, si dhe kreu analizën financiare sipas konfirmimit nga këto institucione.

- Sipas vërtetimit nr(***) prot., datë 6.11.2018, të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore rezultoi se:
 - Nga qendra “C. C. A.”, nuk figuronte emri në listëpagesën për periudhën korrik 2000 – shkurt 2004;
 - Shoqëria “U.” sh.p.k.: në vitin 1999 (nuk ka emër), e siguruar në periudhën prill 2000 – gusht 2001.
 - Shoqëria “B.” sh.p.k. e siguruar vetëm në periudhën qershor – dhjetor 2002.

Nga sa më sipër, të ardhurat e personit të lidhur, znj. M. K., në periudhën 1999 – 2004, rezultojnë si në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

Muaji / Viti	1999	2000 “U.”	2001 “U.”	2002 “B.”	2003	2004
Janar			7,800			
Shkurt			7,800			
Mars			7,800			
Prill		6,645	7,800			
Maj		6,645	7,800			
Qershor		6,645	7,800	9,000		
Korrik		7,773	8,600	10,000		
Gusht		7,773	8,600	10,000		
Shtator		7,773		10,000		
Tetor		7,773		10,000		
Nëntor		7,773		10,000		
Dhjetor		7,773		10,000		
Shuma		66,573	64,000	69,000		

- Për të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja në disa shoqëri dhe OJF, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018, informoi Komisionin se:
 - Për OJF-në “C. C. A.”, e regjistruar në datën 7.10.2002, nuk mund të gjendeshin të dhëna në lidhje me pagën dhe tatimin për të ardhurat për individë të veçantë të punësuar në shoqëri para dhjetorit të vitit 2011. Nga verifikimi i kryer në zyrën e kontabilitetit të DRT-së Tiranë, rezultonte se fondacioni “C. C. A.” ka kryer pagesa tatimi në burim për shërbime konsulence në periudhën 2002 – 2004, gjithsej në shumën 181,115 lekë, që i përkiste 10 % të të ardhurave nga paga për shumën 1.811.150 lekë, por sqaron se nuk janë të specifikuara në përshkrim apo të deklaruara nga shoqëria se cilit individ i përkasin këto pagesa të tatimit në burim.
 - Për shoqërinë “U.” sh.p.k. informon se nga verifikimi i kryer në sistemin C@TS dhe në arkiv nuk rezultojnë të ishin paguar tatim për të ardhurat apo tatim në burim për të ardhurat e realizuara nga znj. M. K. në këtë shoqëri.
 - Për shoqërinë “B.” sh.p.k. nuk rezultonte të kishte informacion.

Drejtoria e Përgjithshme Tatimore⁸ ka informuar se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit rezultojn: në vitin 2003 të ardhurat *neto* në vlerën 470.000 lekë (pas pagesës së tatimit në burim) dhe në vitin 2004 të ardhurat *neto* në vlerën 655.000 lekë (pas pagesës së tatimit në burim); gjithsej **1.125.000 lekë**.

- Komisioni, duke u bazuar në informacionin e marrë nga këto dy institucione, konstatoi se për periudhën 1999 – 2004 të ardhurat *neto* të bashkëshortes së subjektit rezultojn si më poshtë:

Tabela nr. 4

Shoqëritë punëdhënëse	Periudha	Të ardhurat <i>neto</i>	Arkivi Qendror dhe DPT-ja
Fondacioni “C. C. A.”	2002 - 2004	1,980,000	1,630,035 ⁹
“U.” sh.p.k.	1999 - 2000	960,000	130,573
“B.” sh.p.k.	2001 - 2004	1,920,000	69,000
Person fizik, “K.”	2003 - 2004	1,125,000	1,125,000
	1999 - 2004	5,985,000	2,954,608

1.3.21 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare të bazuar vetëm te të ardhurat e konfirmuara nga Arkivi Qendror i Sigurimeve Shoqërore dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilave situata financiare paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 5

ANALIZA FINANCIARE	Periudha 1997–2004
Të ardhurat	9,104,660
Pagat, M. K., për periudhën 1999 - 2004	2,954,608
Pagat e A. K., babai i M. K. (periudha 1997–2005)	2,677,807
Pagat e H. K., nëna e M. K. (periudha 1997–2005)	1,402,411
Gjendje e likuiditetit nga shoqëritë piramidale	2.069.834
Pasuritë	5,580,693
Blerë toka bujqësore me sip. 330 m ²	660,000
Ndërtuar vila me sip. 268 m ² , dy kate + papafingo	4.754.112
Blerë automjet, tip “Ford”	166,581
Shpenzime	2,725,714
Shpenzime jetike për periudhën 1997 – 2002	1,440,000
Shpenzime jetike për periudhën 2003–2004	1,285,714
DIFERENCA (të ardhura – pasuri – shpenzime)	798,253

⁸ Shkresa nr(***)prot., datë 25.10.2016 dhe shkresa nr. (***) prot., datë 31.1.2018; shkresa nr. (***) prot., datë 15.2.2018.

⁹ Të ardhurat *neto* nga fondacioni “C. C. A.” janë marrë në konsideratë të ardhurat *neto* të nxjerra nga zyra e kontabiliteteit të DRT-së Tiranë, ku rezultojn se “C. C. A.” ka kryer pagesa tatimi në burim për shërbime konsulence nëperiudhën 2002 – 2004 gjithsej në shumën 181,115 lekë, megjithëse sqaron se nuk janë të specifikuar në përshkrim apo të deklaruara nga ky subjekt se cilit individ i përkasin këto pagesa të tatimit në burim.

1.3.22 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të të ardhurave, administroi këtë dokumentacion marrë nga institucione publike e private:

- Shkresën nr. (***) prot., datë 13.4.2018, të ZVRPP-së Dibër, përgjigja shoqërohet me dokumentacion nga regjistri i pasurisë së paluajtshme.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 15.2.2018; shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2018; si dhe shkresën nr. (***) prot., datë 22.2.2018, të ZVRPP-së Tiranë, e cila ka dërguar dokumentacion nga regjistri i pasurisë së paluajtshme.
- dokumentet bashkëlidhur me shkresën nr(***)prot., datë 27.9.2017, të ZVRPP-së Tiranë, dërguar ILDKPKI-së në kuadër të vlerësimit të subjektit nga ky institucion; shkresën nr. (***) prot., datë 16.2.2018, të “BKT”-së, si dhe shkresën nr. (***) prot., datë 16.8.2018, të “Tirana Bank”.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 9.2.2018, të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Shkresën nr. (***)prot., datë 15.2.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 12.2.2018, shkresën nr. (***) prot., datë 7.11.2018, dhe shkresën nr. (***) prot., datë 15.11.2018 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë;
- Shkresën e shoqërisë tregtare “U.” sh.p.k., datë 22.8.2018.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 14.8.2018 dhe shkresën nr(***)prot., datë 19.10.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit të Parave.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 20.11.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 7.12.2018, të shoqërisë “B.” sh.p.k.
- Deklarimet e subjektit të rivlerësimit, datë 14.8.2018, si dhe dokumentet bashkëlidhur, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

1.3.23 Komisioni, në rezultatet e hetimit, në analizë të provave në raport me faktet, si dhe në analizën financiare të kryer, konkludoi se:

a) Për burimin e krijimit të të ardhurave (*për ndërtimin e shtëpisë private 2-katëshe + papafingo 268.2 m² dhe truall me sip. 330 m², në vlerën 4.754.112 lekë, nga personi i lidhur dhe familjarët e saj*), deklarimet e subjektit, përputheshin me rezultatet e këtij hetimi, si dhe nga analiza ekonomike, rezultoi se ata kishin pasur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e kësaj pasurie.

b) Dukej se kishte mospërputhje të deklarimit në lidhje me të ardhurat, mes dokumentacionit të lëshuar nga subjektet tregtare ku kishte punuar ose kishte dhënë shërbimin bashkëshortja e subjektit, me informacionin nga administrata tatimore dhe e sigurimeve shoqërore, lidhur me përfitimin e të ardhurave nga subjektet tregtare.

Në lidhje me paragrafin “b)” më sipër, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

1.3.24 Subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve dhe provave të depozituara në datën 16.4.2019, si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, ka parashtruar se: bashkëshortja e tij, në deklaratën para fillimit të detyrës në datën 3.4.2006 kishte deklaruar të gjitha të dhënat në lidhje më të ardhurat e përfituara për vitet e punës në sektorin privat (09/1999-03/2006).

Subjekti ka dorëzuar këtë dokumentacion:

- *listat e pagave të deklaruara për punonjësit, nga shoqëritë “U.” sh.p.k. dhe “B.” sh.p.k. në Institutin e Sigurimeve Shoqërore specifikisht;*
- *listat e pagave nga shoqëria “U.” sh.p.k. në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për periudhat prill 2000 – gusht 2001, si dhe “B.” sh.p.k. për vitin 2002;*
- *vërtetimin nr. (***) prot., datë 23.3.2007, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.*

Ndër të tjera në vijim ka shpjeguar se në këta vjet, paga është tërhequr *cash* nga të gjithë punonjësit dhe se këto shoqëri private kishin deklaruar nivelin minimal ose shumë afër këtij niveli. Nëndeklarimi i pagave për punonjësit nga shoqëritë private, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore ose të tatimit për pagat, sipas subjektit, mbështetej edhe nga: ligji nr. 9766, datë 9.7.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për tatimin për të ardhurat”, neni 21 “shpenzimet të panjohura”, germa “n”, sipas të cilit konsiderohen shpenzime të panjohura “shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar”, si dhe në aktin nënligjor të VKM-së nr. 285, datë 4.5.2007, për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të tatimit për të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë e ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin tekniko-ekonomik të tyre. Të ardhurat e deklaruara te shoqëria “B.” sh.p.k., për periudhën shtator 2001 – dhjetor 2002, kishin qenë në formën e pagës ndërsa për periudhën 2003 – 2004, ato kishin qenë në formën e shërbimeve të dhëna si person fizik i regjistruar. Për të mbështetur deklaratimet e tij subjekti ka dorëzuar; vërtetim të lëshuar në datën 21.9.2004, si dhe kontratën e shërbimit ndërmjet shoqërisë “B.” sh.p.k. dhe znj. M. K. për vitin 2004, sipas të cilës pagesa për shërbimin e ofruar ishte 50.000 lekë/muaj ose 600.000 lekë/vit. Për të ardhurat e marra nga Fondacioni “The C. C.” ka dorëzuar kontratën e shërbimit¹⁰ “Service Agreement” në datën 15.1.2004 me këtë fondacion, sipas të cilës konstatohet se të ardhurat mujore ishin në vlerën 63.250 lekë. Në lidhje me këto të ardhura është mbajtur dhe paguar tatimi në burim në masën 10 % të të ardhurave.

1.3.25 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në lidhje me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues konstaton se Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën nr. (***) prot., datë 24.7.2018, ka konfirmuar pagesën e tatimit 10 % të të ardhurave nga shoqëria “W.”, shlyer në datën 15.12.2005. Personi i lidhur ka shlyer tatim për të ardhurat për shumën e përfutuara *cash* për pagën minimale të deklaruar nga subjektet punëdhënëse.

Në situatën ligjore objekt vlerësimi, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se: (i) këto janë të ardhura të personit të lidhur kur subjekti nuk kishte lidhur martesë; (ii) në kryerjen e analizës financiare janë përllogaritur vetëm të ardhurat e personit të lidhur dhe familjes së saj, për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore; (iii) bazuar në analizën financiare me rezultat pozitiv, të kryer sipas tabelës nr. 5, çmton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të saktë gjatë hetimit administrativ për burimin e tyre, si dhe personi i lidhur dhe familja e saj kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e tokës dhe për ndërtimin e shtëpisë si më sipër arsyetuar.

1.3.26 Në vijim për faktet dhe rrethanat për burimin e ligjshëm në vlerën 110.000 euro, rezulton se:

1.3.27 Shtëpia e mësipërme (truall dhe ndërtesë) i është shitur blerësit A. M., për shumën 220.000 euro, i cili kishte paguar fillimisht kapar në shumën 20.000 euro, fakt që konfirmohet me kontratën e kaparit. Më pas, blerësi A. M. ka kaluar shumën 196.937 euro në llogarinë e shitësit A. K. në “BKT”, që buronte nga një kredi në shumën 200.000 euro nga “Tirana Bank”, kredi e miratuar në bazë të kontratës së shitblerjes me rezervë pronësie (me kusht), të pasurisë së paluajtshme (truall dhe ndërtesë), për çmimin 220.000 euro. Pjesën e mbetur të çmimit, në

¹⁰ Të vetmen kontratë që disponohej, pasi kontratat me fondacionin rinovoheshin çdo vit.

shumën 3.063 euro, subjekti deklaroi se blerësi A. M. e kishte shlyer *cash* dhe për këtë, z. A. K. kishte nënshkruar deklaratën noteriale, për shlyerjen përfundimtare të vlerës së shitjes.

1.3.28 Nga shuma e mësipërme, babai i bashkëshortes, z. A. K., i kishte dhënë kaparin (20.000 euro) personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, me të cilën, në datën 28.5.2008, kishte shlyer kredinë që ajo kishte marrë në “NBG” në nëntor të vitit 2004 (në shumën 23.000 euro), me të cilën në atë periudhë kishte shlyer huan që kishte marrë nga shtetasi F. Sh. në muajin maj të vitit 2004. Këto fakte konfirmohen edhe nga të dhënat e “NBG”-së.

1.3.29 Me shumën e disponueshme në llogarinë në “BKT”, z. A. K., kishte tërhequr *cash* shumën 26.500 euro në datën 29.7.2008 dhe kishte shlyer në datën 31.7.2008 në “Raiffeisen Bank” (cash në sportel) shumën 1.902.430 lekë – si taksë hipoteke për shitje shtëpie 10 %. Më pas, kishte transferuar shumën 120.000 euro në llogarinë bankare të shoqërisë “U.” sh.p.k. me përshkrimin e blerjes së dy apartamenteve. Njëri nga këta apartamente regjistrohet në pronësi të personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit (apartamenti me sip. 94,6 m², si pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***); vlera e shitjes në shumën 61.758 euro), ndërsa tjetri në emër të z. F. K., vëllai i personit të lidhur. Këto fakte janë konfirmuar edhe nga “BKT”-ja, “Raiffeisen Bank”, ZVRPP-ja Tiranë dhe nga shoqëria “U.” sh.p.k.

1.3.30 Apartamentin e dhënë nga babai, rezulton se personi i lidhur e ka shitur në datën 21.10.2015 në bazë të kontratës për shitje pasurie të paluajtshme nr. (***), kundrejt çmimit 110.000 euro, shumë e derdhur po në datën e nënshkrimit të kontratës në llogarinë në “BKT” të noterit publik, e transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në datën 25.10. 2015.

1.3.31 Nga sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se nga çmimi i blerjes dhe i shitjes rezultonte një diferencë fitimi prej 48.242 eurosh nga ky transaksion, shkak për të cilin subjekti i rivlerësimit në datën 14.8.2018 deklaroi se: *“Rivlerësimi i apartamentit prej 94.6 m² në shumën 17.000.000 lekë është përlllogaritur sipas aktit të rivlerësimit, vërtetuar me vërtetimin nga dokumenti hipotekor datë 3.1.2012 dhe për këtë rivlerësim është paguar tatimi 1 % për diferencën (çmim i rivlerësuar - çmim blerjeje, pra: 17.000.000 - 7.608.585 = 9.391.415 lekë), pra, është paguar tatimi në shumën 939.141 lekë në datën 20.12.2011 në “Credins Bank”. ...në momentin e shitjes së këtyre apartamenteve çmimet përkatëse 110.000 euro dhe 130.000 euro nuk i kalojnë vlerat e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk rezulton tatim për pagesë”.*

Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision dokumentet që vërtetonin rivlerësimin e realizuar, pagesën e tatimit, si dhe regjistrimin në regjistrin hipotekor.

1.3.32 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe provave, konkludoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, lidhur me burimin e të ardhurave në shumën 110.000 euro, nga shitja e apartamentit me sip. 94.6 m² (pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), Rr. “R. P.”, p. “U.”) përputhej me rezultatet e hetimit administrativ.

Në përfundim të sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues çmon se në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sip. 124.91 m², me adresë: Rr. “D. H.”, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë sipas nenit 30 dhe pikës 5 “a” të nenit 33, të ligjit 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

2. Shtesë apartamenti, me sip. 29.86 m², fituar me kontratë shitjeje të pasurisë së paluajtshme nr. (***), datë 23.12.2016, me vlerë 46.000 euro, si dhe pasurinë garazh me sip. 12.5 m², përftuar me kontratë shitjeje të pasurisë së paluajtshme nr. (***), datë 23.12.2016, me vlerë 24.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

2.1 Burimi i krijimit i deklaruar për shtesën e apartamentit dhe për garazhin

Vlera prej 70.000 eurosh, të ardhura këto të përfuara nga shitja e apartamentit në pronësi të bashkëshortes (pasuri e krijuar para martesë) me sip. 115.08 m², në shumën 130.000 euro, me nr. pasurie (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), sipas kontratës nr. (***), datë 17.11.2016, me adresë: Rr. “R. P.”, P. “U.”, K. (***), Ap. (***), Tiranë; pjesa takuese e subjektit: 0 %.

Në deklaratën “Vetting”, për burimin e krijimit të deklaruar, subjekti ka sqaruar se:

- Apartamenti me sip. 115.08 m² është blerë në shumën 48.070 euro, sipas kontratës së shitjes së pasurisë nr. (***), datë 21.5.2007, nga të ardhurat e bashkëshortes prej shitjes së apartamentit me sip. 102 m², në shumën 50.000 euro, sipas kontratës nr. (***), datë 23.4.2007.
- Apartamenti me sip. 102 m² është blerë në shumën 32.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***), rep., datë 21.7.2005, nga bashkëshortja, nëpërmjet kredisë financiare në shumën 23.000 euro, në “NBG”, marrë në nëntor 2004, afati 25 vjet, kësti mujor 231 euro, si dhe diferenca prej 9.000 eurosh paguar nga kursimet e saj familjare të krijuara nga të ardhurat e realizuara në periudhën 2001–2005.

2.1.1 Burimi i krijimit i vlerës 130.000 euro, nga të cilat është përdorur shuma prej 70.000 eurosh, për këtë pasuri

Për të vërtetuar burimin e tyre, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- *kontratë sipërmarrjeje* nr. (***), rep., datë 21.7.2005, mes porositëses M. K. dhe sipërmarrësit “N.” sh.p.k., për një apartament me sip. banimi 92.1 m² dhe me sip. shkalle 7.55 m², me sip. totale 99.65 m², kundrejt çmimit 320 euro/m², me vlerë totale 32.288 euro, ku në momentin e nënshkrimit (sipas nenit 5/3 të kontratës) deklarohet se janë parapaguar 20.000 euro;
- *kontratë shitjeje* (me rezervë) nr. (***), datë 23.4.2007, mes shitëses M. K. dhe blerësit Xh. M., për shitjen e një apartamenti me sip. 102 m², kundrejt çmimit 50.000 euro, që do të paguheshin: 20.000 euro, të parapaguara përpara nënshkrimit dhe 30.000 euro deri në datën 30.10.2007, me marrjen e çelësave në dorë;
- *kontratë porosie* nr. (***), datë 21.5.2007, palë porositëse M. K. dhe palë sipërmarrëse shoqëria “U.” sh.p.k., për ndërtimin në godinën në të cilën po ndërtonte sipërmarrësi të një apartamenti 3+1, me sip. 126,5 m², seksioni 2, k. (***), ap. (***); në shumën 48.070 euro (paguar 47.070 euro sipas nenit 2 të kontratës);
- *kontratë shitjeje* nr. (***), datë 8.4.2008, palë shitëse shoqëria “U.” sh.p.k. dhe palë blerëse M. K., për apartamentin e banimit nr. (***), në Rr. “R. P.”, kompleksi “U.”, seksioni (***), k. (***), Tiranë, pasuria me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), me sip. 115,08 m², në shumën 43.370 euro; dhe
- *kontratë shitblerjeje* nr. (***), datë 17.11.2016 (për pasurinë e mësipërme) me palë shitëse M. K. dhe palë blerëse E. A. R.; vlera e shitjes: 130.000 euro.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

2.1.2 Në deklaratën “Vetting” deklarohet shtesë apartamenti, me sip. 29.86 m², me vlerë 46.000 euro, si dhe pasuria garazh, me sip. 12.5 m², me vlerë 24.000 euro, me burim krijimi të deklaruar për të dyja pasuritë: 70.000 euro, të ardhura të përfuara nga shitja e apartamentit në pronësi të bashkëshortes (pasuri e krijuar para martesë), shitur në shumën prej 130.000 eurosh.

2.1.3 Në deklaratën periodike të vitit 2005, personi i lidhur ka deklaruar zotërimin e disa pasurive të krijuara para fillimit të detyrës (detyra në organet tatimore ka nisur në datën 3.4.2005). Deri në fund të periudhës së deklarimit të pasurisë (deri në datën 31.12.2005),

personi i lidhur ka deklaruar se zotëron si pasuri: “shtëpi banimi, apartament me sip. 110 m², L., Komuna D., Tiranë”; me vlerë 32.000 euro; me burim: “pjesërisht me kredi dhe pjesa tjetër nga të ardhurat e krijuara gjatë viteve”; pjesa takuese: 100 %, ndërsa në pjesën e detyrimeve, personi i lidhur ka deklaruar vetëm detyrimin për një kredi: “kredi financiare (23.000 euro) nga “NBG”-ja, Tiranë, marrë në nëntor 2004; kësti: 231 euro/muaj, afati: 15 vjet”, shuma e mbetur 22.000 euro.

2.1.4 Bazuar në materialet e dërguara nga “NBG”-ja, Komisionit i rezultoi se personi i lidhur kishte marrë: (i) një hua në vitin 2004, në shumën 23.000 euro nga shtetasi F. Sh., sipas deklaratës noteriale datë 29.9.2004 (ku huadhënësi dhe personi i lidhur kanë deklaruar se shuma ishte dhënë cash në muajin maj 2004 për ndërtimin e shtëpisë me dy kate); dhe (ii) një kredi në shumën 23.000 euro nga “NBG”-ja, sipas kontratës së kredisë datë 1.11.2004, ku qëllimi i kredisë ishte shlyerja e huas që kishte ndaj z. F. Sh. për ndërtimin e shtëpisë.

2.1.5 Nga hetimi administrativ nuk rezultoi asnjë kredi tjetër bankare e kësaj kohe, që të përdorej për blerjen e një apartamenti në L., D., Tiranë. Ndërkohë, rezultoi se kredia e dhënë nga “NBG”-ja kishte si qëllim shlyerjen e huas ndaj z. F. Sh., fakt që konfirmohet edhe nga përshkrimi i veprimit në transfertën bankare ref: (***), datë 23.11.2004. Pra, në deklarin e pasurisë u konstatuan mospërputhje në lidhje me burimin e ligjshëm për blerjen e apartamentit në L. të Tiranës, si dhe mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave për ndërtimin e shtëpisë (me dy kate dhe papafingo) në L. të Tiranës, të familjes së z. A. K. .

2.1.6 Për këto gjetje, në kuadër të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan deklarime për burimin e ligjshëm të blerjes së apartamentit, i cili deklaroi¹¹se: “Apartamenti me sip. 100.9 m² ishte blerë në shumën 32.288 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***) rep., datë 21.7.2005, nga bashkëshortja M. K. . Bashkëshortja fillimisht ka pasur si qëllim të ndërtojë një shtëpi private ngjitur me shtëpinë e prindërve të saj, me adresë Q., L., Tiranë dhe për këtë i kishte marrë borxh në muajin maj 2004 shumën prej 23.000 eurosh z. F. Sh., shumë e cila ishte marrë përsipër t’i kthehej atij brenda muajit dhjetor 2004, sipas deklaratës noteriale nr. (***) datë 29.9.2004. Në datën 1.10.2004 bashkëshortja i ishte drejtuar “NBG”-së me një kërkesë për huamarrjeje për shumën 23.000 euro. “NBG”-ja e kishte miratuar kredinë për shumën 23.000 euro dhe kjo shumë, pas disbursimit, është kaluar në llogarinë e bashkëshortes në datën 22.11.2004, sipas ekstraktit bankar në lidhje me disbursimin e shumës. Në datën 23.11.2004 është bërë shlyerja e borxhit ndaj z. F. Sh., vërtetuar kjo me transfertën e shumës nga llogaria e bashkëshortes te llogaria e z. F. Sh. në shumën 22.615 euro, sipas ekstraktit bankar, dhe diferenca prej 385 eurosh është shlyer cash. Në pamundësi të ndërtimit të shtëpisë (kjo për shkak se nuk është bërë e mundur marrja e lejes së ndërtimit), shuma e mbetur në dispozicion prej 23.000 eurosh është përdorur për të porositur apartamentin, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***)rep., datë 21.7.2005, me adresë, Q., L., Tiranë...”

2.1.7 Në vijim të deklarinimit të subjektit – se shtetasi F. Sh. i kishte dhënë bashkëshortes së tij shumën prej 23.000 eurosh për ndërtimin e një ndërtese tjetër në tokën e blerë në L., veç asaj për të cilën zbatoi punimet shoqëria “B.” sh.p.k. – Komisioni konstatoi se nga dokumentacioni i ZVRPP-së, në momentin e dhënies së huas nga z. F. Sh., nuk ekzistonte ende një shtëpi e ndërtuar, që personi i lidhur të mund të ndërtonte ngjitur. Sipas aktit të kolaudimit të muajit shtator 2004, referohet se punimet kishin si afat periudhën 1.5.2004 – 1.10.2004. Në deklarinimit e subjektit të rivlerësimit, se një pjesë e çmimit të apartamentit nga shoqëria “N.” sh.p.k. ishte shlyer me huan e dhënë nga z. F. Sh., Komisioni konstatoi mospërputhje me deklarimet në Deklaratën Vjetore Periodike të vitit 2005 (të bashkëshortes) dhe në deklaratën “Vetting” të

¹¹ Në datë 14 gusht 2018.

vitit 2017 (në pjesën sqaruese), sepse aty deklarohet se ky apartament ishte shlyer pjesërisht me kredi nga “NBG”-ja dhe jo me huan e marrë nga z. F. Sh. .

2.1.8 Komisioni, për të qartësuar problemin e qëllimit të investimit në ndërtimin e një shtëpie tjetër, ngjitur me atë të prindërve të bashkëshortes (qoftë edhe si projekt investimi), i kërkoi shpjegime subjektit, në kuadër të hetimit administrativ për depozitimin e ndonjë kërkesë apo të ndonjë aplikimi për leje ndërtimi në komunën D. . Në datën 19.10.2018, subjekti ka deklaruar: “...sipas konfirmimit të bashkëshortes, ajo ka pasur idenë të investojë në ndërtimin e një shtëpie të re, në oborrin e shtëpisë ekzistuese (shtëpia ekzistuese ishte planifikuar për të jetuar në të një familje)... Ideja për të ndërtuar pikërisht në këtë vend ishte diskutuar verbalisht edhe me zyrtarë të komunës dhe nga ana e tyre është pohuar në atë kohë që kjo gjë mund të realizohej. Kushtet urbanistike nuk e mundësuan një gjë të tillë dhe zyrtarët e komunës D., të cilët konfirmuan verbalisht në shkurt 2005 pamundësinë e miratimit të lejes së ndërtimit për një objekt tjetër në të njëjtin oborr, madje u procedua edhe me prishjen e klinikës mjekësore. Për këtë arsye nuk ishte bërë aplikim për leje ndërtimi dhe, për rrjedhojë, nuk kishte as refuzim shkresor për mosmiratim leje”.

Për pagesat e çmimit të kontratës së sipërmarrjes

2.1.9 Sipas kontratës nr(***) rep., datë 21.7.2005, rezultoi se bashkëshortja e subjektit, kishte porositur apartament me sip. banimi 92,1 m² dhe sip. shkalle 7,55 m², me sip. totale 99,65 m², kundrejt çmimit 320 euro/m², me vlerë totale **32.288 euro**; në momentin e nënshkrimit (sipas nenit 5/3 të kontratës) ishin parapaguar **20.000 euro**. Për mënyrën e likuidimit të apartamentit në vitin 2005 nga personi i lidhur deklarohet likuidim i plotë i tij në këtë vit në shumën 32.000 euro, si dhe nuk deklarohet detyrim i pashlyer për këtë kontratë. Për këtë transaksion edhe shoqëria “N.” sh.p.k., konfirmoi pagesat në vlerën prej 20.000 eurosh, paguar në datën 16.7.2005 dhe në vlerën prej 12.000 eurosh paguar në datën 19.1.2006.

2.1.10 Në analizë të fakteve të mësipërme, në lidhje me vlerën e apartamentit dhe me mënyrën e likuidimit të tij, Komisioni konstatoi se në deklaratën periodike të vitit 2005 bashkëshortja e subjektit kishte deklaruar pasurinë apartament me vlerë 32.000 euro, ndërkohë që vlera e tij ishte 32.288 euro; në vijim, deri në fund të atij viti deklarohet se ishin paguar 32.000 euro, ndërkohë që ishin paguar vetëm 20.000 euro dhe gjithashtu nuk deklarohet asnjë detyrim i mbartur në vitin 2005 për kontratën e sipërmarrjes, ndërkohë që në datën 19.1.2006, rezulton të ishte paguar shuma 12.000 euro për kontratën e sipërmarrjes, si pjesë e çmimit të pashlyer në vitin 2005.

2.1.11 Për këtë konstatim, në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili me përgjigjet e datës 14.8.2018, deklaroi: “...bashkëshortja kishte marrë një shumë hua nga z. F. Sh. në vlerën 23.000 euro për ndërtimin e një shtëpie ngjitur me vilën prindërve në L., por që këtë shumë nuk e ka përdorur për qëllimin e deklaruar, për shkak të mosmarrjes së lejes së ndërtimit. Për këtë arsye, me kredinë e marrë nga “NBG”-ja (22.615 euro) dhe me shumën 385 euro cash, likuidoi huan ndaj z. F. Sh. ”. Më tej, ka deklaruar: “...shumën 23.000 euro, dhënë hua nga z. F. Sh. (pa interesa dhe pa kosto të tjera), bashkëshortja vijoi ta mbante edhe në vitin 2005, duke e përdorur atë për të blerë “apartamentin në gjendje karabina, nga shoqëria “N.” sh.p.k., kundrejt çmimit 32.288 euro, të shlyer me cash në dy këste (20.000 euro, datë 16.7.2005 dhe 12.000 euro, datë 19.1.2006), por duke mos shlyer shumën 288 euro. Personi i lidhur kreu punimet e brendshme gjatë vitit 2006 deri në muajin prill 2007”.

- Për momentin e marrjes së apartamentit në dorëzim në gjendjen karabina, si dhe për aspekte të tjera, subjekti në datën 19 tetor 2018, ndër të tjera deklaroi: “...Ky apartament ishte marrë

në dorëzim nga ana e bashkëshortes verën e vitit 2006 (ndërkohë që likuidimi i plotë i vlerës së apartamentit është përfunduar në muajin janar 2006)."

2.1.12 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet publike e private dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresën nr. (***) prot., datë 20.7.2018, dhe shkresën nr. (***) prot., datë 15.8.2018, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për konfirmimin e këtyre transaksioneve.
- Shkresat e të gjitha bankare të nivelit të dytë dhe të subjekteve të tjera financiare: shkresën nr. (***) prot., datë 16.2.2018, dhe shkresën nr. (***) prot., datë 18.10.2018, të "BKT"-së; shkresën nr. (***) prot., datë 22.10.2018 të "Societe Generale Albania"; shkresën nr. (***) prot., datë 31.01.2018, të "NBG"-së;
- Shkresën nr. (***) prot., datë 2.2.2018, dhe shkresën nr. (***) prot., datë 15.10.2018, të "Intesa Sanpaolo Bank"; shkresën nr. OP-(***) prot., datë 4.10.2018, të "ProCredit Bank"; shkresat nr. (***) prot., datë 2.2.2018 dhe nr. (***) prot., datë 8.10.2018, të "Raiffeisen Bank", të shoqëruara me materialet në CD.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 8.8.2018, të shoqërisë "N." sh.p.k., shoqëruar me dokumentet bashkëlidhur.
- Shkresën nr. s'ka prot., datë 22.8.2018, të shoqërisë "U." sh.p.k., shoqëruar me dokumentet bashkëlidhur.
- Shkresën e noterit publik, znj. V. S., datë 14.10.2018, e cila konfirmoi kontratat për transaksionet e kryera.
- Shkresën nr. (***) prot., datë 14.8.2018, dhe shkresën nr. (***) prot., datë 19.10.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Deklarime të subjektit të rivlerësimit përmes përgjigjeve të datës 14.8.2018 dhe të datës 19.10.2018, si dhe dokumentet bashkëlidhur.
- Analizën e të ardhurave dhe të burimeve të tjera të ligjshme deri në fund të vitit 2005 dhe deklarin e pasurisë për vitin 2005, para fillimit të detyrës së personit të lidhur.

2.1.13 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës, për mospërputhjet mes deklarin të subjektit në deklaratën "Vetting" të vitit 2017 (në pjesën sqaruese), si dhe atë periodike të vitit 2005 të personit të lidhur –për shpenzimet të kredisë prej 23.000 eurosh nga banka "NBG" për blerjen/porositjen e apartamentit në vitin 2005 nga shoqëria "N." sh.p.k.. – dhe rezultateve të hetimit administrativ, si dhe me deklarin e tij gjatë hetimit administrativ. Deklarimi i personit të lidhur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, se kishte shlyer deri në fund të vitit 2005 shumën prej 32.000 eurosh për blerje apartamenti ndaj shoqërisë "N." sh.p.k., nuk ishte në përputhje me deklarinet e palëve kontraktuese gjatë hetimit administrativ, pasi subjekti dhe shoqëria e ndërtimit deklarojnë dhe pranojnë gjatë hetimit administrativ se në këtë vit u likuiduan vetëm 20.000 euro dhe në datën 19.1.2006 u likuidua shuma prej 12.000 eurosh.

2.1.14 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituar në datën 16.4.2019, si dhe deklarinete në seancën dëgjimore, ndër të tjera ka argumentuar¹²:

Apartamenti i blerë nga znj. M. K. nga shoqëria "N." sh.p.k., sipas kontratës nr. (***) rep., datë 21.7.2005, kishte pasur si burim të ligjshëm të të ardhurave kredinë në shumën prej 23.000 eurosh, marrë në "NBG", si dhe diferencën prej 9.000 eurosh nga të ardhurat e krijuara në periudhën 2004 – 2005. Veprimet e ndodhura gjatë vitit 2004 me z. F. Sh. ishin veprime të ndërmjetme (*zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik/periudhë*), pra, në thelb, destinacioni i kredisë së marrë u bë blerja e apartamentit nga shoqëria "N." sh.p.k. Mënyra e

¹² Referojuni shpjegimet e subjektit të dërguar me *e-mail-in* e datës 16.4.2019.

likuidimit të apartamentit ka qenë: ishte paguar shuma 20.000 euro sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 16.7.2005 nga shoqëria “N.” sh.p.k., si dhe pagesa për shumën e mbetur 12.000 euro sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 19.1.2006. Të gjitha veprimet kanë ndodhur para datës së fillimit në detyrë në administratën publike nga znj. M. K. (3.4.2006) dhe në deklaratën e dorëzuar në datën 5.4.2006. Deklarata e dorëzuar nga znj. M. K. në datën 5.4.2006, ishte deklarata e dorëzuar para fillimit të detyrës (3.4.2006). Në këtë deklaratë janë deklaruar të gjitha pasuritë, si dhe detyrimet e krijuara para fillimit të detyrës. Si e tillë kjo deklaratë kishte dhënë gjendjen e pasurive dhe detyrimeve në datën 3.4.2006. Deklarimi i pasurive dhe i detyrimeve deri në datën 31.12.2015 do të ishte i gabuar, pasi të gjitha pasuritë dhe detyrimet e krijuara për periudhën 1.1.2006 – 3.4.2006 do të mbeteshin pa u deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe kjo do të përbënte një shkelje. Në deklaratën e dorëzuar në datën 5.4.2006, në faqen ku deklarohen “Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, kërkohej deklarimi i detyrimeve të tjera që mbeten ende pa u shlyer, deri në datën e fillimit të detyrës prej zyrtarit.

2.1.15 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e të provave, konstatoi se deklarimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit i referohet deklaramit periodik të vitit 2005¹³, i cili është deklarimi përpara fillimit të detyrës së personit të lidhur. Referuar përcaktimeve ligjore në nenin 5/1, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, është parashikuar se deklarohet gjendja e pasurive dhe çdo angazhim apo të ardhura *deri në datën e fillimit të punës të vitit* të deklaramit. Pra, rezultoni se personi i lidhur ka dhënë deklarim duke pasur parasysht faktin se, deri në datën e dorëzimit të deklaramit, detyrimi ndaj shoqërisë “N.” sh.p.k. ishte shlyer tërësisht.

Lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në vlerën 32 000 euro, sipas kontratës nr. (***) rep., datë 21.7.2005, rezultoni se kredia e marrë në “NBG” në shumën 23.000 euro ka shlyer huan e marrë z. F. Sh. në vitin 2004 dhe kjo hua ka shërbyer si burim krijimi për një pjesë të vlerës së apartamentit, ndërkohë që, në lidhje me *kursimet*, në shumën 9.000 euro, të deklaramit si burim i pjesës tjetër të mbetur të vlerës së apartamentit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve ka konfirmuar se për vitet 2004 dhe 2005, bashkëshortja e subjektit ka pasur qarkullim nga shërbime të kryera, si në vijim: në vitin 2004 vlera 700.000 lekë, paguar tatim fitimi 45.000 lekë, fitimi *neto* 655.000 lekë / $126.74 = 5.168$ euro dhe në vitin 2005 vlera 1.200.000 lekë, paguar tatim fitimi 35.043 lekë, *fitimi neto* 1.165.957 lekë / $122.54 = 9.515$ euro, në një total të ardhurash në shumën 1.820.957 lekë ose 14.683 euro, çka tregon se personi i lidhur ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shumën 9.000 euro për blerjen e pasurisë së paluajtshme.

Lidhur me destinacionin e shpenzimit të kredisë prej 23.000 eurosh, për huan e marrë në vitin 2004, trupi gjykues çmon se shpjegimi i subjektit ka të bëjë me veprime të ndërmjetme (zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik/periudhë) nuk është bindës, pasi nuk ka “*praktika të zëvendësimit të debitorit*” – pa miratimin paraprak të kreditorit).

Lidhur me këtë situatë, trupi gjykues duke pasur në konsideratë faktet dhe provat se: (i) kemi të bëjmë me veprime të personit të lidhur të dokumentuara që në vitin 2004¹⁴; (ii) transaksione bankare të shlyerjes së kësaj huaje po në këtë vit, kohë në të cilën subjekti nuk ka qenë në martesë me personin e lidhur; (iii) shlyerja e huas me kredinë bankare ishte kryer me burime të ligjshme, Komisioni, konkludon se jemi përpara një pasaktësie në deklarim të personit të

¹³ Deklarimi para fillimit të detyrës.

¹⁴ Deklarata noteriale e viti 2004 e shtetasit F. Sh. .

lidhur dhe, për rrjedhojë, edhe të subjektit të rivlerësimit, por që nuk e cenon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave.

2.1.16 Në vijim të hetimit, transkasionet pasurore që personi i lidhur ka kryer deri në momentin e përfitimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pasurinë nr. 2 të deklaruar në deklaratën “Vetting”, ka rezultuar si më poshtë:

2.1.17 Në deklaratën periodike të vitit 2007, personi i lidhur ka deklaruar pakësime, pasi ka shitur pasurinë shtëpi banimi, me sip. 110 m², Tiranë, argumentuar më sipër, në një vlerë prej 50.000 eurosh; pjesa takuese: 100 %.

2.1.18 Për të provuar këtë transaksion subjekti i rivlerësimit, në dokumentet shkresore shoqëruese të deklaratës “Vetting” të vitit 2017, ka depozituar kontratën e shitjes (me rezervë) nr. (***) datë 23.4.2007, mes shitëses M. K. dhe blerësit Xh. M., për shitjen e një apartamenti me sip. 102 m² (pra, apartamentit të mësipërm i shtohen edhe 2.35 m²) kundrejt çmimit 50.000 euro.

2.1.19 Komisioni, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve, konstatoi se mënyra e pagesës parashikohej 20.000 euro të parapaguara përpara nënshkrimit dhe 30.000 euro, deri në datën 30.10.2007, me marrjen e çelësve në dorë. Përveç këtij fakti, vërehej se në këtë kontratë, nuk deklarohet kalim pronësie, por parashikohej: “...plotësimi i dokumentacionit ligjor dhe teknik dhe dorëzimi i tyre tek blerësi do të jetë mënyra për të kaluar pronësia, për shkak se edhe pala shitëse deklaroi se, sendin objekt të kësaj kontrate e ka fituar me kontratë sipërmarrje me shoqërinë tregtare dhe jo me akt noterial për kalim pronësie”.

2.1.20 Në lidhje me qartësimin e situatës së marrëdhënies mes personit të lidhur dhe shtetasit Xh. M., si dhe të pagesës efektive dhe të mënyrës së likuidimit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar: “Mëqenëse apartamenti i blerë nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr(***)rep., datë 21.7.2005 kishte qenë në gjendjen karabina, gjatë periudhës 2006 –prill 2007, znj. M. K., iu desh të bënte punime me qëllim përfundimin e objektit [në momentin e lidhjes së kontratës kishin mbetur dhe disa punime të papërfunduara, si vendosja e dritareve dhe veshja me pllaka e tualetit]. Me marrjen e kështit të parë këto punime u përfunduan dhe në datën 12.5.2007 blerësi ka paguar cash shumë prej 30.000 eurosh, duke marrë çelësat e apartamentit në dorë.

Në kontratën e shitjes së apartamentit me rezervë nr. (***) datë 23.4.2007, ishte marrë përsipër që shoqëria sipërmarrëse “N.” sh.p.k. t’i dorëzonte dokumentacionin teknik dhe ligjor blerësit. Me pagesën e shumë prej 50.000 eurosh nga blerësi në maj 2007, pasi është bërë dorëzimi i çelësve të apartamentit këtij të fundit, është vënë në dijeni administratori i shoqërisë “N.” sh.p.k., z. Xh. N., me qëllim kalimin e pronësisë në emër të blerësit, z. Xh. M. . Ndërkohë, shoqëria nuk kishte përfunduar me procesin e regjistrimit të godinës ku ndodhej apartamenti dhe, pavarësisht se apartamenti zotërohej nga blerësi z. Xh. M., procesi i kalimit të pronësisë te blerësi është realizuar disa muaj më vonë. Në lidhje me shitjen e këtij apartamenti (e drejtë reale) te z. Xh. M., tatimi në burim është deklaruar në datën 23.1.2017 dhe është paguar në datën 24.1.2017. Kjo pagesë¹⁵ është kryer në këtë datë, pasi gjatë procesit të mbledhjes së dokumentacionit, me qëllim plotësimin e deklaratës “Vetting” të vitit 2017, u konstatua se nuk ishte paguar tatimi në lidhje me këtë veprim juridik dhe, menjëherë kemi përmbushur këtë detyrim ligjor duke iu referuar normës aktuale të taksimit, për sa i përket shitjes së pasurive të paluajtshme (50.000 euro – 32.000 euro) x 15 % x 140 lekë/euro = 378.000 lekë”.

¹⁵ Referojuni deklaratës së tatimit në burim sipas të cilës është paguar shuma prej 378.000 lekësh.

2.1.21 Komisioni, bazuar në të dhënat e ZVRPP-së Tiranë, konstatoi se shtetasi Xh. M. ishte bërë pronar i një apartamenti banimi me sip. 92,1 m², pasuria (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , bazuar në një kontratë shitblerjeje drejtpërdrejt nga shoqëria “N.” sh.p.k., kundrejt shumës 3.710.000 lekë. Nuk rezultonte që nga marrëdhënia mes këtyre të dyve të ishte deklaruar se pagesa mund të ishte kryer nëpërmjet bashkëshortes së subjektit. Nga ana tjetër, pas verifikimit për transaksionet e kësaj shoqërie ndërtimi në këtë godinë, rezultoi se për apartamentet me të njëjtin kompozim dhe sipërfaqe, ajo kishte aplikuar afërsisht të njëjtin çmim në shitje: 3.700.000 deri në 3.800.000 lekë. Në të gjitha kontratat, palët deklarorin se ishin shlyer jashtë zyrës noteriale.

2.1.22 Nisur nga rrethanat faktike të pikës 2.1.21, por edhe nga shpjegimet e subjektit për pagesën e tatimit të kësaj të ardhure, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet e tij, pasi: (i) deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting”, lidhur me burimin e të ardhurave të shumës 30.000 euro nga shitja e apartamentit shtetasit Xh. M. (deklaruar nga personi i lidhur në deklaratat vjetore periodike të vitit 2005), nuk provohej me asnjë dokument ligjor; (ii) pagesa e tatimit në vitin 2017 në shumën prej 378.000 lekësh për kalimin e pronësisë nga znj. M. K. te z. Xh. M. në vitin 2007 dukej e paqartë, pasi nga subjekti nuk ishin depozituar dokumente provuese sa i takonte: (a) kontratës dhe dokumenteve që ishin vlerësuar nga administrata tatimore për përlllogaritjen e tatimit; (b) metodologjisë së zbatuar nga administrata tatimore për të përcaktuar se detyrimi tatimor ishte në vlerën 378.000 lekë; (c) kohës që kishte lindur detyrimi; (ç) penalteteve të mundshme ose kufizimeve për pagesa të vonuara etj.

2.1.23 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave të depozituara në datën 16.4.2019, ndër të tjera ka argumentuar¹⁶ se:

2.1.24 Realizimi i kalimit të pronësisë drejtpërdrejt nga shoqëria “N.” sh.p.k. ishte një kusht i vendosur në kontratën e shitjes së apartamentit me rezervë nr. (***) , datë 23.4.2007, dhe kjo gjë ishte konstatuar edhe nga Komisioni. Madje, në dokumentacionin e administruar nga verifikimet e Komisionit, përmes shkresës nr. (***) prot., datë 9.10.2018 te noteri publik, ka rezultuar që bashkëlidhur kontratës noteriale, ishte dhe dokumentacioni i lejes së ndërtimit të shoqërisë sipërmarrëse “N.” sh.p.k., gjë që vërtetonte ende edhe më shumë se procesi i shitjes me rezervë nga znj. M. K. te z. Xh. M. kishte të bënte pikërisht me apartamentin e përfituar me kontratën e porosisë nr. (***) rep., datë 21.7.2005, nga shoqëria “N.” sh.p.k. Gjithashtu, nuk rezultoi ndonjë pagesë çmimi nga z. Xh. M. kundrejt shoqërisë “N.” sh.p.k. në lidhje me këtë apartament. Shoqëria “N.” sh.p.k., të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti i ka marrë në vitin 2005 nga znj. M. K., ndërsa z. Xh. M. për këtë apartament kishte shlyer shumën 50.000 euro ndaj znj. M. K. . Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. (***) kol, nr. (***) , datë 13.4.2019, sipas të cilës z. Xh. M. konfirmon pagesën e shumës së plotë prej 50.000 eurosh (me dy këste) ndaj znj. M. K., si dhe faktin që nuk kishte pasur asnjëherë një marrëdhënie pagese me shoqërinë “N.” sh.p.k.

Gjithashtu, për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka depozituar: (i) njoftimin e datës (***)/2007 të bërë nga ana e bashkëshortes në gazetën “Çelësi”, për shitjen e këtij apartamenti, gjë që vërtetohet nga adresa dhe të dhënat e apartamentit të nxjerrë për shitje, si dhe nga numri i telefonit, i cili sipas subjektit është në përdorim nga nëna e bashkëshortes; (ii) shkresën nr. (***) prot., datë 19.10.2018, të OSHEE-së në lidhje me kodin e klientin TR(***) në emër të znj. M. K., në datën 16.4.2007, si një fakt tjetër vërtetues në lidhje me këtë apartament. Ndërsa për konstatimin e Komisionit se për apartamentet me të njëjtin kompozim dhe sipërfaqe shoqëria “N.” sh.p.k. ka aplikuar afërsisht të njëjtin çmim në shitje: 3.700.000 – 3.800.000 lekë, subjekti ka parashtruar se, edhe pse nuk mund të ishte në përgjegjësinë e individit blerës mënyra e deklarimit të shoqërisë për kontratat e tjera, ka depozituar një kontratë të ngjashme nr. (***) ,

¹⁶ Referojuni shpjegimet e subjektit te dërguar me *e-mail-in* e datë s 16.4.2019.

datë 19.11.2007, sipas të cilës çmimi i shitjes së apartamentit për sip. 71.9 m² + 22 m² sipërfaqen e përbashkët është 5.090.000 lekë, pra, një çmim më të lartë se çmimi 3.800.000 lekë.

2.1.25 Në lidhje me rezultatin tjetër të hetimit – se dukej e paqartë pagesa e tatimit në vitin 2017, në shumën 378.000 lekë, për kalimin e pronësisë nga znj. M. K. te z. Xh. M. në vitin 2007, pasi nuk ishte depozituar dokumente provuese – subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: “...kemi të bëjmë me vetëdeklarim nga bashkëshortja dhe nuk kemi të bëjmë me vlerësim nga administrata tatimore, për rrjedhojë, nuk ka metodologji të përdorur nga kjo administratë në lidhje me llogaritjet e mësipërme. Pagesa e tatimit për këto të ardhura ishte kryer nga ana e tyre gjatë plotësimit të deklaratës “Vetting” të vitit 2017, në datën 23.1.2017 dhe, në kushtet që deklarata e muajit janar nuk ishte shfaqur ende në sistemin tatimor, u deklarua si e ardhur neto për muajin dhjetor 2016. Nga të gjitha verifikimet që mund të bëhen pranë Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, mund të verifikohet lehtësisht se në periudhën dhjetor 2016 nuk kishte pasur asnjë transferim pasurie të paluajtshme nga bashkëshortja te ndonjë individ tjetër, person fizik ose person juridik, për rrjedhojë, pagesa e këtij tatimi në shumën 378.000 lekë i përket pikërisht veprimeve juridike të shpjeguara më lart. Koha për të cilën kishte lindur ky detyrim është muaji prill 2007, por duke qenë se për atë periudhë në sistemin tatimor nuk ekzistonte deklarata e tatimit në burim, është proceduar me deklarimin dhe pagesën e këtij detyrimi në periudhën aktuale, pra, për muajin dhjetor 2016. Duke qenë një vetëdeklarim i bashkëshortes për këtë detyrim tatimor në momentin e konstatimit, administrata tatimore nuk mund të bënte vlerësim për periudhën tatimore prill 2007 për detyrime tatimore, e të përlllogariste kamatvonesat apo penalitetet, pasi kjo e drejtë është parashkruar, bazuar në pikën 1, të nenit 73, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet: “1. E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor parashkruhet brenda 5 viteve nga data e fundit e dorëzimit të deklaratës tatimore, fillestare ose të ndryshuar, të përcaktuar në legjislacionin tatimor përkatës”.

2.1.26 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e provave, duke mbajtur në konsideratë: (i) deklaratën noteriale të shtetasit Xh. M. për pagesën e shumës së plotë prej 50.000 eurosh (me dy këste); (ii) faktin se kjo deklarata noteriale nuk bie në kundërshtim me veprimin juridik, me kontratën e shitjes (me rezervë) nr. (***), datë 23.4.2007; (iii) deklarimi i shtetasit Xh. M. përputhet plotësisht me deklarimin e personit të lidhur në deklaratën periodike të vitit 2007; (iv) provat e depozituara nga subjekti në lidhje me vërtetësinë e transaksioneve të ndodhura mes palëve; dhe (v) kohën kur ka ndodhur ky transaksion, kur subjekti nuk ka qenë në martesë me personin e lidhur, çmon se burimi i të ardhurave për shumën 30.000 euro është kontrata e shitjes me rezervë të apartamentit nr. (***), datë 23.4.2007, me çmim shitjeje në total 50.000 euro, si dhe subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme bindëse për burimin e tyre.

Lidhur me pagesën e tatimit me vonesë, trupi gjykues, bazuar në pikën 19, të nenin 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Të ardhura të ligjshme janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Për tatimin për të ardhurat””, çmon se edhe pse këto të ardhura janë përfituar nga bashkëshortja në kohën kur subjekti nuk ka qenë në martesë, pagesa e këtij tatimi përpara dorëzimit të deklaratës “Vetting” përmbush kriterin ligjor të burimit të ligjshëm të konfirmuar nga deklarata noteriale e blerësit, si dhe të të ardhurës neto, pasi për shumën në fjalë është shlyer detyrimi tatimor.

2.2 Në vijim të hetimit të transaksioneve që personi i lidhur ka kryer me pasuritë, deri në momentin e përfitimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë nr. 2

(shitesë apratamenti + garazh), të deklaruar në deklaratën “Vetting”, ka vijuar si më poshtë:

2.2.1 Në deklaratën periodike të vitit 2007 personi i lidhur ka deklaruar blerjen e një shtëpie banimi me sip. 126,5 m², në Rr. “R. P.”, Tiranë, me vlerë 48.070 euro, me pjesë takuese: 100 %, pa deklaruar burimin e krijimit, si dhe në pjesën e detyrimeve subjekti *nuk ka deklaruar* detyrim të pashlyer për këtë pasuri.

2.2.2 Për të provuar këtë transaksion në materialet shpresore shoqëruese të deklaratës “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e porosisë nr. (***), datë 21.5.2007, mes porositëses M. K. dhe shoqërisë sipërmarrëse “U.” sh.p.k., për ndërtimin e një apartamenti me sip. 126,5 m², kundrejt çmimit 380 euro/m², me vlerë të përgjithshme 48.070 euro, nga të cilat, në momentin e nënshkrimit u likuidua shuma 47.070 euro, jashtë zyrës noteriale.

2.2.3 Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë ka konfirmuar në emër të bashkëshortes së subjektit pronësinë e pasurisë me sip. 115,8 m² me pasurie nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), sipas kontratës së shitjes nr. (***), datë 8.4.2008, me palë shitëse shoqërinë “U.” sh.p.k. dhe me palë blerëse M. K. . Sipas kësaj kontrate rezultonte se vlera e shitjes së kësaj pasurie ishte në shumën 43.370 euro.

2.2.4 Nga aktet e mësipërme, dy kontratat (e porosisë dhe e shitblerjes), Komisioni konstatoi mospërputhje në çmimin dhe në shumën e paguar, në raport me vlerën e deklaruar në deklaratën periodike të personit të lidhur, pasi i rezultoi se: në deklaratën periodike të vitit 2007 deklarohet se ishte paguar shuma 48.070 euro; në kontratën e porosisë nr. (***), datë 21.5.2007, deklarohet se ishte paguar shuma 47.070 euro; ndërsa në kontratën e shitjes nr. (***), datë 8.4.2008, deklarohet se ishte paguar shuma 43.370 euro.

2.2.5 Në lidhje me çmimin e saktë, burimin e të ardhurave, shumën efektive të paguar dhe mënyrën e pagesës subjekti, gjatë hetimit administrativ, deklaroi se për blerjen e apartamentit me sip. 126.5 m², nga znj. M. K., sipas kontratës së porosisë nr. (**) në shoqërinë sipërmarrëse “U.” sh.p.k. kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes me rezervë nr. (***), datë 23.4.2007, nga znj. M. K. në shumën 50.000 euro.

Në total shuma e paguar *cash* ishte 48.070 euro, sipas mandatarkëtimit nr. (***), datë 24.4.2007 në shumën 1.500.000 lekë (konvertuar në euro: 11.811 euro) dhe mandatarkëtimit nr. (***), datë 21.5.2007, në shumën 4.604.893 lekë (konvertuar në euro: 36.259 euro). Shuma 47.070 euro është lapsus i noteres dhe mund të vihet re që nuk ishte cilësuar se kur do të paguhej shuma tjetër prej 1.000 eurosh.

Kjo ishte e njëjta pagesë dhe nuk ka pasur kthim shume nga shoqëria “U.” sh.p.k. te znj. M. K. pasi shuma 43.370 euro në kontratën e shitblerjes nr. (***), datë 8.4.2008 duhet të ishte 48.070, por kjo shumë është vendosur gabim nga noterja. Kjo kontratë kishte shërbyer si akt formal për kalimin e pronësisë nga shoqëria “U.” sh.p.k. te znj. M. K., pasi çmimi i apartamentit dhe pagesat ishin kryer sipas mandatpagesave përkatëse nr. (***), datë 24.4.2007 dhe nr.(***), datë 21.5.2007, të shoqërisë “U.”.

2.2.6 Çmimi prej 48.070 eurosh dhe mënyra e pagesës sipas mandatarkëtimeve nr. (***), datë 24.4.2007, dhe nr. (***), datë 21.5.2007, konfirmohet edhe nga shoqëria “U.” sh.p.k.

2.2.7 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisioni konstatoi se: (a) deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” (në pjesën sqaruese) lidhur me çmimin dhe me mënyrën e pagimit të shumës 48.070 euro për blerjen e apartamentit nga shoqëria “U.” sh.p.k. (me sip. 115,8 m², pasuria nr(***), vol. (***), f. (***), z.k. (***)), përputhej me rezultatet e

hetimit administrativ, sipas dokumentacionit të administruar; (b) Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për mospërputhjet e sipërfaqes dhe të çmimit të kësaj pasurie, pasqyruar në kontratën e porosisë dhe në kontratën e shitjes, për të cilat subjekti gjatë hetimit administrativ deklaroi se ishin lapsuse të noterës publike.

2.2.8 Subjekti i rivlerësimit, në datën 16.4.2019, për konstatimin e Komisionit në lidhje me lapsuset e bëra nga noterja, ka depozituar deklaratën noteriale nr. (***) , datë 8.4.2019, të noterës publike A. M. .

2.2.9 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e të provave, duke mbajtur në konsideratë: (i) se personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën periodike 2007, se kjo pasuri ishte blerë në çmimin 48.070 euro; (ii) se provat/mandatpagesat që konfirmojnë çmimin e paguar po në shumën 48.070 euro; (iii) faktin se në kontratën e porosisë pasqyrohet sipërfaqja më e lartë (126.5 m²) se ajo e pasqyruar në kontratën e shitjes (115.8 m²); (iv) faktin se këto transaksione pasurore janë kryer dhe deklaruar nga bashkëshortja e subjektit po sipas pagesave efektive (*kohë kur ky i fundit nuk ka qenë në martesë*), çmon se nuk ka dyshime për burimin e ligjshëm.

2.2.10 Në vijim të hetimit administrativ, për këtë pasuri rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në deklaratën periodike 2016, kanë deklaruar shitjen e apartamentit me sip. 115,8 m², sipas kontratës nr. (***) , datë 17.11.2016, në vlerën 130.000 euro.

2.2.11 Nga “Intesa Sanpaolo Bank” konfirmohet fakti i transferimit të shumës 130.000 euro nga llogaria e noterit publik në llogarinë e bashkëshortes, në zbatim të kontratës së mësipërme.

2.2.12 Nga analizimi i akteve të mësipërme, Komisioni konstatoi se nga çmimi i blerjes dhe i shitjes rezultonte një diferencë fitimi prej 81.930 eurosh nga ky transaksion, shkak për të cilin subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime për tatimin e paguar dhe për mënyrën e pagesës. Subjekti ka parashtruar se: ishte kryer rivlerësim i pasurisë, i apartamentit me sip. 115.8 m² në shumën 18.500.000 lekë sipas aktit të rivlerësimit, vërtetuar me dokumentin hipotekor të datës 5.1.2012 dhe për këtë rivlerësim është paguar tatimi 1 % për diferencën (çmim i rivlerësuar – çmim blerjeje, pra: 18.500.000 – 5.330.173 = 13.169.827 lekë), pra, është paguar tatimi në shumën 131.698 lekë, në datën 20.12.2011, në “Credins Bank”; në momentin e shitjes së këtyre apartamenteve me çmimet përkatësisht, 110.000 euro dhe 130.000 euro, nuk i kalojnë vlerat e rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, nuk rezulton të ketë pasur detyrimin për të paguar tatim mbi të ardhurat. Gjithashtu, subjekti ka depozituar dokumentacion për rivlerësimin e realizuar, pagesën e tatimit, si dhe regjistrimin në regjistrin hipotekor.

2.2.13 Për shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e depozituar, Komisioni konstatoi se rivlerësimi i apartamentit në shumën 18.500.000 lekë, ishte pasqyruar edhe në kartelën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në Tiranë.

2.2.14 Lidhur me pagesën e tatimit, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në bazë të shkronjës b, të pikës 3, të nenit B, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka dërguar “mendim”, lidhur me procedurën e ndjekur nga bashkëshortja e subjektit, për sa i përket përfitimit sipas ligjit nr. 10418/2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, pasi pika 3, e nenit 18, të këtij ligji përjashton zyrtarët shtetërorë, të cilët janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, nga faljet e detyrimeve tatimore të rregulluara në kreun III të ligjit, sikurse ka qenë bashkëshortja e subjektit. Në kreun III, “Falja e detyrimeve tatimore dhe doganore”, përfshihet edhe neni 27 i këtij ligjit, që ka të bëjë me rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme për individët.

2.2.15 Komisioni për këtë çështje ligjore të dërguar si “*mendim*” nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, i kërkoi opinion ligjor Ministrisë së Financave, e cila dha opinionin¹⁷ përkatës.

2.2.16 Nga analiza e fakteve e provave të sipërpërmendura për burimin e shumës 130.000 euro që kishte shërbyer për krijimin e pasurisë nr. 2, Komisionit konstatoi se: (a) deklarimi i subjektit në deklaratën “*Vetting*”, se burimi i shumës 130.000 euro ishte krijuar nga shitja e apartamentit (me sip. 115.8 m², të blerë më parë nga shoqëria “U.” sh.p.k.), *përputheshin* me rezultatet e hetimit administrativ; (b) ndërkohë, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime nëse bashkëshortja e tij kishte apo jo të drejtë të rivlerësonte pasurinë bazuar në ligjin nr. 10418/2011, me qëllim përlllogaritjen e detyrimit tatimor (në rast të shitjes eventuale në të ardhmen të apartamentit) sipas kreut III të tij, në të cilin përfshihej pika 10 e nenit 27.

2.2.17 Subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve dhe provave të depozituara në datën 16.4.2019, ka parashtruar¹⁸ një analizë të detajuar të dispozitave ligjore në fuqi, duke konkluduar se bashkëshortja e tij ka pasur të drejtë të rivlerësojë pasurinë e paluajtshme në pronësi të saj, bazuar në ligjin nr. 10418, datë 24.4.2011, i ndryshuar.

2.2.18 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e të provave, të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10418, datë 24.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 12, datë 18.11.2011, i cili ka parashikuar procedurën e zbatimit të këtij ligji, lidhur me këtë çështje arsyeton:

Qëllimi i ligjit nr. 10418, datë 24.4.2011, ka synim të rregullojë situatën e sasive të mëdha të parave dhe të asetëve që qarkullojnë *jashtë sistemit të kontrollit fiskal*, situatë e krijuar si rezultat i detyrimeve të maturuara por të pashlyera ndaj shtetit (*detyrime tatimore, doganore, gjoha, kontribute sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore, taksa në fusha të ndryshme etj.*), si dhe si rezultat i referencave ligjore të transaksioneve për asetet, të cilat kanë regjistrim nëpër regjistrat publikë në një periudhë shumë të hershme dhe me një çmim referimi ligjor me diferencë të madhe nga çmimi i referimit të momentit të regjistrimit të mëparshëm.

Rezulton se në nenet 36 dhe 37 të këtij ligji parashikohet dalja e aktit nënligjor për procedurën e zbatimit për përfitimin nga procesi i legalizimit të kapitalit dhe për zbatimin e tij, ku është përfshirë edhe neni 27, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, i cili është formalizuar me udhëzimin nr. 12, datë 18.5.2011, të Ministrisë së Financave.

Rezulton se kreu I i këtij ligji identifikon si përfitues të tij subjektet: individët, personat fizikë, si dhe personat juridikë. Në kreun II, të nenit 5, të ligjit, ligjvënësi ka përcaktuar kategoritë e subjekteve që përfitojnë nga procesi i legalizimit të kapitalit. Në një lexim *stricto sensu* të dispozitave ligjore të neneve 8-11, trupi gjykues vlerëson se legalizimi i kapitalit të *individëve dhe të personave fizikë* ka të bëjë me deklarinimin për zotërimin e shumave në të holla, ndërsa legalizimi i kapitalit për personat juridikë lidhet me deklarinimin e diferencës që rezulton nga rivlerësimi i pasurisë. Në këtë kuptim, rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme konsiderohet legalizim i kapitalit vetëm për personat juridikë, por jo për individët. Trupi gjykues vlerëson se përjashtimi nga përfitimi i lehtësive që parashikon kreu I i ligjit: “...se ata individë, të cilët, në përputhje me legjislacionin e fushës, i nënshtrohen detyrimit ligjor për deklarinimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”, lidhet ngushtësisht me faktin se individët zyrtarë deklarues në ILDKPI nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga legalizimi

¹⁷ Referojuni shkresës përkatëse.

¹⁸ Referojuni parashtrimet e subjektit të datës 16.4.2019.

i kapitalit, pra, nuk kanë të drejtë të deklarojnë zotërimin e shumave në të holla të padeklaruara më parë, pasi ata i nënshtrohen detyrimit ligjor të deklarimit të pasurive për ligjshmërinë e tyre. Ndërsa rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme nuk është pjesë e zbatimit të këtij përjashtimi, duke qenë se nuk konsiderohet “*legalizim i kapitalit*” për individët. Gjithashtu, referuar nenit 35¹⁹ për “Kohën e zbatimit”, rezulton se koha e parashikuar për legalizimin dhe faljen shtrihej deri në datën 31 dhjetor 2013, ndërkohë që për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme nga individët, në përputhje me nenin 27 të po këtij ligji, mund të realizohej deri në datën 31.8.2012”. Nga interpretimi *ad literam* i ligjit vërehet se në pikën 1, të nenit 18 të tij, janë parashikuar subjektet përfituese dhe këtu ligji i referohet “*kreut*”, “*..Nga falja e parashikuar në këtë kre përfitojnë:...*”, kurse, për sa i përket subjekteve që përjashtohen, pika 3, e nenit 18, nuk përdor të njëjtën terminologji (“*Nga falja e parashikuar në këtë kre përjashtohet...*”), por kjo dispozitë ligjore i referohet vetëm përjashtimit nga detyrimet tatimore dhe doganore dhe konkretisht “*Nga falja e detyrimeve tatimore dhe doganore përjashtohen...*” duke vërtetuar se qëllimi i ligjbërësit ka qenë vetëm përjashtimi i individëve deklarues në ILDKPKI nga e drejta për të përfituar nga falja e detyrimeve tatimore dhe doganore. Sipas kësaj dispozite, nga falja e detyrimeve përjashtohen si zyrtarët (individët apo personat fizikë), ashtu edhe personat juridikë, nëse zyrtarët kanë kuota kapitali te këta persona. Dispozita ligjore e nenit 19 përcakton *detyrimet* tatimore që falen, ku përfshihen *detyrimet “e papaguara”* dhe ato “*të prapambetura*”. Nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite (në të cilën konstatohet përdorimi i termit dhe konceptit “*detyrim*”, që dallon dhe është e kundërta e termit dhe konceptit “*e drejtë*”), konstatohet se rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme është një “*e drejtë*” e individit dhe jo një “*detyrim*” të cilin mund ta shmangësh, duke përfituar nga falja e tij sipas këtij ligji.

Fakti se rivlerësimi i pasurisë është një e drejtë e çdo individit është parashikuar edhe në udhëzimin nr. 12, datë 18.5.2011, të Ministrisë së Financave, ku në pikën 1, të kreut III, citohet: “*...Nga kjo e drejtë përfitojnë të gjithë shtetasit që zotërojnë pasuri të paluajtshme pa asnjë kufizim*. Sipas këtij arsytimi trupi gjykues gjen edhe mendimin²⁰ e dhënë nga ²¹ Ministria e Financave dhe e Ekonomisë e, për rrjedhojë, çmon se aplikimi i ligjit nr. 10418, datë 24.4.2011, për sa i përket rivlerësimit të pasurive të paluajtshme është një e drejtë e çdo individit, sikurse dhe e bashkëshortes së subjektit.

3. Për deklarimin në lidhje me apartamentin e banimit (dupleks) me sip. 205.33 m² dhe truallin me sip. 521,08 m², me adresë: Kompleksi Rezidencial “L.” (buzë plazhit të Gjirit të Lalzit), I, Durrës; pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), Durrës; sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 4.6.2012, dhe më pas, sipas kontratës së shitjes nr. (***), datë 20.8.2015; vlera e blerjes së apartamentit 82.132 euro; Vlera e blerjes së truallit 956.457 lekë; pjesa takuese e subjektit: 50 %; me burim krijimi të deklaruar:

Vlera 35.000 euro, të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 48,27 m², me nr. pasurie (***), z.k. (***), sipas kontratës nr. (***), datë 27.5.2011; adresa: Komuna Sh., L., për të cilin subjekti ka sqaruar në deklaratën “Vetting” se:

- Apartamenti me sip. 48.27 m² është blerë në shumën 2.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 25.1.2010. Shuma: 2.000.000 lekë, e blerjes së këtij apartamenti

¹⁹ E drejta e subjekteve që të përfitojnë nga legalizimi dhe falja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2013”, ndërkohë ligji parashikon se “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme nga individët, në përputhje me nenin 27 të këtij ligji, mund të realizohet deri në datën 31.8.2012”.

²⁰ Nr. (***), prot., datë 14.2.2019.

²¹ Pika 3, e nenit Ç, e Aneksit të Kushtetutës parashikon se institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë bashkëpunojnë me Komisionin e Kolegjin e Apelit, duke vënë në dispozicion të tyre çdo informacion... Ata mund të japin mendime ose të bëjnë propozime konkrete, sipas ligjit.

është marrë nga vendimi nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Vendimi, nr. (***) akti dhe nr(***)vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka të bëjë me pjesëtimin e pasurisë apartament të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. (***), datë 3.6.2002, ndodhur në adresën: Rr. “M. Gj.”, p. (***), k. (***), Tiranë. Ky apartament është blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 6.12.2003, nga të ardhurat familjare të krijuara gjatë viteve 1999 – 2003.

Vlera 30.000 euro, kursime të bashkëshortes të krijuara përpara martesë (të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, të realizuara nga shitja e shtëpisë private me 2 kate + papafingo 268,2 m² + truall me sip. 330 m², pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në shumën 220.000 euro), sipas kontratës nr. (***), datë 9.6.2008. me adresë: Rr. “M. K.”, pranë F. B., Q., L., Tiranë.

3.1 Për të vërtetuar burimin e shumës 35.000 euro, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. (***), datë 6.12.2003, midis palëve shitëse S. S. dhe palës blerëse Kastriot Selita dhe A. S., për blerje apartamenti, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. (***), datë 3.6.2002; vlera e blerjes: 2.000.000 lekë.
- Aktmarrëveshje datë 6.6.2006, për pjesëtim me marrëveshje të pasurisë mes znj. A. Gj. (ish-bashkëshortes) dhe z. Kastriot Selita.
- Vendim nr. (***), datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore.
- Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. (***), datë 25.1.2010, me palë shitëse shoqërinë “C.” sh.p.k., me administrator F. C. dhe me palë blerëse Kastriot Selita për shitjen e apartamentit me sip. 48.27 m², me nr. pasurie (***), në komunën Sh. të Lezhës; vlera: 2.000.000 lekë.
- Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, nr. (***), datë 24.5.2011, me palë shitëse Kastriot Selita dhe palë blerëse M. I., për shitjen e apartamentit me sip. 48.27 m², me nr. pasurie (***), z.k. (***), të ndodhur në lagjen “B.”, Lezhë; vlera: 35.000 euro dhe 3.000 euro mobilim.
- Shkresë nr. (***) prot., datë 18.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Shkresë nr. (***) prot., datë 6.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 23.1.2017, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të ardhurat *neto* të personit të lidhur nga paga e vitit 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shumën 1.150.331 lekë.
- Kontratë nr. (***), datë 19.9.2013, mes qiradhënëses M. K. dhe qiramarrëses E. Sh. .
- Kontratë nr. (***), datë 19.11.2014, mes qiradhënëses M. K. dhe qiramarrëses E. Sh. .
- Kontratë nr. (***), datë 20.9.2013, mes qiradhënësve Kastriot Selita e M. K. dhe qiramarrësit Sh. L. .
- Shkresë nr. (***) dhe (***) prot., datë 25.1.2017, “Konfirmim pagesa tatim burimi” të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 26.1.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, për të ardhurat *neto* të subjektit nga paga për periudhën 4.11.2013 – 10.1.2017, si gjyqtar në Gjykatën e Administrative të Apelit, në shumën 4.960.873 lekë.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 20.1.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të ardhurat *neto* të personit të lidhur nga paga e vitit 2014 në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj, në shumën 1.197.935 lekë;
- Kontratë shitblerjeje mjeti rrugor nr. (***), datë 30.10.2014, mes shitëses M. K. dhe blerësit A.M. B. (me shtetësi egjiptiane), kundrejt çmimit 400.000 lekë.

3.2 Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

3.2.1 Në lidhje me shumën 35.000 euro, hetimi ka synuar që të zbardhë saktësinë e deklaratës “Vetting” dhe të deklarimeve periodike vetore pasurore, si dhe të përcaktojë për ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie (*shuma 35.000 euro*) nga subjekti i rivlerësimit, duke nisur që në origjinë, në gjendjen pasurore dhe financiare të familjes së tij, në momentin e krijimit të asetit të parë (apartament me sip. 73 m² në rrugën “M. Gj.”), i cili pas procedurave gjyqësore të pjesëtimit të pasurisë (me ish-bashkëshorten), krijoi mjetet financiare në shumën 2.900.000 lekë për blerjen e apartamentit nga shoqëria “C.” sh.p.k., apartament që më pas iu shit blerësit M. I. në shumën 38.000 euro (*nga të cilat 3.000 euro për mobilimin e tij*).

3.2.2 Sipas deklaramit të subjektit në deklaratën “Vetting”, rezulton se subjekti ka sqaruar se ky burim është krijuar nga shitja e apartamenti me sip. 48,27 m² në Lezhë, i cili është blerë me të ardhurat në shumën 2.000.000 lekë, marrë nga vendimi nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kishte të bënte me pjesëtimin e pasurisë apartament në Tiranë, të blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 6.12.2003, nga të ardhurat familjare të krijuara për periudhën 1999 – 2003, në shumën 2.000.000 lekë.

3.2.3 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2003 subjekti ka deklaruar pasurinë shtëpi banimi/apartament me nr. (***) regjistri hipotekor, datë 30.12.2003, ndodhur në adresën Rr. “M. Gj.”, p. (***), Tiranë; me vlerë 2.000.000 lekë; pjesa takuese: 50 %; me kontratë blerjeje nr. (***), datë 6.12.2003, me burim: kursime familjare. Po në këtë vit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e tij si gjyqtar/kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në shumën 1.080.000 lekë dhe pagat e ish-bashkëshortes si juriste në Degën e Tatim Taksave Durrës në shumën 450.000 lekë.

3.2.4 Në përgjigjet e datës 14.8.2018, subjekti ka deklaruar: *“Data e shkëputjes nga trangu i familjes me prindërit e mi është data 19.11.2002”*. Rezulton se deri në këtë datë subjekti ka qenë në të njëjtin trung familjar me prindërit. Pas shkëputjes nga trangu familjar, subjekti së bashku me vëllain e tij, janë zhvendosur në Njësinë Administrative nr. (***), të Bashkisë Durrës, në të njëjtën kartelë familjare.

3.2.5 Nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet fakti se me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. (***), datë 6.12.2003, mes palës shitëse S. D. S. dhe blerësve Kastriot Selita dhe A. S., realizohet kalimi i pronësisë për pasurinë në fjalë kundrejt çmimit 2.000.000 lekë, të paguara jashtë zyrës noteriale.

3.2.6 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar se është zgjidhur martesë, si dhe në bazë të të dhënave të regjistrimit të Gjendjes Civile²² Durrës (ZGJC2), pasqyrohet statusi i subjektit “i divorcuar” sipas vendimit gjyqësor nr. (***), datë 14.9.2005, zbatuar më 3.2.2006.

3.2.7 Me aktmarrëveshjen e datës 6.6.2006 mes palëve Kastriot Selia dhe A. Gj., evidentohet fakti i përfundimit të gjykimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 11.5.2006, në të cilën janë përfshirë apartamenti dhe orenditë shtëpiake. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje palët kanë rënë dakord që apartamenti dhe orenditë të kalojnë në pronësi të palës A. Gj., ndërsa kjo e fundit detyrohej që t’i paguante palës Kastriot Selita shumën prej 2.900.000 lekësh. Kjo marrëveshje parashtrohet në gjykatë, në fazën e dytë të pjesëtimit, e cila, pasi e ka vlerësuar atë të rregullt dhe proporcionale, me vendimin nr. (***), datë 19.6.2006, “Faza e dytë e pjesëtimit”, ka vendosur që ta pranojë atë, duke e bërë pjesë të vendimit.

²² Referojuni shkresës nr. (***), datë 15.10.2018.

3.2.8 Në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, të dhëna nga ish-bashkëshortja, subjekti deklaroi: “*Burimi i ligjshëm i shumës 2.900.000 lekë ishin vendimet²³ e pjesëtimit të pasurisë të cituara më sipër*”.

3.2.9 Për mënyrën e përmbushjes së marrëveshjes së datës 6.6.2006, në deklarimin²⁴ e saj shtetasja V. T., në cilësinë e avokates së subjektit të rivlerësimit, deklaroi se pas miratimit të marrëveshjes së pjesëtimit të pasurive me vendim gjyqësor, ajo kishte qenë personi që kishte marrë fizikisht shumën 2.900.000 lekë nga znj. A. Gj., e cila e kishte tërhequr nga “Raiffeisen Bank” dhe, më pas, avokatja ia kishte dorëzuar subjektit.

3.2.10 Rezulton se “Raiffeisen Bank”²⁵ e ka konfirmuar se shtetasja A. Gj. ka derdhur shumën 2.900.000 lekë në datën 13.6.2006 dhe tërheqjen e po kësaj shume në datën 19.6.2006.

3.2.11 Nga të dhënat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se në periudhën që subjekti ka qenë gjyqtar pranë kësaj gjykate, ka përfituar pagë *neto* shumën: 108.362 lekë (tetor – dhjetor 2001) dhe shumën 389.417 lekë (janar – tetor 2002), në total shumën 497.779 lekë.

3.2.12 Nga të dhënat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në periudhën janar – dhjetor 2003, gjatë së cilës subjekti ka qenë gjyqtar pranë kësaj gjykate, ka përfituar pagën *neto* në shumën: 696.499 lekë.

3.2.13 Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003, subjekti ka deklaruar se kursimet e tij për periudhën 2000 – 2003 kanë qenë në shumën 1.170.119 lekë dhe, nga kjo vlerë ishte përdorur shuma 1.000.000 lekë, si kontribut për blerjen e apartamentit. Për shpenzimet e jetesës ka deklaruar se ishte ndihmuar nga familja tij, nga të ardhurat nga ekonomia bujqësore dhe blektorale, nga të ardhurat e emigrimit të vëllait në Greqi, si dhe ka evidentuar faktin se ka jetuar bashkë me vëllanë e tij më të vogël.

3.2.14 Komisioni kreu analizën financiare të pasqyruar si më poshtë (tabela nr. 6), duke u bazuar në të dhënat nga institucionet: bankat e nivelit të dytë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe të ardhurat e ish-bashkëshortes, znj. A. Gj., për periudhën 1999 – 2003.

Tabela nr. 6

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhura, ²⁶ periudha 1999 - 2003 (pagat e subjektit)	1,757,029
Paga e ish-bashkëshortes e viteve 2002 dhe 2003 (159,932 + 355,560)	515,492
Pasuria e blerë	2,000,000
Shpenzime jetike, periudha 1999-2002 (15 000 lekë/muaj)	720,000
Shpenzime jetike, viti 2003	310,000
Diferenca (të ardhura – pasuri – shpenzime)	-757,479

3.2.15 Nga analiza financiare e kryer, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit në Rr. “M. Gj.”, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë të paguara jashtë zyrës noteriale e, për rrjedhojë, i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

²³ Vendimi (faza e parë) nr. 2381, datë 11.5.2006, vendimi i pjesëtimit (faza e dytë) nr. 2381 akti, nr. 3574 vendimi, datë 19.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁴ Referojuni deklaratimit të shtetasës V. T., dhënë përmes *e-mail-it*, datë 11.1.2019.

²⁵ Shkresa nr. (***) prot., datë 15.1.2019.

²⁶ Për këtë periudhë janë përfshirë të ardhurat që u konfirmuan nga institucionet përkatëse.

3.2.16 Subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve dhe provave të depozituara në datën 16.4.2019, ndër të tjera ka argumentuar²⁷ se kontributi i tij në këtë pasuri ka qenë në masën 50 %, pasi kjo pasuri ishte krijuar në vitin 2003 dhe se kontributi prej 50 % i ish-bashkëshortes nuk ka pasur asnjë lloj ndikimi në pasurinë që zotëron, pasi i ka kaluar ish-bashkëshortes pas pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, sipas vendimit të pjesëtimit të fazës së parë. Subjekti ka kundërshtuar përlllogaritjet e komisionit në analizën financiare lidhur me shpenzimet jetike dhe marrjen në konsideratë të fakteve sa më poshtë:

- deri në muajin tetor 1999 shpenzimet e tij ishin përballuar nga prindërit, ndërkohë Komisioni ka kryer përlllogaritje shpenzimesh për një vit të plotë;
- marrjen në konsideratë të faktit se nuk ka deklaruar të ardhura deri në muajin tetor 1999 pasi ka qenë student në fakultetin juridik, kështu që përlllogaritjet e shpenzimeve duhet t'i referoheshin vetëm periudhës kur ka filluar pagesa nga Shkolla e Magjistraturës, pra, për periudhën tremujore tetor – dhjetor 1999;
- për periudhën tetor 1999 – tetor 2002 ka deklaruar se ka jetuar në Qytetin Studenti, shpenzimet e tij kanë qenë vetëm për ushqim dhe për veshmbathje, duke bashkëlidhur edhe shkresën nr. (***) prot., datë 9.4.2019 të Rezidencës²⁸ Studentore Universitare nr. 1 sh.a.
- për vitet 2000 – 2001, llogaritjet duhet të bëheshin vetëm për personin e tij dhe jo për tre persona, pasi vëllai i tij kishte kaluar në gjendje civile me subjektin në datën 19.11.2002, si dhe marrjen në konsideratë të faktit se data e celebrimit të martesës me ish-bashkëshorten daton më 14.3.2003, duke pasqyruar përlllogaritjet²⁹ e tij;
- ka pretenduar për vitet 1999 – 2003, se nisur nga fakti se Komisioni në përlllogaritjet për të ardhurat e ish-bashkëshortes i është referuar vetëm periudhës 2002 – 2003, por referuar deklaramentit periodik të vitit 2003 në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, burimi ka qenë “kursimet familjare”, të cilat duhej të vlerësoheshin nga Komisioni pasi kanë qenë të lidhura me kursimet e krijuara si nga ai vetë, ashtu edhe nga ish-bashkëshortja. Sipas deklaramentit të subjektit, ish-bashkëshortja ka punuar edhe para vitit 2002 në sektorin privat (shoqëri private), por dhe në sektorin publik (Drejtorinë e Ujësjellësit Kavajë), si dhe ka jetuar me familjen e saj dhe prindërit e saj kanë qenë të punësuar në administratë publike, ndërsa vëllai i saj ka qenë emigrant në Itali.
- për të vërtetuar me dokumentacion të ardhurat e ish-bashkëshortes, subjekti ka dorëzuar shkresën nr. (***), datë 15.4.2019, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili i ka kthyer përgjigje negative referuar kufizimeve të ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar edhe për të ardhura të familjarëve të ish-bashkëshortes. Për të gjitha argumentet e provat e mësipërme, në vijim subjekti ka parashtuar se për shkak të pamundësisë ligjore dhe objektive për aksesimin e këtyre të dhënave bazuar në nenin 32, të ligjit 84/2016, “Deklarimi i pasurisë”, i ka kërkuar Komisionit të marrë informacione të tjera në ISSH, për të bërë llogaritjet e sakta në lidhje me burimin e të ardhurave për ish-bashkëshorten për kontributin e saj prej 50 %, për arsyet se ai është tërësisht në pamundësi objektive për t'i siguruar.

3.2.17 Komisioni, gjatë vlerësimit të shpjegimeve, provave dhe kërkesave të subjektit e veçanërisht të pamundësisë së tij për të provuar të ardhurat e ish-bashkëshortes, e vlerësoi këtë të fundit si një nga arsyet e rihapjes së hetimit.

3.2.18 Në vijim të hetimit Komisioni kërkoi informacion për të ardhurat e realizuara nga ish-bashkëshortja pranë Ujësjellës Kanalizime Kavajë³⁰ dhe nga Agjencia Rajonale e Sigurimeve

²⁷ Referojuni shpjegimeve të subjektit të dërguar me *e-mail*-in e datës 16.4.2019.

²⁸ Kjo drejtori ka konfirmuar se nuk disponon informacion, për shkak të kohës së gjatë prej afro 18 vjetësh.

²⁹ Referojuni tabelave në shpjegimet e subjektit të dërguara në datën 16.4.2019.

³⁰ Shkresa nr. (***) prot., datë 13.5.2019.

Shoqërore Kavajë³¹, nga ku u konstatua se ish-bashkëshortja ka qenë në marrëdhënie pune në UK Kavajë gjatë vitit 2001 (periudha shtator – dhjetor) dhe gjatë vitit 2002 (periudha janar – korrik), duke realizuar të ardhura në shumën prej 128.812 lekësh.

3.2.19 Komisioni, për verifikimin e burimeve të ligjshme, të pasurisë në fjalë, por edhe të verifikimit të shumës 2.900.000 lekë (*e ardhur nga pjesëtimi i pasurisë mes ish-bashkëshortëve*), i kërkoi shtetases A. Gj. që të paraqitej për të dhënë deklarimin e saj për çështjet e ngritura në rezultatin e hetimit, por pas njoftimit, rezultoi se shtetasja në fjalë e nënshkroi marrjen dijeni, por nuk u paraqit.

3.2.20 Komisioni rivlerësoi llogaritjet financiare për aftësinë paguese për këtë pasuri, duke konsideruar:

a) të ardhurat që nga muaji tetor 1999, referuar dokumentit të Shkollës së Magjistraturës,³² sipas së cilit pasqyrohet se ka nisur trajtimin me pagesë në muajin tetor 1999, me rastin e fillimit të studimeve në këtë institucion;

b) shpenzimet jetike për periudhën tetor 1999 – tetor 2002, gjatë të cilës subjekti ka jetuar në konvikt në Qytetin Studenti dhe nuk rezultoi që të ketë pasur njeri tjetër në përgjegjësi financiare, për pasojë, për këtë periudhë shpenzimet jetike llogariten për një person;

c) faktin se martesë me ish-bashkëshorten ishte lidhur në muajin mars 2003;

ç) shkresën nr. (***) datë 29.1.2019, të ILDKPKI-së, ku përcaktohet “konsumi vjetor për frymë në lekë, sipas anketave përkatëse për llogaritjet e shpenzimeve jetike”.

- duke i pasqyruar të dhënat në këtë tabelë:

• Të ardhura, periudha 1999 – 2003 (pagat e subjektit të rivlerësimit)	1,757,029 lekë
• Paga e ish-bashkëshortes, për vitet 2002 dhe 2003 (159,932 +355,560)	515,492 lekë
• Paga e ish-bashkëshortes për vitet 2001 – 2001, Ujësjellës Kanalizime Kavajë	128,812 lekë
• Pasuria e blerë,	2,000,000 lekë
• Shpenzime jetike, periudha 1999 – 2003	626,578 lekë
Diferenca (të ardhura – pasuri – shpenzime) -	225,245 lekë

3.2.21 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të provave, lidhur me burimet e ligjshme të pasurisë shtëpi banimi/apartament me vlerë 2.000.000 lekë, të cilën subjekti e ka blerë në vitin 2003, arsyeton:

- Në një vlerësim të përgjithshëm, në lidhje me analizën financiare që pasqyron një diferencë të ardhurash, trupi gjykues çmon se kjo mangësi e burimeve financiare, për një total në shumën prej 225.245 lekësh, duke vlerësuar se ajo duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, nuk është e mjaftueshme në vetvete që të passjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Lidhur me burimin e shumës prej 2.900.000 lekësh, nisur nga faktet, rrethanat dhe provat që kanë krijuar këtë burim, trupi gjykues arsyeton:

- Përsa i përket ligjshmërisë së këtij burimi, trupi gjykues vlerëson se fillimisht duhet të çmohen katër situata/rrethana kryesore në kuptim të ligjit nr. 84/2016:

³¹ Kërkesë nr. (***) prot., datë 3.5.2019, të ASSH-së Kavajë, të ardhurat A. Gj. .

Kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 7.5.2019, të ARSSH-së (KPK (***)).

³² Shkresa: vërtetim nr. (***) prot., datë 21.10.2016 e Shkollës së Magjistraturës.

- *Së pari, kush ka qenë pozita e subjektit në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave?*
- *Së dyti, a ka rrethana se ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur?*
- *Së treti, a ka detyrim subjekti të provojë burimin e ligjshëm të shumës që dikush i ka paguar, duke zbatuar/egzekutuar një vendim gjykatë?*
- *Së katërti, a është subjekti në kushtet e pamundësisë për të justifikuar këtë burim?*

Lidhur me situatën e parë, në analizë të fakteve dhe të provave rezulton se sipas deklaratës periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar zgjidhjen e martesës. Në bazë të të dhënave të regjistrit të Gjendjes Civile³³ Durrës (ZGJC2), rezultojnë të dhënat se znj. A. Gj. ka lidhur martesë në datën 14.3.2003. Subjekti ka statusin “i divorcuar” me vendimin nr. (***) datë 14.9.2005, zbatuar më 3.2.2006. Nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 11.5.2006, rezulton se ka përfunduar faza e parë e pjesëtimit gjyqësor të pasurive në bashkësi ligjore, në të cilin përfshihen apartamenti dhe orenditë shtëpiake. Pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, palët kanë rënë dakord që në marrëveshje mes tyre, që të formalizojnë në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë mënyrën e ndarjes së tyre, e cila ka përfunduar me vendimin nr. (***) datë 19.6.2006, “Faza e dytë të pjesëtimit”. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje, subjekti i rivlerësimit ka lënë në favor të ish-bashkëshortes së tij pjesën e tij ideale për pronësinë e apartamentit dhe të orendive, përkundrejt vlerës 2.900.000 lekë. Në analizë të fakteve dhe të provave më sipër, trupi gjykues çmon se pozita e subjektit, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, është vetëm ajo e një pale në një transaksion që shkaktohet si rrjedhojë e përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga një vendim gjyqësor, i cili është marrë pas divorcit të palëve ndërgjyqëse, që ushtrojnë të drejtat dhe liritë civile të parashikuara në Kodin Familjes, në Kodin Civil, nën kontrollin dhe miratimin e gjykatës dhe ekzekutimit përmes shërbimit përmbartimor.

Lidhur me situatën e dytë, nga arsyetimi i mësipërm, si dhe në analizë të provave, trupi gjykues vlerëson se në çmuarjen ligjore të shumës 2.900.000 lekë, duhet të mbahen në konsideratë faktet e provuara gjatë hetimit se kjo shumë është një vlerë që nuk ka qenë gjendje në sistemin bankar apo dhe e deklaruar gjatë deklarimeve periodike para divorcit, por ka qenë shumë e hyrë jashtë pasurisë bashkëshortore, si dhe në periudhën që është miratuar aktmarrëveshja e formalizuar me vendim gjyqësor, palët nuk kishin më statusin e bashkëshortëve. Në vlerësimin e rrethanave, trupi gjykues çmon se raporti mes palëve ndërgjyqëse nuk përbën marrëdhënie të posaçme interesi, sipas ligjit nr. 84/2016, ku palët nuk ndërvaren nga njëri-tjetri në ushtrimin e të drejtës së pjesëtimit, pasi çdo qytetar ka të drejtë (legjitimohet) që të realizojë të drejtat pasurore nëpërmjet gjykatës, pavarësisht dëshirës apo interesit të palës kundërshtarë. Në këto argumente, trupi gjykues çmon se nuk ka rrethana për të cilat ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur.

Lidhur me situatën e tretë, Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti nuk ka qenë në një marrëdhënie huamarrje apo përfitimi të ndonjë dhurimi nga një person i tretë, ai nuk mbart detyrimin që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të marra nga të tretët.

Lidhur me situatën katërt, trupi gjykues nisur nga faktet: (i) se për përjashtimin e çdo dyshimi për këtë burim kërkoi thirrjen e ish-bashkëshortes së subjektit për të dëshmuar për burimin e ligjshëm, e cila, me gjithë marrjen dijani duke nënshkruar njoftimin, nuk u paraqiti; (ii) se subjekti ka deklaruar dhe ka dëshmuar pamundësinë e tij për të provuar burimin e krijimit të shumës së blerjes së pjesës së pasurisë në bashkëpronësi, për shkak të cenimit të privatësisë së ish-bashkëshortes, bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, çmon se nuk ka

³³ Referojuni shkresën (***) datë 15.10.2018.

rrethana që të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, për sa kohë nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pamundësia ligjore dhe objektive e subjektit rezultojnë në nivel provueshmërie.

3.2.22 Në vijim të hetimit administrativ rezultojnë se në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka sqaruar se me shumën 2.900.000 lekë, që i ka dorëzuar fizikisht ish-bashkëshortja, znj. A. Gj. (me ndërmjetësimin e avokates V. T.), ai ka kryer transaksionin: kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, nr. (***) , datë 25.1.2010, me palë shitëse shoqërinë “C.” sh.p.k., me administrator F. C. dhe palë blerëse Kastriot Selita, me objekt apartamentin me sip. 48.27 m², me nr. pasurie (***) , në komunën Sh. të Lezhës, me vlerë 2.000.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

3.2.23 Rezultojnë se në deklaratat periodike të viteve 2008 dhe 2009, subjekti ka deklaruar dy pagesat: 1.200.000 lekë (në vitin 2008) dhe 800.000 lekë (në vitin 2009), kundrejt shoqërisë “C.” sh.p.k., për prenotimin e një apartamenti me sip. 68 m².

3.2.24 Nga ZVRPP-ja Lezhë konfirmohet transaksioni për blerje apartamenti me shoqërinë “C.” sh.p.k., kundrejt çmimit 2.000.000 lekë, të deklaruar të shlyer jashtë zyrës noteriale.

3.2.25 Për të konfirmuar likuidimin efektiv të pagesave dhe transaksionin në tërësi, shoqëria ³⁴“C.” sh.p.k., ka konfirmuar transaksionin, si dhe pagesat e kryera si më poshtë:

- vlera 10.000 euro (konvertuar në shumën 1.230.000 lekë), paguar *cash* në llogarinë bankare të shoqërisë “C.” sh.p.k., në “BKT”, me mandatpagesë me referencë: (***) , datë 29.9.2008, me përshkrimin: likuidim pjesor apartamenti (1+1) Sh.;

- vlera 6.000 euro (konvertuar në shumën 780.000 lekë), paguar *cash* në llogarinë bankare të shoqërisë “C.” sh.p.k., në “BKT”, me mandatpagesë me referencë: (***) , datë 26.3.2009, me përshkrimin: *likuidim kësti apartamenti* (likuidim total).

3.2.26 Subjekti i rivlerësimit, për rrethanat e blerjes së këtij apartamenti nga shoqëria “C.” sh.p.k., ka deklaruar: “...*Megjithëse pagesat për këtë apartament janë bërë përkatësisht në vitet 2008 dhe 2009, kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti mban datën 25.1.2010, pasi shoqëria “C.” sh.p.k. nuk kishte realizuar procesin e regjistrimit të godinës në të cilën ndodhej ky apartament në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë. Ky apartament është marrë në dorëzim nga unë në muajin prill 2009, pas shlyerjes totale të vlerës së blerjes së apartamentit. [...] Shlyerja e pagesës është realizuar nëpërmjet bankës “BKT” sipas mandateve respektive në “BKT” në datën 29.9.2008 në shumën 10.000 euro (konvertuar në 1.200.000 lekë) dhe në datën 26.3.2009 në shumën 6.000 euro (konvertuar në shumën 8.000.000 lekë).*”

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Lidhur me pagesat për blerjen e apartamentit në Sh. të Lezhës, në rezultatet e hetimit për këtë pasuri, trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet e dala dhe provat, konkludoi se deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit e, për rrjedhojë, çmon se deklarimi i tij është i saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016;

3.2.27 Rezultojnë se në deklaratën “Vetting”, subjekti ka sqaruar se apartamentin e blerë nga shoqëria “C.” sh.p.k. e ka shitur me gjithë mobilje në vitin 2011 kundrejt shumës: 35.000 euro për apartamentin dhe 3.000 euro për mobilje.

3.2.28 Në vijim të këtij deklarimi rezultojnë gjithashtu se në deklaratën periodike të vitit 2011 subjekti ka deklaruar: “*Pakësime: shitje apartamenti 1+1 në Sh., Lezhë, në muajin maj 2011*”;

³⁴Kjo shkresë shoqërohet me: kontratën, mandatet e pagesës, dokumentacionin e pronësisë, vërtetimin e likuidimit të tatimeve për ndërtimin e pallatit si dhe kartelën e noterit

në vlerën 38.000 euro; “*Paguar tatim në burim në shumën 289.265 lekë*”; pjesa takuese: 100 %; “*Shtesa: të ardhura neto nga shitja e apartamentit të sipërcituar: 35.919 euro*”; pjesa takuese: 100 %.

3.2.29. Nga ZVRPP-ja Lezhë, konfirmohet transaksioni për blerjen e apartamentit kundrejt çmimit 38.000 euro, por në kontratë nuk deklarohet mënyra e likuidimit të shumës.

3.2.30 Për mënyrën e likuidimit të shumës 38.000 euro nga blerësi M. I., subjekti i rivlerësimit, në datën 14.8.2018, ka deklaruar: “*...Apartamenti prej 48.27 m² është shitur sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) , datë 24.5.2011, blerësit M. I. në shumën totale prej 38.000 eurosh. Në lidhje me koston e mobilimit ka sqaruar se mobilimi ishte realizuar në vitin 2010, në vlerën afërsisht 3.000 euro, por në lidhje me këto shpenzime nuk dispononte dokumente. Fakti i vetëm provues ishte që vlera ishte pasqyruar në kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 24.5.2011, meqenëse këto mobilje nuk kanë pasur amortizim pasi apartamenti është përdorur vetëm në periudhën korrik – gusht 2010 nga prindërit dhe familja ime. Pagesat nga blerësi M. I. ishin shlyer në datën e lidhjes së kontratës, më 24.5.2011, dhe konkretisht shuma prej 29.900 eurosh që shlyer nëpërmjet “Raiffeissen Bank” dhe shuma prej 8.100 eurosh është paguar cash, po në datën e lidhjes së kontratës.” Subjekti ka depozituar veprimin bankar të “Raiffeisen Bank” të datës 24.5.2011 për shumën 29.900 euro; pagesën e tatimit në burim në datën 23.6.2011 të “Credins Bank” në shumën 289.265 lekësh për shitjen e kësaj pasurie të paluajtshme”.*

3.2.31 Nga të dhënat e transaksioneve bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank”, konfirmohet transaksioni i pagesës me referencë: (***) , datë 24.5.2011, në sportel nga shtetasi M. S. I., cash, në shumën 29.900 euro, me përshkrimin: “*kalim fondi për blerje shtëpie*”.

3.2.32 Në vlerësim të fakteve të mësipërme Komisioni konkludoi se deklarimi i subjektit për përfitimin e shumës prej 38.000 eurosh, pjesërisht me bankë (29.900 euro) dhe pjesërisht cash (8.100 euro), ishte i saktë, por kjo vlerë e fundit nuk mbështetej në ndonjë dokument/provë dhe, për rrjedhojë, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumente në lidhje me këtë konstatim.

3.2.33 Në lidhje me pagesën cash të shumës 8.100 euro, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. (***) , datë 4.4.2019, të blerësit, duke konfirmuar në këtë mënyrë pagesën cash prej **8.100 eurosh**.

-Në lidhje me burimin e shumës 30.000 euro, që subjekti ka deklaruar për pasurinë apartament banimi (dupleks), Gjiri i Lalzit, faktet e rrethanat kanë rezultuar:

3.2.34 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se burimi i shumës 30.000 euro është: “*...Kursime të bashkëshortes të krijuara përpara martesë, të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, të ardhura këto të realizuara nga shitja e shtëpisë private me 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m², pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , në shumën 220.000 euro, sipas kontratës nr. (***) , datë 9.6.2008. Adresa: Rr. “M. K.”, pranë F. B., Q., L., Tiranë”.*

3.2.35 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar: “*Nga shuma totale e kursimeve cash, e deklaruar në vitin 2008, në shumën 60.000 euro dhe në deklarimin e vitit 2009, në shumën 6.000 euro, theksoj se shuma totale e gjendjes cash që unë zotëroj është 30.000 euro. Kjo gjendje cash është krijuar nga shitja e aseteve familjare të deklaruara në deklaratimet e mëparshme dhe kursimet e vitit 2009”.*

3.2.36 Në lidhje me këtë transaksion është bërë trajtimi në lidhje me burimin e të ardhurave për apartamentin te “Pallati A.”, më sipër arsyetuar.

3.2.37 Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, shitjen e shtëpisë (vilë) së familjes në periudhën e vajzërisë blerësit A. M. . Shuma neto prej 204.365

eurosh provohet që të jetë shlyer ndaj babait të personit të lidhur, z. A. K. . Me këtë shumë u kryen disa transaksione, duke nisur me pagesën prej 120.000 eurosh për blerjen e dy apartamenteve nga shoqëria “U.” sh.p.k. (një për të bijën, M. K., dhe një për të birin, F. K.); likuidimin e një kredie të mbetur në shumën 21.798 euro, ndaj “NBG”-së në emër të personit të lidhur.

3.2.38 Lidhur me blerjet e tjera të realizuara me shumën 204.365 euro, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se: “...shuma 4.365 euro shpenzuar për shpenzime familjare (kryesisht për mobilim pjesor të apartamentit me sip. 126.5 m² të blerë nga shoqëria “U.” sh.p.k. sipas kontratës nr. (***)), pasi pas shitjes së shtëpisë private 2 kat + papafingo për një periudhë afro 4-vjeçare në këtë apartament ka jetuar e gjithë familja e bashkëshortes.

- Gjendje cash, në vitin 2008 në shumën 60.000 euro, shumë e cila është ndarë ndërmjet dy fëmijëve znj. M. K. dhe z. F. K., në mënyrë të barabartë nga 30.000 euro secili, në momentin e ndarjes nga trangu familjar.”

3.2.39 Rezulton se nga të dhënat e “BKT”-së konfirmohet fakti se shtetasi z. A. K. ka tërhequr cash në data të ndryshme shumën 76.937 euro dhe ka kryer transfertën bankare prej 120.000 eurosh ndaj shoqërisë “U.” sh.p.k., për blerjen e dy apartamenteve, si më sipër.

3.2.40 Në rrethanat e mësipërme, konstatohet se babait të personit të lidhur, pas shpenzimeve të kryera, i ka mbetur diferenca prej 30.000 eurosh për t’ia kaluar së bijës me rastin e martesës, shumë kjo e përfituar nga shitja e shtëpisë private me dy kate plus papafingo.

3.2.41 Në përfundim, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ konkludoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet financiare të krijuara prej kursimeve të bashkëshortes para martesë, për gjendjen cash prej 30.000 eurosh ishte i saktë, por nuk mbështetej në dokumente shkresore që vërtetonte dorëzimin e kësaj shume e, për rrjedhojë, i kaloi barrën e provës.

3.2.42 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij ka depozituar deklaratë noteriale të babait të bashkëshortes, nëpërmjet të cilës konfirmohet dorëzimi fizik i shumës 30.000 euro cash.

3.2.43 Për faktin e dorëzimit të kësaj shume të bashkëshortja, si dhe për burimin e transaksionit të saj (nga shitja e shtëpisë blerësit A. M.³⁵), të konfirmuar nga z. A. K. me deklaratën noteriale³⁶, Komisioni u thellua në hetimin dhe analizën nëse kalimi i kësaj shume (30.000 euro – pjesë e shumës neto, afërsisht 205.000 euro³⁷), në kushtet kur transaksioni që e kishte prodhuar atë iu nënshtroa likuidimit të detyrimit tatimor, mund të përbëjë në thelb një transaksion të ri që, si i tillë, t’i nënshtrohej tatimit për të ardhurat sipas pikës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar) dhe sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), duke i kërkuar subjektit shpjegime për rezultatet shtesë.

³⁵ Shihni dokumentet:

- Kontratë kapari për dorëzim parash nr. (***), datë 27.5.2008, për shlyerjen e shumës 20.000 euro, me palë shitëse z. A. K. .

- Kontratë shitblerjeje me rezervë pronësie (me kusht), nr. (***) datë 9.6.2008 të pasurisë së paluajtshme (truall dhe ndërtesë), me palë shitëse z. A. K., me pëlqimin e bashkëshortes, znj. H. K., dhe dy fëmijëve, M. K. dhe F. K. .

- Deklaratë noteriale nr. (***), datë 23.7.2008, midis palëve, për shlyerjen përfundimtare të vlerës së shitjes prej 200.000 eurosh.

³⁶ Deklarata noteriale nr. (***), datë 15.4.2019.

³⁷ Z. A. K. tërheq cash 26.500 euro, në datën 29.7.2008, nga llogaria e tij në “BKT” dhe likuidon në datën 31.7.2008 në “Raiffeisen Bank” (cash në sportel) shumën 1.902.430 lekë, si taksë hipoteke për shitje shtëpie 10 %.

3.2.44 Për një vlerësim sa më objektiv, Komisioni mori paraprakisht edhe mendimin e dy institucioneve³⁸ të specializuara: të Ministrisë së Financave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3.2.45 Subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve të depozituara në datën 10.6.2019, ndër të tjera argumentoi³⁹ se shuma 30.000 euro është marrë në momentin e ndarjes nga trangu familjar i bashkëshortes, nga babai⁴⁰ i saj z. A. K. . Për të paraqitur me saktësi faktet e ndodhura, sqaron se kjo shumë nuk është një dhuratë martese, por është shuma e përfutur nga bashkëshortja në momentin e ndarjes nga trangu familjar. Burimi i shumës 30.000 euro kishte qenë pikërisht shuma *neto* 204.365 euro, e cila rezulton si diferencë ndërmjet çmimit të shitjes së shtëpisë private në pronësi të babait të bashkëshortes sipas kontratës së shitjes, nr. (***) , datë 9.6.2008 në shumën 220.000 euro me shumën e paguar për tatimin në shitje prej 1.902.280 lekësh. Subjekti ka parashtruar se bazuar në pikën “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), ky transaksion nuk ka siguruar të ardhura tatimore shtesë përderisa baza tatimore për llogaritjen e tatimit është 0 (*shuma e marrë 30.000 euro – shumën për të cilën është paguar tatim 30.000 euro*), pra, për rrjedhojë, edhe tatimi është 0 lekë. Sipas subjektit, e njëjta metodologji për llogaritjen e tatimit përdoret edhe nëse do t’i referohemi mënyrës së llogaritjeve që bëhen në rastin e dhurimit të pasurive të paluajtshme, përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”, sipas të cilit fitimi kapital, ku baza tatimore për të cilën llogaritet tatimi është diferenca ndërmjet vlerës së pasurisë së dhuruar në momentin e dhurimit dhe çmimit të blerjes ose çmimit të referencës së pasurisë së dhuruar. Sipas subjektit nuk rezulton të këtë detyrim për pagesë të tatimit për shumën prej 30.000 eurosh të marrë nga bashkëshortja në momentin e ndarjes nga trangu familjar, për sa kohë që është paguar më parë tatimi për këtë shumë.

3.2.46 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e provave, por dhe të ligjit të zbatueshëm arsyeton se sipas deklaramentit të bashkëshortes në vitin 2005, provuar me deklaramentimin e saj në procesverbalin e datës 19.1.2007 në ILDKPKI, konfirmohet fakti se ajo ka dhënë kontributin më të madh në ndërtimin e kësaj pasurie. Ndërkohë, ka rezultuar se në vitin 2008 ajo nuk e ka deklaruar pjesën zotëruese të shumës prej 204.365 eurosh, që është çmimi i shitjes së shtëpisë, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010 ajo e ka deklaruar shumën 30.000 euro në pjesë takuese: 100 %. Mbajtja e shumës 30.000 euro, deklaruar në vitin 2009 (pasi deri në vitin 2008 bashkëshortja ka deklaruar se të gjitha paratë i mbanin bashkë si familje), është gjeneruar nga një transaksion i vetëm, që është shitja e shtëpisë. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se raporti midis bashkëpronësisë dhe kontributit, për sa kohë që ajo nuk kundërshtohet, është vullnet i palëve dhe pranohet si i tillë, çka do të thotë se bashkëshortja e subjektit nuk e humb kontributin e saj, pavarësisht deklaramentit të pjesës takuese 25 % në vitin 2005. Nisur nga faktet dhe rrethanat e mësipërme, kjo shumë përbën thjesht një ndarje brenda anëtarëve të familjes, për të cilën nuk ka asnjë arsye që të përcaktohen pjesët takuese apo kontributi i dhënë për përfitimin e saj, për sa kohë kanë gjetur zbatim dispozitat ligjore në fuqi lidhur me tatimin. Nën këtë arsyetim, kjo shumë nuk përbën një të ardhur të tatueshme sipas germës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), dhe pikës 2.3.9, të kapitullit 2.3, “Të

³⁸ Referojuni përgjigjeve të tyre.

³⁹ Referojuni shpjegimeve të subjektit të dërguara me *e-mail*-in e datës 16.4.2019.

⁴⁰ Shihni deklaratën noteriale nr. (***) , datë 15.4.2019.

ardhura të tatueshme”, të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), pasi shuma kryesore prej 220.000 eurosh, nga ku është shkëputur shuma 30.000 euro, është tatuar një herë dhe tatimi për herë të dytë, tërësisht apo pjesërisht, do të konsiderohej si problem me natyrë të theksuar diskriminimi nga zbatimi i ligjit në mënyrë të pabarabartë. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues gjen edhe mendimin e dhënë nga dy institucionet: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, të cilat kanë dhënë qëndrimin e tyre se një e ardhur e tatuar në burim nuk i nënshtrohet tatimit për herë të dytë.

3.2.47 Në lidhje me burimet për pasurinë apartamentin e banimi (*dupleks*) në Kompleksin Rezidencial “L.”, u konstatua se në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 ishin deklaruar dy burimet dhe vlera totale e këtyre dy burimeve është 65.000 euro, pra, mbetej pa u deklaruar nga subjekti i rivlerësimit burimi i ligjshëm për vlerat 17.132 euro dhe 984.199 lekë, për të cilat atij iu kërkuan sqarime. Për burimin e të ardhurave për këtë pasuri subjekti ka deklaruar⁴¹:

3.2.48 Shuma 5.000 euro – të ardhura nga kursimet familjare të vitit 2012, me pjesë takuese 50 %, të krijuara nga të ardhurat nga paga e tij në shumën 971.798 lekë, të ardhura nga paga e bashkëshortes në shumën 1.150.331 lekë, si dhe nga të ardhurat e qirasë së apartamentit në pronësi të bashkëshortes në shumën 2.520 euro. Po për këtë burim, subjekti ka sqaruar se nga këto të ardhura vjetore janë zbritur shpenzimet e bëra gjatë vitit dhe, kursimet e mbetura nga këto të ardhura, janë në shumën 5.000 euro për vitin 2012⁴², të cilat janë përdorur për pagesën e detyrimeve financiare ndaj shoqërisë “L.” sh.p.k. në vitin 2013⁴³.

3.2.49 Shuma 8.010 euro – të ardhura nga qiraja e apartamenteve në vitin 2014, me pjesë takuese 50 %, me burime: 3.960 euro të ardhura *neto* nga qiraja (pas pagimit të tatimit në burim) sipas kontratës nr. (***) , datë 19.9.2013, si dhe kontratës nr. (***) , datë 19.11.2014 nga apartamenti në pronësi të bashkëshortes (pasuri e blerë para martesë); 4.050 euro të ardhura *neto* nga qiraja (pas pagimit të tatimit në burim) nga apartamenti në Komunën I. (Gjiri i Lalzit), sipas kontratës nr. (***) , datë 24.9.2013. Po për këtë burim subjekti ka sqaruar se të ardhurat e përfituara nga qiraja e apartamenteve në shumën totale **8.010 euro** janë përdorur për të paguar një pjesë të detyrimit ndaj shoqërisë “L.” sh.p.k. në vitin 2014.

3.2.50 Shuma 4.122 euro, nga të ardhurat familjare të vitit 2014, me pjesë takuese 50 %; me burime: të ardhura *neto* nga paga e tij në shumën 1.678.622 lekë; të ardhura *neto* nga paga e bashkëshortes në shumën 1.028.088 lekë; të ardhura nga shitja e makinës në pronësi të bashkëshortes sipas kontratës nr. (***) , datë 30.10.2014, në shumën 400.000 lekë. Për këtë burim subjekti ka sqaruar se të ardhurat e tjera (nga pagat dhe nga shitja e makinës) janë në shumën totale 3.106.710 lekë, nga të cilat vetëm shuma 4.122 euro (*e konvertuar në 568.836 lekë me kursin mesatar 138 lekë/euro*) është përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “L.” sh.p.k. në vitin 2014.

3.2.51 Për truallin në vlerën 984.199 lekë, sipas deklarimit të tij në datën 23.7.2018 (*shpenzimet për truallin*), ka deklaruar si burime: kursime vjetore të tij në vitin 2009, në shumën 200.000 lekë, kursime vjetore të tij në vitin 2010, po në shumën 200.000 lekë, kursime vjetore familjare të vitin 2011, në shumën 500.000 lekë, si dhe të ardhura familjare të vitit 2013 në shumën 84.199 lekë. Për këtë burim subjekti ka sqaruar se për të ardhurat nga pagat, si dhe nga të

⁴¹ Referojuni deklarinimin e subjektit, të datës 23.7.2018.

⁴² Shihni deklaratën periodike vjetore të vitit 2012.

⁴³ Shihni deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

ardhurat nga qiraja në datën 27.1.2017, janë dorëzuar në ILDKPKI vërtetimet nga pagat, si dhe kontratat e sipërcituara të qirasë në kuadër të deklaratës së pasurive “Vetting” të vitit 2017.

Në lidhje me burimin e shumës 5.000 euro, sipas pikës 3.2.48 rezulton:

Për të vërtetuar burimin e shumës 5.000 euro, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Vërtetim nr. (***) prot., datë 18.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të ardhurat *neto* të subjektit nga paga e vitit 2012 si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në shumën 971.798 lekë.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 23.1.2017, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të ardhurat *neto* të personit të lidhur nga paga e vitit 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në shumën 1.150.331 lekë.
- Kontratë nr. (***), datë 19.9.2013, mes qiradhënëses (bashkëshortes) dhe qiramarrëses E. Sh., në bazë të së cilës palët kanë rënë dakord për dhënien me qira të një apartamenti me sip. 115,8 m², tërësisht i kompletuar për qëllim banimi, të ndodhur në Rr. “R. P.”, Pll. “U.”, Ap. (***), Tiranë; pasuria nr. (***), z.k. (***), Tiranë, për afatin 1.8.2013 – 31.7.2014, kundrejt çmimit 400 euro/muaj. Likuidimi i shumës së qirasë do të bëhej në llogarinë e qiradhënëses në “Raiffeisen Bank”. Në klauzolën “Detyrimet e qiramarrësit” palët kanë përcaktuar se qiramarrësi merr përsipër pagimin e tatimit në burim.
- Kontratë qiraje nr. (***), datë 19.11.2014; mes qiradhënëses M. K. dhe qiramarrëses E. Sh., për periudhën 1.8.2014 – 31.12.2014, kundrejt çmimit 400 euro/muaj. Likuidimi i shumës së qirasë do të bëhej në llogarinë e qiradhënëses në “Raiffeisen Bank”. Në klauzolën “Detyrimet e qiramarrësit” palët kanë përcaktuar që qiramarrësi merr përsipër pagimin e tatimit në burim.
- Kontratë nr. (***), datë 20.9.2013, mes qiradhënëseve Kastriot Selita e M. K. dhe qiramarrësit Sh. L. për dhënien me qira të apartamentit me sip. 205 m², në Komunën I., në Kompleksin Rezidencial “L.”, për vitin 2013; palët kanë rënë dakord për pagesën në vlerën 2.500 euro; për vitin 2014, palët kanë rënë dakord për pagesa në vlerën 4.500 euro. Likuidimi i shumës së qirasë do të bëhej *cash* ose në bankë, në marrëveshje mes palëve.
- Shkresat nr(***) prot., dhe (***) prot., datë 25.1.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, “Konfirmim pagesa tatim burimi” drejtuar personit të lidhur, sipas së cilave, për vitin 2014, personi i lidhur ka paguar tatim për të ardhurat nga qiradhënia e pasurisë së paluajtshme.
- Shkresën kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 21.7.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, administruar në fashikullin e akteve të ILDKPKI-së, e cila bën me dije se për vitin 2012 personi i lidhur ka paguar tatim për të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme në shumën 26.646 lekë.

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar:

- Shtesa: gjendje *cash* (kursime familjare gjatë vitit) – 5.000 euro.
- Paga vjetore dhe shpërblimi (Kastriot Selita) – 971.798 lekë.
- Paga vjetore dhe shpërblimi (M. K.) – 1.150.331 lekë.
- Të ardhura *neto* nga dhënia me qira e apartamentit me sip.126 m², për periudhën gusht – dhjetor 2012 +1, muaj garanci paradhënie + janar 2013 paradhënie, sipas kontratës së qiradhënies nr. 1458/621, datë 31.7.2012 – 2.520 euro.

3.2.52 Rezulton se shoqëria “L.” sh.p.k. ka konfirmuar likuidimin e çmimit e ndërtesës, në shumën 82.132 euro: mandatarkëtimi nr. (***), datë 4.6.2012, shuma 40.000 euro, pagesë *cash*

në arkën e shoqërisë; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 25.3.2013, shuma 15.000 euro; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 16.5.2013, shuma 15.000 euro; mandatarkëtimi nr. (***) , datë 31.12.2014, shuma 12.132 euro, ndërsa vlerën 956.457 lekë të blerjes së truallit e ka shlyer në “Raiffeisen Bank”, sipas mandatpagesës nr. (***) , datë 17.9.2013.

3.2.53 Nga ZVRPP-ja Durrës dhe ALUIZNI, konfirmohen transaksionet pasurore, kontratë për shitblerje pasurie të paluajtshme nr. (***) , datë 20.8.2015, me palë shitëse shoqërinë “L.” sh.p.k. dhe me palë blerëse M. K. dhe Kastriot Selita; kontrata nr(***) , datë 26.9.2013, mes ALUIZNI Tirana 3 dhe shoqërisë “L.” sh.p.k., për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore.

3.2.54 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka konfirmuar: të ardhurat e tatueshme të subjektit, periudha janar 2012 – dhjetor 2018; të ardhurat e tatueshme të personit të lidhur, periudha dhjetor 2011 – dhjetor 2017; tatimi i qirasë nga kontrata e qirasë nr. (***) , datë 31.7.2012, mes personit të lidhur znj. M. K. dhe znj. E. Sh. për periudhën: 1.8.2012 – 31.12.2012; përkatësisht datë 16.8.2012, tatim i deklaruar dhe i paguar 10.544 lekë; datë 4.10.2012, tatim i deklaruar dhe i paguar, 5.318 lekë; datë 26.10.2012, tatim i deklaruar dhe i paguar, 5.318 lekë; datë 26.10.2012, tatim i deklaruar dhe i paguar, 5.318 lekë; si dhe është dërguar kontrata e qirasë nr. (***) , datë 31.7.2012, mes znj. M. K. dhe znj. E. Sh. .

3.2.55 Nga të dhënat e “Alpha Bank”, në llogarinë me nr. AL (***) rezulton se të ardhurat e realizuara nga paga të subjektit dhe interesat për vitin 2012 janë në total në shumën 968.393,18 lekë.

3.2.56 Nga të dhënat e “Raiffeisen Bank”, në llogarinë me nr. (***) , konfirmohet fakti se në emër të personit të lidhur, për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, rezultojnë të jenë derdhur në total 1.149.135,89 lekë, paga dhe shpërblime, si dhe 96.336 lekë (= 690 euro) nga znj. E. Sh. me përshkrimin: “E. Sh. derdh këst qiraje”, referenca nr. (***) .

Në përfundim, lidhur me burimin e shumës 5.000 euro, të përdorur për pasurinë apartament banimi (dupleks), trupi gjykues, në analizë të fakteve e të provave, konkludoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në datën 23.7.2018, lidhur me krijimin e gjendjes cash në shumën 5000 euro, përputhet me dokumentacionin administrativ dhe bankar të siguruar gjatë hetimit administrativ.

Në lidhje me burimin e shumës 8.010 euro, sipas pikës 3.2.49 rezulton:

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

3.2.57 Rezulton se lidhur me këtë burim, në datën 23.7.2018, subjekti deklaroi se kjo vlerë ishte krijuar nga qiraja e apartamenteve në vitin 2014, e përdorur për të paguar një pjesë të detyrimit ndaj shoqërisë “L.” sh.p.k. në vitin 2014.

3.2.58 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar:

- të ardhura *neto* nga dhënia me qira e apartamentit (me sip. 126 m²) sipas kontratave të qiradhënies nr. (***) , datë 19.9.2013, dhe nr. (***) , datë 19.11.2014 (*për periudhën janar – dhjetor 2014, minus 1 muaj garanci paradhënie, minus tatimin në burim*), në shumën 3.960 euro;
- të ardhura *neto* nga dhënia me qira e apartamentit në komunën I. sipas kontratës nr. (***) , datë 20.9.2013, për periudhën janar 2014 – korrik 2014 (*minus tatimin në burim*), në shumën 4.050 euro.

3.2.59 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ka konfirmuar:

- tatim qiraje⁴⁴ nga kontratat e qirasë nr. (***) , datë 19.9.2013, dhe nr. (***) , datë 19.11.2014, mes znj. M. K. dhe znj. E. Sh., për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, në shumën 49.428 lekë;
- tatim qiraje nga kontrata e qirasë nr. (***) , datë 20.9.2013, mes z. Kastriot Selita dhe znj. M. K. dhe z. Sh. L., për periudhën 1.1.2014 – 31.7.2014, në shumën 60.170 lekë; nga ky institucion janë dërguar edhe kontrata e qirasë nr. (***) , datë 19.9.2013, si dhe kontrata e qirasë nr. (***) , datë 19.11.2014, mes qiradhënëses (bashkëshortes) dhe qiramarrëses E. Sh. .

3.2.60 Nga të dhënat e sjella nga “Raiffeisen Bank”, Komisioni është informuar për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur nga paga dhe shpërblime, dhe se në llogarinë nr. (***) , rezulton të jenë derdhur në total 125.000 lekë (= 892 euro) nga “E.-S.” sh.p.k. me përshkrimin: “E.-S., pagesë qiraje”, referenca nr(***) , datë 6.3.2014, ndërsa nga balanca e llogarisë nr. (***) në monedhën euro, rezulton të jenë derdhur pagesat e qirasë⁴⁵ në emër të personit të lidhur, në periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014: total deri në datën 31.12.2014 rezultojnë të ardhura nga qiratë, shuma 7.642 euro ose 1.070.720,62 lekë (*sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të monedhës euro me lekë*).

Në përfundim, për deklarimin e subjektit të rivlerësimit në datën 23.7.2018, për burimin e deklaruar të kësaj pasurie, lidhur me krijimin e gjendjes *cash* në shumën 8.010 euro, trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të provave, konkludoi se ky deklaram përputhet me dokumentacionin administrativ dhe bankar, të siguruar gjatë hetimit administrativ.

Në lidhje me burimin e shumës 4.122 euro, sipas pikës 3.2.50 rezulton:

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

3.2.61 Rezulton se lidhur me këtë burim subjekti në datën 23.7.2018, deklaroi të ardhurat e tjera (nga pagat dhe nga shitja e makinës) në shumën totale 3.106.710 lekë, nga të cilat vetëm shuma 4.122 euro (e konvertuar në 568.836 lekë me kursin mesatar 138 lekë/euro) është përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “L.” sh.p.k. në vitin 2014.

3.2.62 Për të vërtetuar burimin e shumës 4.122 euro, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Vërtetim nr. (***) prot., datë 26.1.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për të ardhurat *neto* të subjektit nga paga për periudhën 4.11.2013 – 10.1.2017, si gjyqtar në këtë gjykatë, në shumën 4.960.873 lekë.
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 20.1.2017, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të ardhurat *neto* të personit të lidhur nga paga e vitit 2014 në Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj 1.197.935 lekë.

⁴⁴ Konkretisht: datë 9.5.2014, tatim i deklaruar dhe i paguar: 21.786 lekë, datë 22.7.2014; tatim i deklaruar dhe i paguar: 5.330 lekë, datë 31.7.2014; tatim i deklaruar dhe i paguar: 5.290 lekë, datë 12.9.2014; tatim i deklaruar dhe i paguar: 10.818 lekë, datë 3.11.2014; tatim i deklaruar dhe i paguar: 5.298 lekë, datë 12.11.2014; tatim i deklaruar dhe i paguar: 10.818 lekë nga qiradhënia me Sh. L.: datë 6.3.2014, tatim i deklaruar dhe i paguar 12.500 lekë, datë 30.7.2014, tatim i deklaruar dhe i paguar: 47.670 lekë.

⁴⁵ Specifikisht: datë 9.5.2014, referenca nr. t(***)n, shuma 1.440 euro, derdhur nga “E. Sh., qira janar – shtator 2014”; datë 22.7.2014, referenca nr. (***) , shuma 360 euro, “E. Sh. derdh qira apartamenti”; datë 30.7.2014, referenca nr. (***) , shuma 3.150 euro, “Sh. L., pagesë për periudhën prill – korrik 2014”; datë 31.7.2014, referenca nr. (***) , shuma 360 euro, “E. Sh., qira qershor 2014”; datë 12.9.2014, referenca nr(***) , shuma 720 euro, “E. Sh. derdh pagesë qiraje për muajin korrik – gusht 2014”; datë 3.11.2014, referenca nr. (***) , shuma 360 euro, “E. Sh. derdh qira muaji shtator 2014”; datë 12.11.2014, referenca nr. (***) , shuma 360 euro, “E. Sh., pagesë qiraje muaji tetor 2014”.

- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***), datë 30.10.2014, mes shitëses M. K. dhe blerësit A. M. B. (me shtetësi egjypjane), me objekt: autoveturë e tipit “Dacia Logan”, kundrejt çmimit 400.000 lekë, të shlyer jashtë zyrës noteriale.

3.2.63 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “*Paga neto vjetore të tij në shumën 1.678.622 lekë*”, “*Paga neto vjetore të bashkëshortes në shumën 1.028.088 lekë*”, si dhe të ardhura në shumën 400.000 lekë nga “*Shitja e automjetit sipas kontratës nr. (***) datë 30.10.2014*”.

3.2.64 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka konfirmuar të ardhurat e tatueshme të subjektit, për periudhën janar 2012 – dhjetor 2018, si dhe të ardhurat e tatueshme të personit të lidhur, për periudhën dhjetor 2011 – dhjetor 2017.

3.2.65 Nga të dhënat e “Raiffeisen Bank”, konfirmohen të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe personi i lidhur nga paga dhe shpërblime, si dhe nga qiraja në vitin 2014, të evidentuara në tabelat e balancës së llogarive të personit të lidhur në këtë bankë, dhe specifikisht:

- Nga balanca e llogarisë nr. (***), në monedhën lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, rezultojnë të ishin derdhur në total 1.651.002 lekë nga paga dhe shpërblime që i takojnë periudhës së punës, viti 2014, si dhe një pagesë në shumën prej 117.059 lekësh, e cila i përkiste pagës së muajit dhjetor 2013.

- Nga balanca e llogarisë nr. (***), në monedhën lekë, në emër të personit të lidhur, në periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, rezultojnë të jenë derdhur në total 1.048.876,52 lekë nga paga dhe shpërblime, që i takojnë periudhës së punës, viti 2014, si dhe një pagesë në shumën 87.041,11 lekë, që i përket pagës së muajit dhjetor 2013.

3.2.66 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, konfirmohet për transaksionin e realizuar nga bashkëshortja e subjektit me shtetasin egjiptian A. M. B. për automjetin me targë AA (***), të cilën e ka pasur në pronësi për periudhën 17.10.2005 – 31.10.2014.

3.2.67 Shoqëria “L.” sh.p.k. ka konfirmuar likuidimin e shumës prej 82.132 eurosh për çmimin e ndërtesës, pagesë *cash* në arkën e shoqërisë, shoqëruar me mandatet përkatëse, si dhe likuidimin përmes bankës të vlerës së truallit në shumën 956.457 lekë.

Në përfundim, për deklarin e subjektit të rivlerësimit të datës 23.7.2018, për burimin e deklaruar të kësaj pasurie, lidhur me krijimin e gjendjes *cash* në shumën 4.122 euro, trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të provave, konkludoi se ky deklarin përputhet me dokumentacionin administrativ dhe bankar të siguruar gjatë hetimit administrativ.

Në lidhje me burimin e shumës 984.199 lekë (shpenzimet për truallin), sipas pikës 3.2.51

Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

3.2.68 Rezulton se në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, për këtë pasuri subjekti ka deklaruar: “*Trualli në të cilin ndodhet apartamenti dhe trualli përreth tij 521.8 m². Paguesa për procesin e legalizimit në shumën 984.199 lekë, bërë në datën 19.9.2013. Kontratë sipërmarrje nr. (***), datë 4.6.2012, dhe më pas kontratë shitblerjeje nr. (***), datë 20.8.2015*”.

3.2.69 Rezulton se lidhur me këtë burim, në datën 23.7.2018, për shpenzimet e truallit subjekti deklaroi si burim kursimet vjetore të tij në vitin 2009, në shumën 200.000 lekë; kursime vjetore të tij në vitin 2010, po në shumën 200.000 lekë; kursime vjetore familjare të vitin 2011, në shumën 500.000 lekë, si dhe të ardhura familjare të vitit 2013 në shumën 84.199 lekë.

3.2.70 Për të vërtetuar burimin e shumës 984.199 lekë, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Vërtetim nr. (***) prot., datë 26.1.2017, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për të ardhurat *neto* të subjektit nga paga për periudhën 4.11.2013 – 10.1.2017, si gjyqtar në këtë gjykatë;
- Vërtetim nr. (***) prot., datë 20.1.2017, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të ardhurat *neto* të personit të lidhur nga paga gjatë periudhës së punës pranë organeve tatimore;
- Kontratat e qirasë të sipërcituara.

3.2.71 Rezulton se në deklaratat periodike sipas deklarimeve për burimet e përdorura, subjekti ka deklaruar: në vitin 2009 “*Gjendje cash nga paga në shumën 200.000 lekë*” – 200.000 lekë; në vitin 2010, ka deklaruar: “*Shtesë e gjendjes cash për vitin 2010 nga kursime nga paga në shumën 200.000 lekë*”; në vitin 2011 subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “*Shtesa: gjendje cash nga kursimet vjetore familjare*” në shumën 500.000 lekë; në vitin 2013 subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “*Shtesa: gjendje cash (kursime familjare gjatë vitit)*” në shumën 300.000 lekë.

3.2.72 Nga ALUIZNI Durrës dhe ZVRPP-ja Durrës, konfirmohet pronësia në bashkëpronësi për pasuritë: truall me sip. 521 m², me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), dhe ndërtim (apartament banimi – *dupleks*), me sip. 79,83 m² + 29,12 m² + 79,81 m² + 17,68 m² = 206,44 m², me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), ndodhur në kompleksin rezidencial “L.”, në zonën e Gjirit të Lalzit, të shoqëruara me mandatpagesën nr. (***), datë 17.9.2013, në “Raiffeisen Bank”, shuma 15.955 lekë, nga z. Kastriot Selita (*pagesë cash në sportel*); mandatpagesë nr. (***), datë 17.9.2013, në “Raiffeisen Bank”, shuma 968.244 lekë nga subjekti i rivlerësimit.

3.2.73 Komisioni kreu analizën financiare në kuadër të verifikimit të aftësive financiare për të blerë pasuritë, për të kryer shpenzimet në raport me të ardhurat, për vitin 2013, pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 7

	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2013
Nr.	Pasuritë	(4,136,031)
1	LIKUIDITETE	(5,120,230)
	ALUIZNI për çmimin e truallit dhe përditësimit ap. të blerë nga “L.” sh.p.k.	984,199
	Të ardhurat	3,617,337
1	Paga	1,639,403
2	Paga e bashkëshortes	1,130,705
3	Të ardhura nga mësimdhënia në ATT Dogana	27,000
4	Dhënia me qira e ap. 126 m ²	504,756
5	Dhënia me qira e ap. komuna I.	315,473
	Detyrimet	(4,206,300)
1	Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit “L.” sh.p.k.	(4,206,300)
	Shpenzime	1,261,566
1	Udhëtime jashtë shtetit	711,566

2	Shpenzime jetike	550,000
	Balanca	2,285,502

3.2.74 Në përfundim, trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe të provave, si dhe të analizës financiare në tabelën e mësipërme, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka pasur aftësi paguese për pagesën e kontratës nr. (*) , datë 26.9.2013, mes ALUIZNI Tirana 3 dhe shoqërisë “L.” sh.p.k., për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, në shumën 968.244 lekë.**

3.2.75 Komisioni, për vërtetimin e fakteve dhe të burimit të të ardhurave, për pasurinë e apartament banimi (*dupleks*) të ndodhur në Gjirin e Lalzit, administroi nga institucionet publike e private dokumentacionin përkatës si më poshtë:

- Shkresa nr. (***) prot., datë 12.2.2018, dhe shkresa nr. (***) prot., datë 22.2.2018, dhe materialet bashkëlidhur të ZVRPP-së Tiranë;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 4.8.2018 dhe shkresa nr. (***) prot., datë 24.9.2018, dhe materialet bashkëlidhur të ZVRPP-së Lezhë;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 5.2.2018, dhe shkresa nr. (***) prot., datë 6.3.2018 dhe materialet bashkëlidhur të ZVRPP-së Durrës ;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 19.2.2018 dhe shkresa nr. (***) prot., datë 20.2.2018 dhe materialet bashkëlidhur të ZVRPP-së Mat;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 8.2.2018 dhe materialet bashkëlidhur nga ALUIZNI – Zonat Turistike Tiranë;
- Shkresat e institucioneve bankare: shkresa nr. (***) prot., datë 2.2.2018, shkresa nr. (***) , datë 16.2.2018, shkresa nr. (***) prot., datë 10.5.2018, shkresa nr. (***) prot., datë 25.6.2018;
- Shkresa e datës 20.8.2018 e shoqërisë “L.” sh.p.k.;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 20.8.2018, e shoqërisë “C.” sh.p.k.;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 15.2.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 13.2.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 14.8.2018 dhe shkresa nr. (***) prot., datë 19.10.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 12.2.2018, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 7.11.2018 dhe shkresa nr. (***) prot., datë 15.11.2018, të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore;
- Shkresa nr. (***) prot., datë 20.11.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë;
- Deklarimet e subjektit me anë të përgjigjeve të datës 14 gusht 2018 dhe të datës 19 tetor 2018, si dhe materialet bashkëlidhur;
- Analiza e të ardhurave nga paga dhe e burimeve të tjera të ligjshme deri në fund të vitit 2016;
- Materiale shkresore të ndryshme të siguruara nga hetimi administrativ, i ushtruar nga ILDKPKI-ja; shkresë nr. (***) prot., datë 21.7.2017, “kthim përgjigjeje” e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, pranë ILDKPKI-së.

Në përfundim, për pasurinë apartament banimi (*dupleks*) dhe truall i ndodhur në Kompleksin Rezidencial “L.”, Durrës, deklaruar në deklaratën “Vetting”, trupi gjykues sa më sipër arsyetuar, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, në kuptim të nenit 30 dhe nenit 33, pika 5 “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm krijimin e kësaj pasurie në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

4. Automjet, tip “Daimler Chrysler” (D) 211, me targë AA(*)**

4.1 Rezulton se në deklaratën “Vetting” për vitin 2017 subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë me kontratën nr(***), datë 1.12.2009, në shumën: 11.000 euro; pjesa takuese: 100 %, me burim të deklaruar në shumën 900.000 lekë: “Të ardhura nga vendimi i pjesëtimit nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë” dhe në shumën 4.000 euro: “Dhuratë nga vëllai, H. S., emigrant në Luino, Itali, që në vitin 2004 e në vazhdim”.

4.2 Për të vërtetuar burimin e tyre, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI këto dokumente:

- Kontratë shitjeje nr. (***), datë 6.12.2003;
- Aktmarrëveshje, datë 6.6.2006, për pjesëtim me marrëveshje të pasurisë mes znj. A. Gj. (ish-bashkëshortja) dhe z. Kastriot Selita;
- Vendim nr. (***), datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë, që miraton marrëveshjen;
- Kontratë shitblerjeje automjeti nr. (***), datë 1.12.2009;
- Deklaratë noteriale nr. (***), datë 24.1.2017, të nënshkruar nga vëllai i tij z. H. S. .

4.3 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2009 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti tip “Mercedez Benz”, me vlerë 11.000 euro dhe si burim ka deklaruar:

- shumën 4.000 euro, dhuratë nga vëllai i tij, H. S., i cili punon në Luino, Provinca Varese në Republikën e Italisë, si dhe
- shumën 7.000 euro (966.000 lekë), pakësimi i gjendjes *cash*, në shumën 11.000 euro.

4.4 Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë (shoqëruar me dosjet e automjeteve në emër të subjektit dhe të personit të lidhur), konfirmohet transaksioni i realizuar me shtetasin M. E. D. për makinën me targë AA(***).

4.5 Komisioni konstatoi se burimet e deklaruara nga subjekti për krijimin e këtij asetit nuk plotësonin shumën e plotë të kontratës. Për këtë subjekti deklaroi se për shkak të një gabimi në printim, të sqaruar edhe te pyetja e mëparshme, edhe te deklarimi për blerjen e makinës, nuk shfaqet fjalia e fundit. Burimi i të ardhurave për blerjen e makinës ishte:

- vlera 900.000 lekë të ardhura nga vendimi i pjesëtimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. (***) akti, nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006;
- vlera 4.000 euro dhuratë nga vëllai, H. S., emigrant në Luino, Itali që në vitin 2004 e në vazhdim;
- vlera 66.000 lekë, nga të ardhurat vjetore nga paga për vitin 2009.

Nga të ardhurat në shumën 983,928 e përfituara në vitin 2009 është kursyer shuma 200.000 lekë dhe, përveç shpenzimeve të tjera të këtij viti, shuma 66.000 lekë është përdorur për blerjen e makinës, pra, realisht ka ulur vlerën e kursimeve të vitit, të cilat nëse kjo shumë nuk do të ishte përdorur për blerjen e makinës, kursimet do të ishin në vlerën 266.000 lekë, por për shkak të përdorimit të kësaj shume, janë në vlerën 200.000 lekë.

4.6 Komisioni kreu analizën financiare në kuadër të verifikimit të aftësive financiare për të blerë këtë pasuri, për të kryer shpenzimet në raport me të ardhurat për vitin 2009, pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

4.7 Nga analiza financiare në vitin 2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur aftësi paguese për blerjen e automjetit në vitin 2009 dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera.

Tabela nr. 8

ANALIZA FINANCIARE	Viti 2009
Të ardhurat	1,532,608
Paga e tij	983,928
Paga e bashkëshortes	
Pasuritë	-107,111
Blerje automjeti (11 000 euro)	1,508,870
Shtim/pakësim i gjendjes së likuiditeteve <i>cash</i>	-1,615,981
Shtim i gjendjes së likuiditeteve <i>cash</i> , bashkëshortja	
Detyrimet	-800,000
Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit "C." sh.p.k.	-800,000
Pasuritëneto	692,889
Shpenzime	508,609
Shpenzime për qira banese	40,000
Udhëtime jashtë shtetit	188,609
Shpenzime jetike	160,000
Shpenzime qiraje për banim në Peshkopi	120,000
DIFERENCA	331,110

4.8 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruara nga vëllait i tij në shumën 4.000 euro në vitin 2009, subjekti ndër të tjera deklaroi: *"Vëllai, H. S., ka jetuar si emigrant në Luino, Itali nga viti 2004 e në vazhdim. Të ardhurat e fituara nga puna në Itali, në ndërtim, si dhe nga shërbime të tjera, janë dërguar në mënyrë të vazhdueshme në Shqipëri, pranë familjes, si cash, ashtu edhe nëpërmjet transfertave përmes institucioneve financiare jobankë ("Western Union", "MoneyGram"). Kam depozituar dokumentacion provues të detajuar në lidhje me dërgesat e shumave në euro nëpërmjet "Western Union" dhe "MoneyGram" për vitin 2009, si në tabelën e mëposhtme (tabela nr. 9). Nga shumat e poshtëcituar, shuma 4.000 euro më është dhuruar nga vëllai, për blerjen e makinës, të cilën e kam deklaruar respektivisht në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009."*

Tabela nr. 9

Nr.	Institucioni financiar jo bankë	Data e dërgimit	Numri i referencës	Dërguesi	Shuma e dërguar
1	MoneyGram	18.6.2009	46534288	Xh. Ll.	2,500 euro
2	MoneyGram	19.6.2009	94279743	Xh. LL.	1,000 euro
3	MoneyGram	3.7.2009	92248463	R. C.	1,500 euro
4	Western Union	3.12.2009	499-400-2653	H. S.	1,000 euro

4.8.1 Për provuar burimet e ligjshme të shumës së dhuruar subjekti ka depozituar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklarimet e të ardhurave nga punësimi në organet shtetërore në Itali (Istituto Nazionale Previdenza Sociale) për periudhën 2009 e në vazhdim, në shumën 4.204 euro, nga punëdhënësi R. C.;

- Dokumentacioni që provon marrëdhëniet e punës të vëllait me shtetasin italian R. C.;
- Dokumentacion, certifikatat familjare që vërtetojnë se ka lidhje farefisnore me znj. Xh. Ll.(vajza e hallës).
- Kopje e pasaportës së të vëllait, sipas të cilës provohet hyrja në Itali në datën 4.10.2004.
- Kopje e dokumentit të dërguar nga kompania “MoneyGram” SHBA për konfirmim të pagesave të dërguara nga vëllai nëpërmjet kompanisë “MoneyGram” në Shqipëri, si dhe mandatet përkatëse;
- Vërtetim nga “Western Union” në lidhje me pagesën e dërguar nga i vëllai nëpërmjet kompanisë “Western Union” në Shqipëri, si dhe mandate përkatëse;
- Ekstrakt të llogarisë së sigurimeve shoqërore për të ardhurat e vëllait, lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në Itali.

4.9 Lidhur me burimin tjetër në shumën 900.000 lekë, për të cilën subjekti ka dorëzuar dokumentacionin, vendimin e pjesëtimit nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, arsyetimi e kësaj të ardhure u trajtua për sa më sipër në pikën 3.2.21 të këtij vendimi.

4.10 Komisioni nisur nga parashikimi kontraktual për blerjen e kësaj pasurie se çmimi prej 11.000 eurosh do të paguhej pas regjistrimit të makinës në emër të blerësit, i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me mënyrën e pagesës së çmimit të makinës, të shoqëruar me provën përkatëse, për të cilën deklaroi se kjo pagesë ishte bërë *cash*.

4.11 Rezulton se Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë ka lëshuar certifikatë pronësie për automjetin me targë TR (***), me pronar subjektin e rivlerësimit, në bazë të kontratës së shitblerjes nr. (***), datë 1.12.2009, por nuk rezultoi asnjë dokument ligjor që vërteton dorëzimin fizik apo kalimin me bankë të shumës 11.000 euro ose 966.000 lekë dhe 4.000 euro nga blerësi te shitësi.

4.12 Në përfundim, për këtë pasuri trupi gjykues konkludoi se: deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” për burimet e përdorura për këtë pasuri përputhej me rezultatet e hetimit administrativ dhe se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit. Por, pagesa e shumës prej 11.000 eurosh për blerjen e automjetit shitësit, nuk mbështetej në asnjë dokument shkresor që vërtetonte dorëzimin e kësaj shume. Për këtë Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

4.13 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. (***), datë 1.4.2019, të shitësit, sipas së cilës vërtetohet dorëzimi i shumës 11.000 euro në momentin e marrjes në dorëzim të autoveturës.

Në përfundim: për pasurinë autoveturë, tip “Daimler Chrysler”, të deklaruar në deklaratën “Vetting”, trupi gjykues, për sa më sipër arsyetuar, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, në kuptim të nenit 30 dhe nenit 33, pika 5 “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm krijimin e kësaj pasurie në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, përmes verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016 ka dërguar raportin nr. (***) prot., datë 2.11.2017 për

kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, të deklasifikuar me vendim nr. (***) , datë 11.5.2018, të KDZH-së, ku ka konstatuar se:

Në përfundim të veprimeve të kryera verifikuese, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita për vazhdimin e detyrës.

Komisioni, në bazë të një indicje të dhënë nga denoncimi nr. (***) prot., datë 15.2.2019, të një grupi gjyqtarësh të Gjykatës Administrative të Apelit, kreu verifikime të thelluara prej institucioneve kompetente lidhur me kontrollin e figurës, por në përfundim nuk arriti në një konkluzion për provueshmërinë e tyre. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Inspektorati i KLD-së, aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka hartuar raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit⁴⁶. Ky raport është bazuar: në formularin e vetëdeklarimit; në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti; në 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së. Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së për dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga analizimi i të dhënave në të teta dosjeve, referuar neneve 71-76 të ligjit të statusit për kriteret e vlerësimit, ky institucion për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit ka parashtruar se:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit analizon normat ligjore të zbatueshme (shihni dosjet 1 dhe 4); përdor jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Kushtetutës dhe KEDNJ-it (shihni dokumentin 2, si dhe dosjet 3 dhe 5); i kushton vëmendje respektimit të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta (shihni dosjet 1 dhe 3); në 1 rast, ka zhvilluar hetim të pjesshëm gjyqësor, duke mos e konsideruar të plotë hetimin e zhvilluar nga shkalla e parë (shihni dosjen 3); ndër 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 4 prej tyre, nga ku ka rezultuar se në një rast Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit (shihni dosjen 5), ndërsa në të tria rastet e tjera ende nuk ka përfunduar shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të dhënë prej gjyqtarit Kastriot Selita prej Gjykatës së Lartë (shihni dosjet 1, 2 dhe 3).

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej subjektit janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore në raport me faktet e konstatuara. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe nga 5 dosjet e vëzhguara që të jetë cenuar nga Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. I kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat ka arsyetim dhe tregon shkakun ligjor (*shihni* dosjet nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5).

⁴⁶ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 9.2.2018.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga analizimi i ngarkesës në punë të subjektit të rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, kur ka kryer edhe detyrën e kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, ai ka deklaruar se në periudhën 2014 – 2016 i janë caktuar për gjykim 1488 çështje gjyqësore, prej të cilave ka përfunduar 1093 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 73.4 %.

- *Për respektimin e afateve të gjykimit të dhënat referojnë se dy nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar tej afatit ligjor, “brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”, i përcaktuar nga pika 2, e nenit 48, e ligjit nr. 49/2012.*

Në analizim të shkaqeve rezulton se:

- çështja në dosjen nr. 3, e cila ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, 4 muaj e 12 ditë, ka qenë çështje themeli e shqyrtuar në seancë gjyqësore, ku është vendosur përsëritja e pjesshme e hetimit gjyqësor të zhvilluar nga shkalla e parë e gjykimit dhe, në përfundim, është disponuar me vendim për ndryshimin e vendimit administrativ të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e pjesshëm të padisë.

- çështja në dosjen nr. 2 është gjykuar përtej afatit 30-ditor, por kalimi i afatit ka ardhur për shkakun se brenda periudhës së gjykimit ka qenë muaji gusht, periudhë në të cilën përkon leja vjetore e gjyqtarëve me ligj. Duke përjashtuar këtë periudhë, konstatohet se gjykimi është realizuar brenda afatit standard të gjykimit.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Kastriot Selita është verifikuar një rast vonese në arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. (***) datë 29.9.2014, rast në të cilin është konstatuar vonesë prej 37 ditëve nga shpallja dhe, në përfundim, ky rast⁴⁷ i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik (shihni te “Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së”).

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Për aftësitë për kryerjen e procedurave gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes: në gjykimet që i përkasin dosjeve të mbyllura me një seancë të vetme në dhomë këshillimi (shihni dosjet 1, 2, 4 dhe 5), gjykimi ka filluar saktësisht në datën dhe orën e planifikuar.

Në çështjen gjyqësore, e cila është gjykuar me seanca gjyqësore publike, një pjesë e seancave gjyqësore është dokumentuar me regjistrim audio (shihni dosjen 3).

Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka disponuar me urdhër për caktimin e seancës në dhomë këshillimi, si dhe ka përgatitur relatimin me shkrim, referuar nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012.

- Subjekti ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore, ka mbikëqyrur dokumentimin e veprimeve me procesverbal në dhomë këshillimi, i cili është mbajtur sipas parashikimeve të nenit 49/3 të ligjit nr. 49/2012 dhe të procedurës civile.

- Procesverbali i seancës është i firmosur në fund të fletës nga sekretarja gjyqësore dhe në fund të tij nga trupi gjykues ose nga kryesuesi dhe sekretarja gjyqësore.

- Subjekti i rivlerësimit është kujdesur për aktet e njoftimit të palëve, të cilat janë bërë në bazë të parashikimeve të nenit 49/2 të ligjit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

⁴⁷ KLD-ja e lidh me ngarkesën e madhe që ka kjo gjykatë.

Subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke punuar në fushën e së drejtës administrative.

Sipas të dhënave, nga dosjet e denoncimeve, por edhe nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit.

b) Integriteti

Nga dosjet e shortuara të denoncimeve nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga dosjet e shortuara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në dosjet gjyqësore të verifikuara, në procesverbalin gjyqësor, nuk ka të dhëna për mënyrën e drejtpërdrejtë të komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, por vërehet se gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nga dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike për aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, por vërehet se nuk është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe në depozitim të dosjes në sekretarinë çka mund të konsiderohet si një tregues bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe me administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë (administrative) që kryen, i nënshtrohet detyrimit të programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 7 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shihni të dhënat e trajnimit në tre vitet e fundit). Në formularin e vetëvlerësimit, gjyqtari Kastriot Selita ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrës në 7 aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Inspektorati i KLD-së për tetë⁴⁸ çështjet gjyqësore për të cilat është hartuar ky raport, konstatoi tejkalime të afateve të gjykimit, si dhe në një rast, vonesë të dorëzimit të dosjes së përfunduar si më poshtë vijon:

II/1 Gjykimi që i përket vendimit nr. (***) , datë 19.2.2016, ka zgjatur 3 muaj e 7 ditë – duke tejkaluar afatin 30-ditor të përcaktuar nga pika 2, e nenit 48, e ligjit nr. 49/2012.

⁴⁸ Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, si dhe pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

II/2 Gjykimi që i përket vendimit nr. (***), datë 30.11.2016, ka zgjatur 1 muaj e 23 ditë – jashtë afatit 30-ditor të përcaktuar nga pika 2, e nenit 48, e ligjit nr. 49/2012.

II/3 Gjykimi i çështjes gjyqësore (konflikt pune) i përfunduar me vendimin nr. (***), datë 23.9.2014 nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 25.7.2016 – 23.9.2014, duke tejkaluar afatin 30-ditor të përcaktuar nga pika 2, e nenit 48, e ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, në përlllogaritjen e kësaj të dhëne duhet vërejtur se muaji gusht përkon me lejen vjetore e gjyqtarëve.

II/4 Dosja e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 16.3.2016, është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 30.3.2016 – pas 14 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 7-ditor të parashikuar nga pika 3, e nenit 55, e ligjit nr. 49/2012.

Për konstatimet për tejkalim të afateve për rastet e evidentuara në pikat II/1, II/2 II/4, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij të datës 16.4.2019, ndër të tjera ka renditur veprimet e ndërmarra për çdo rast: për dosjen gjyqësore me palë paditëse “A.” sh.a. dhe me të paditur Ministrinë e Financave Tiranë, ka shpjeguar se në datën 13.11.2015 është hedhur në short elektronik, ku subjekti ka qenë relator i çështjes; referuar nenit 48/2 të ligjit 49/2012, në të cilin citohet: “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”, janë kryer veprimet procedurale për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi. Sipas, regjistrit të veprimeve, i printuar nga sistemi ICMIS, dhe pas shpalljes së listës së gjykimit datë 19.11.2015, ishte caktuar data 7.12.2015 për gjykimin në dhomë këshillimi. Diferenca në ditë kalendarike midis datës së regjistrimit dhe datës së gjykimit në dhomë këshillimi ishte 25 ditë kalendarike, brenda afatit të përcaktuar në nenin 48/2, të ligjit 49/2012. Për sa më sipër, rezulton e provuar se çështja është planifikuar për gjykim brenda afatit 30-ditor. Referuar procesverbalit të dhomës së këshillimit të datës 7.12.2015, gjykimi (në dhomë këshillimi) ishte shtyrë për shkak se njëri nga anëtarët e trupit gjykues kishte paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje dhe në po këtë datë, për këtë shkak, gjykimi është shtyrë për në datën 22.12.2015, pra, 15 ditë kalendarike.

Në datën 22.12.2015, gjykata e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi dhe, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 51 dhe në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në datën 22.1.2016, ora 09:30, për sqarimin e rrethanave faktike. Në këto kushte, gjykimi i çështjes në dhomë këshillimi është bërë në respektim të kërkesave të nenit 48/2, të ligjit nr. 49/2012, brenda afatit 30-ditor, ndërsa përfundimi i gjykimit tej afatit 30-ditor ka ardhur për shkak të zëvendësimit të gjyqtarit pas heqjes dorë, si dhe kalimit të çështjes për gjykim në seancë gjyqësore.

Data e caktimit në seancë gjyqësore është një muaj për shkak të ngarkesës me gjykime, procesit të mbartjeve çdo fillim viti (numri i çështjeve të mbartura në Gjykatën Administrative të Apelit, nga viti 2015 në vitin 2016 ka qenë 12000 çështje). Gjithashtu, në planifikimin e datës së seancës gjyqësore kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë, si planifikimi i gjykimeve të tjera në periudhën nga data 8.1.2016 – 22.1.2016, fakti që njëri nga anëtarët e trupit gjykues ka qenë në përbërje të një trupi tjetër gjykues, me gjykime të planifikuara (përpara datës 22.1.2016), me këtë të fundit. Subjekti ka shpjeguar mbajtjen e seancave gjyqësore dhe veprimet e ndërmarra⁴⁹ në çdo seancë.

Për dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. (*)**, datë 30.11.2016, subjekti ka shpjeguar se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën Administrative sipas përcaktimeve të neneve 10/2

⁴⁹ Referojuni shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar.

dhe 12/2, të ligjit 49/2012 si juridiksion fillestar, për rrjedhojë, Gjykata Administrative e Apelit, në lidhje me këtë gjykim funksionon si gjykatë e shkallës së parë, për shkak se objekti i padisë ishte shfuqizimi i një akti nënligjor me karakter normativ. Gjykimi i kësaj çështjeje i nënshtrohet rregullave të gjykimit në shkallë të parë dhe nuk është nën veprimin e nenit 48/2 të ligjit nr. 49/2012. Subjekti ka parashtruar të gjitha veprimet e detyrat për çdo seancë gjyqësore të zhvilluar.

Për dorëzimin e dosjes gjyqësore përfunduar me vendimin nr. (*)**, datë 16.3.2016, jashtë afatit 7-ditor të parashikuar nga pika 3, e nenit 55, e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se e ka dorëzuar në afat pikërisht ditën e 6 të punës, datat në vijim kanë përkuar me ditë kalendarike pushimi, festa zyrtare, si dhe ditë ku subjekti ka qenë i angazhuar në konferenca gjyqësore, duke bashkëlidhur dhe linket për njoftimin e tyre.

Në përfundim, lidhur me tejkalimin e afateve për tria rastet, në analizim të veprimeve të ndërmarra për çdo rast, si dhe në vlerësim të provave që subjekti depozitoi, trupi gjykues çmon se ato janë tërësisht të lidhura me arsyet ligjore objektive që nuk mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

Denoncimet e paraqitura në Komision

Në Komision janë depozituar **17 denoncime** nga publiku për subjektin e rivlerësimit.

1. Për rastet e paraqitura Komisioni kreu hetim të zgjeruar.

1.1 Pas kryerjes së hetimeve rezultoi se dy denoncime⁵⁰ i përkitnin të njëjtit denoncues dhe kishin të njëjtin objekt denoncimi; një denoncim⁵¹ nuk i përkiste subjektit të rivlerësimit, tri⁵² denoncime nuk plotësonin kërkesat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; tri⁵³ denoncime ishin të lidhura me themelin e çështjes, ndërsa dy⁵⁴ denoncime nuk përmbushnin kërkesat e nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, por njëkohësisht ishin të lidhura edhe me themelin e çështjes.

Pas hetimeve të gjashtë denoncimeve Komisioni konstatoi se:

1.2.a Shtetasi R. D.⁵⁵ e ka denoncuar subjektin për shkelje të etikës profesionale dhe për zvarritje të procesit, pasi ka lënë në fuqi një vendim në kundërshtim me ligjin, vendim ky që sipas denoncuesit kishte shkuar tri herë në Gjykatën e Apelit, dy herë ishte zgjatur, ndërsa herën e fundit ishte përshpejtuar për arsye korruptuese. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin e Gjykatës Administrative, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit është pjesë e trupit gjykues.

Nga verifikimi i vendimit gjyqësor rezulton se kjo çështje gjyqësore është gjykuar në disa shkallë, si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e në vijim nga gjykatat administrative.

Komisioni, në lidhje me këtë rast denoncimi, i kërkoi KLD⁵⁶-së inspektimin e dosjes gjyqësore të vendimit nr. (***) , datë 1.11.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dhënien e

⁵⁰ Denoncimi nr. (***) prot., datë 28.12.2017, i shtetasit R. K. dhe denoncimi nr. (***) prot., datë 9.5.2018, i po këtij shtetasi.

⁵¹ Denoncimi nr. (***) prot., datë 19.6.2018, i shtetasit S. B.

⁵² Denoncimi nr. (***) prot., datë 23.3.2018, i shtetasit K. GJ.; denoncimi nr. (***) prot., datë 30.5.2018 i shtetasit K. D.; denoncimi nr. (***) prot., datë 26.2.2018, i shtetasës M. K.; denoncimi nr(***)prot., datë 1.11.2018 i shtetasit V. Q.

⁵³ Denoncimi nr. (***) prot., datë 2.7.2018, i shtetasit F. D.

⁵⁴ Denoncimi nr. (***) prot., datë 15.1.2018, i kantierit të ndërtimit të anijeve; denoncimi nr. (***) prot., datë 23.1.2018 i shtetasit P. C.

⁵⁵ Denoncimi nr. (***) prot., datë 7.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Shkresa nr. (***) prot., datë 24.10.2018.

mendimit të saj. Ky institucion ka dhënë vlerësimin e saj vetëm për aspektet formale, si dhe është shprehur se pretendimet e denoncuesit i takojnë gjykimit të çështjes në një shkallë më të lartë, për sa kohë ai ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në kuadër të verifikimit të denoncimit, por edhe të disponimit të materialeve të dosjes gjyqësore, Komisioni analizoi trajtimin e kërkesës së denoncuesit në aspektin procedural, për të kuptuar nëse ishin garantuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe nga një gjykatë kompetente.

Komisioni konstatoi se Gjykata Administrative e Apelit nuk kishte sqaruar nëse interpretimi i vendimit të themelit të dhënë nga gjykata civile ishte kompetencë lëndore e gjykatës së shkallës së parë administrative, në referim të kushteve ligjore të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: “...gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ka dhënë, kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.”, pra, interpretimin e bën gjykata që ka dhënë vendimin (në këtë rast gjykata e shkallës së parë, e cila ka trajtuar themelin), për rrjedhojë, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 2, të nenit E, të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime të detajuara për ecurinë e çështjes, si dhe vuri në dispozicion vendimin nr. (***) , datë 13.4.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, përmes së cilës është trajtuar çështja e kompetencës, si dhe në kushtet që ky vendim ishte i formës së prerë, ka zgjidhur në mënyrë përfundimtare çështjen e kompetencës dhe ka qenë i detyrueshëm për t’u zbatuar sipas përcaktimeve të nenit 451/a, të Kodi i Procedurës Civile.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit janë bindëse, si dhe çmon se pretendimet e tjera të denoncuesit janë të lidhura me themelin e çështjes, për sa kohë që denoncuesi ka ushtruar mjetet e tjera ligjore të ankimit në shkallët me të larta të gjyqësorit.

1.2.b Shtetasi T. B. e ka denoncuar⁵⁷ subjektin për korrupsion dhe për aftësi profesionale, se nuk ishte njoftuar për datën dhe për orën e seancës, për llojin e gjykimit, si dhe për faktin se kishte marrë dijeni një vit e gjysmë me vonesë. Denoncuesi ka bashkëlidhur printime nga sistemi i Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe dëftesën e komunikimit të vendimit datë 10.7.2017.

Ka rezultuar se në çështjen gjyqësore, me vendimin nr. (***) , datë 23.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Korçë, banesa i ishte kthyer ish-pronarit (N. V.), duke vendosur që shteti t’i paguante denoncuesit dëmshpërblim në një shumë të barabartë me çmimin e blerjes së banesës, por të indeksuar në momentin e likuidimit.

Një pagesë e tillë nuk rezultoi të ishte bërë asnjëherë dhe, nga ana tjetër, shtetasi N. V. ka kërkuar gjyqësisht që t’i kthehet sendi që i ishte kthyer me vendimin e KKKP-së së Bashkisë Korçë. Me vendimin e datës 13.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendosi pranimin e padisë dhe detyrimin e shtetasit T. B. t’ia kthejë sendin shtetasit N. V. . I padituri ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila me vendimin e datës 9.6.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë të datës 13.11.2013.

Gjatë studimit të vendimit gjyqësor të çështjes në fjalë, Komisioni konstatoi se trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit rendit një sërë dispozitash ligjore, akte normative dhe konkluzione të Gjykatës Kushtetuese, të cilat rregullojnë mënyrën e sistemit me strehim nga Enti Kombëtar i Banesave në bashkëpunim me banka të nivelit të dytë, nëpërmjet financimit pjesërisht me fonde publike e pjesërisht me kredi me interesa të buta, të banesave për personat

⁵⁷ Denoncimi nr. (***) prot., datë 28.12.2017, në dosjen e Komisionit.

e pastrehë, si rezultat i procedurave të kthimit të banesave subjekteve të shpronësuara, por nga ana tjetër dukej se ato nuk përputheshin me objektin e kërimit.

- Komisioni, për sa më sipër konstatuar, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në pikën 2, të nenit E, të Kushtetutës, i kërkoi shpjegime subjektit, pasi: a) dukej se në vendimin nr. (***) datë 10.12.2015, kërkitimi i paditësit nuk përkonte me bazën ligjore dhe me jurisprudencën kushtetuese që adreson këto kërkitime. Konkretisht, realizimi i së drejtës me karakter monetar, sipas vendimit të formës së prerë të KKKP-së, nuk është konsistent me rregullimet ligjore të aktit normativ nr. 3, miratuar me ligjin nr. 82/2012, datë 13.9.2012, “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm”, i cili nuk duket që merr përsipër të trajtojë çështjet e dëmshpërblimit të drejtë sipas një vendimi të formës së prerë, por marrëdhënie të pazgjdhura mes qiraxhinjve dhe pronarëve. Kjo, sipas jurisprudencës kushtetuese të vendimit nr. (***)/2010, “Për kualifikimin e vendimeve të KKKP-së”, sipas ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, i ndryshuar. Trupi gjykues në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, por edhe të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, i kërkoi shpjegime subjektit edhe për shkaqet që sollën vonesën e komunikimit të këtij vendimi.

- Komisioni, në lidhje me këtë rast denoncimi, i kërkoi KLD⁵⁸-së inspektimin e dosjes së vendimit në fjalë të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dhënien e mendimit të saj. Ky institucion, e dha vlerësimin e tij vetëm për aspektet formale, si dhe u shprehu se pretendimet e denoncuesit i takonin gjykimit të çështjes në një shkallë më të lartë, për sa kohë ai ka ushtruar rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

- Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij të datës 16.4.2019, ndër të tjera, ka parashtruar se ai i është përmbajtur tërësisht objektit të kërimit, i cili ka qenë përkufizuar: “... *detyrimin e palëve të paditura t’u paguajnë paditësve vlerën e plotë dhe reale të banesës, që me vendimin nr. (***) datë 23.12.1994, të KKKP-së së Bashkisë Korçë i është njohur dhe i është kthyer ish-pronarit, B. V., në vlerën 4.802.150 lekë*”. Subjekti ka shpjeguar se kanë qenë pikërisht kërkitimet e padisë, ato të kanë referuar shkakun ligjor të ngritjes së tyre, me referencë ligjore ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” dhe ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Kërkitimet e paditësit kanë pasur konsistencë të plotë ligjore me të drejtën e përcaktuar në bazë të pikës 4, të vendimit nr. (***) datë 23.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Korçë, me nenin 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (para shfuqizimit nga Gjykata Kushtetuese), si dhe me vendimin nr. 12, datë 21.3.2000, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është vendosur: “Shfuqizimi si i papajtuësëm me Kushtetutën i frazës që përmban neni 10, paragrafi i I, i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, me përmbajtje “...ndërsa personave të tretë shteti u kthen masën e shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, e konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve”. Gjykata Administrative e Apelit e ka vlerësuar dhe e ka zgjidhur çështjen në themel, bazuar në shkakun ligjor të referuar, sikurse ka qenë ai pas shfuqizimit të frazës së nenit 10/1, të ligjit nr. 7678/1993.

- Lidhur me vonesën e komunikimit të vendimit subjekti ndër të tjera ka shpjeguar se komunikimi i datës dhe i orës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, si dhe përbërja e trupit gjykues është bërë nëpërmjet shpalljes së rregullt sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Gjykatës së Apelit www.gjykataadministrativeapelit.al. Komunikimi i aktit ishte kryer nga sekretaria gjyqësore, e cila ishte kthyer nga posta shqiptare me shënimet “Larguar”, “Ka ndërruar adresë”, si dhe kishte rezultuar se adresa e re e paditësit nuk i ishte njoftuar asnjëherë gjykatës nga pala paditëse dhe, në këto rrethana, dosja gjyqësore ishte nisur në Gjykatën Administrative të

⁵⁸ Shkresa nr. (***) prot., datë 24.10.2018.

Shkallës së Parë Korçë. Subjekti ka depozituar shkresën nr. (***) prot., datë 2.4.2019, të Gjykatës së Lartë, referuar kërkesës për kopje të dëftesave të komunikimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Subjekti ka theksuar se në datën e shpalljes së vendimit, vendimi ishte shpallur (pjesa e dispozitivit), në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit, në rubrikën “Vendime”, sipas praktikës së ndjekur që nga koha e hapjes së kësaj faqeje zyrtare.

Sa më sipër, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse, nuk rezultojnë elemente që të kishin cenuar anën procedurale të procesit, rezulton se subjekti e mbështet vendimin e dhënë, sipas bindjes dhe logjikës⁵⁹ së trupit gjykues, ndërsa ligjshmëria e vendimmarrjes lidhur me themelin e çështjes vendoset nga shkallët me të larta gjyqësore, për sa kohë që denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit. Lidhur me komunikimin e vendimit, subjekti provoi se kishte ndërmarrë të gjitha masat për komunikimin e tij, si përmes rrugës postare, edhe nëpërmjet komunikimit në faqen zyrtare të institucionit.

1.2.c Shtetësja M. Z., përmes denoncimit⁶⁰ nr. (***) prot., datë 26.1.2018, e ka denoncuar subjektin për proces jo të rregullt ligjor, për vendim të padrejtë dhe për korrupsion, pasi në çështjen penale në vitin 2008 në ngarkim të të birit të saj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, për të cilin po kjo gjykatë në vitin 2006 kishte caktuar denoncuesen (të ëmën) si kujdestare të tij. Prej saj pretendohet se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ajo nuk ishte njoftuar të merrte pjesë në proces si kujdestare ligjore e të pandehurit, si dhe se i biri ishte shpallur fajtor për vrasje dhe ishte dënuar *pa të drejtë për të mbuluar fajtorin e vërtetë*, i cili, sipas saj, ishte i biri i një gjyqtari në Gjykatën e Apelit Tiranë. Denoncimi është shoqëruar me vendimin nr. (***), datë 26.9.2006, dhe me vendimin nr. (***), datë 3.6.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Komisioni,⁶¹ nga analizimi i fakteve dhe i rrethanave të paraqitura, vërejti se denoncoheshin shkelje të natyrës procedurale, që lidhen me mosnjoftimin e kësaj denoncueseje, por dhe për një proces të parregullt ligjor. Në këtë drejtim, për të disponuar dosjen, por edhe për t’u bërë një verifikim nga KLD-ja si një institucion vlerësues, Komisioni i kërkoi kësaj të fundit një raport shtesë për çështjet e kërkuara për verifikim.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pas verifikimit dha vlerësimin e tij, duke konkluduar se në kryerjen e procedurave janë respektuar të gjitha të drejtat ligjore procedurale që lidhen me thirrjen në proces, me mbrojtjen dhe me përfaqësimin, si dhe me dakordësinë e palëve me vendimin e trupit gjykues, për shkak se nuk rezultojnë të jenë ankimuar.

Pavarësisht vlerësimit të KLD-së, Komisioni konstaton se sipas dispozitivit të vendimit të dhënë në vitin 2008, djali i denoncueses ishte dënuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, “mbajtje pa leje të armëve luftarake” me burgim të përjetshëm.

- Në vlerësim të rrethanave, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, pasi dukej se në rastin e denoncuar në gjykimin penal të vitit 2008, me të pandehur të birin e denoncueses, nga subjekti ishte gjykuar dhe ishte dënuar një person për të cilin më parë, në vitin 2006, ishte disponuar me heqjen e zotësisë për të vepruar për shkak të problemeve të tij me shëndetin mendor.

⁵⁹ Bazuar në nenin pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr.96/2016;

⁶⁰ Denoncimi nr. (***) prot., datë 26.1.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶¹ Referojuni korrespondencës së Komisionit me KLD-në dhe shkresës nr. (***) prot. datë 14.11.2018 të KLD-së, në dosjen e Komisionit.

- Në shpjegimet e tij subjekti i rivlerësimit ndër të tjera parashtroi se gjykimi i kërkesës me objekt “heqjen e zotësisë për të vepruar” ka qenë një gjykim civil, ku janë respektuar të gjitha urdhërimet e Kodit të Procedurës Civile. Në gjykimin e kësaj çështjeje penale⁶² sipas përcaktimeve të neneve 15, 16, 17, të Kodit të Procedurës Penale, pjesëmartja në gjykimin e heqjes së zotësisë për të vepruar në një procedim tjetër nuk përbënte shkak për heqje dorë apo për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi i një çështjeje tjetër që i përket një procedimi tjetër penal. Denoncuesja, sipas prokurës së lëshuar, ka zgjedhur avokatin mbrojtës, të cilit i ka dhënë tagrat dhe të drejtat sipas përmbajtjes së prokurës. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës vendimin nr. (***) , datë 9.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

Për sa më sipër, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë faktet se: (i) denoncuesja i ka ushtruar të gjitha mjetet ligjore të ankimit pasi rezulton se kjo çështje⁶³ ka marrë formë të prerë në apel dhe është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, duke mos u pranuar rekursi; (ii) Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj të datës 9.3.2011, ka gjykuar çështjen në fjalë, duke konkluduar për ekzistencën e një procesi të rregullit ligjor, çmton se shpjegimet dhe provat e subjektit janë bindëse, si dhe pretendimet e denoncueses janë zgjidhur pikërisht nga shkallët më të larta gjyqësore.

1.2.ç Shtetasi Sh. S. e ka denoncuar⁶⁴ subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë dhe për zvarritje të çështjes nga muaji mars 2015 deri në muajin qershor 2017.

- Për verifikimin e pretendimit të zvarritjes, KLD⁶⁵-ja ka dhënë vlerësimin e saj për këtë çështje vetëm për aspektet formale, si dhe është shprehur se pretendimet e denoncuesit për vendim të padrejtë janë çështje që i takonin gjykimin në një shkallë më të lartë, duke qenë se edhe denoncuesi ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në lidhje me afatin e gjykimin dhe të mbajtjes së dosjes për më shumë se 1 vit e 9 muaj, KLD-ja ka dhënë mendimin se kjo rrethanë justifikohet nga ngarkesa tepër e lartë e kësaj gjykate, fakt i bërë me dije shpeshherë nga kryetari i saj në mbledhjet e KLD-së.

- Komisioni, nga aktet e administruara konstatoi se procesi i gjykimin ka zgjatur për 1 vit e 9 muaj. Në këtë proces, subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues, relatore kishte qenë një tjetër subjekt rivlerësimi.

- Nga verifikimi i akteve të dosjes dhe, konkretisht i urdhrin të relatores për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, konstatohej se nga data e shortimit të dosjes 24.7.2016, e deri në gjykim të çështjes në dhomë këshillimi në datën 23.6.2017, kishte një distancë kohore prej një vit e dy muajsh.

- Në këto rrethana Komisioni i kërkoi shpjegim subjektit në cilësinë e kryetarit të kësaj gjykate, për arsyet e zgjatjes së procesit përtej kufijve ligjorë.

- Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës, ndër të tjera shpjegoi se kohëzgjatja e gjykimin të kësaj çështjeje ishte shkaktuar për arsye objektive, si rrjedhojë e volumit të çështjeve që ka pasur Gjykata Administrative e Apelit, volum i cili vazhdon edhe aktualisht ku presin për t’u gjykuar më shumë se 12500 çështje. Subjekti ka depozituar akte⁶⁶ në cilësinë e provave për ngarkesën e lartë të çështjeve që relatorja ka pasur.

⁶² Në gjykimin civil është shqyrtuar zotësia për të kryer vetë veprime juridiko-civile, ndërsa në gjykimin penal është shqyrtuar përgjegjësia penale.

⁶³ Referojuni provave të dërguara nga subjekti të datës 16.4.2019;

⁶⁴ Denoncimi nr. (***) prot., datë 5.3.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 14.11.2018.

⁶⁶ Referojuni shkresës nr. (***) , datë 26.1.2017.

Në përfundim, lidhur me tejkalimin e afatit të gjykimit për rastin, trupi gjykues në vlerësim të rrethanave, të ngarkesës së lartë të çështjeve që kjo gjykatë ka, fakt i njohur publik, të provave të subjektit, të cilësisë së subjektit si kryetar i kësaj gjykate, çmon se ato janë tërësisht të lidhura me arsyet objektive që nuk mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

1.2.d Shoqëria Kantieri i Ndërtimit të Anijeve ka shprehur denoncimin⁶⁷ me objekt “proces jo i rregullt ligjor, vendim i padrejtë dhe për aftësi profesionale”, duke pretenduar për qëndrime të njëanshme, të cilat nuk janë në përputhje me faktet e konstatuara gjatë gjykimit dhe as me qëndrimet e të njëjtëve gjyqtarë, të mbajtura në vendimet e tjera të mëparshme, për rrethana të njëjta. Denoncuesi ka bashkëlidhur 7 vendime, por vetëm tri prej tyre identifikojnë subjektin e rivlerësimit specifikisht: vendimi nr. (***) datë 2.3.2016; vendimi nr. (***) datë 26.10.2016 dhe vendimi nr. (***) datë 24.5.2017.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, lidhur me vlerësimin për çështjet e ngritura në denoncim ka dhënë vlerësimin e saj vetëm për aspektet formale, ndërkohë që shprehet se pretendimet e denoncuesit janë çështje që i takojnë gjykimit në një shkallë më të lartë, duke qenë se edhe denoncuesi ka ushtruar rekurs kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Komisionit, nga verifikimi i rasteve, i rezultoi se: në vendimin nr. (***) datë 2.3.2016, kualifikimi i marrëdhënies kontraktore midis palëve ndërgjyqëse i referohet neneve 149 – 152 të Kodit të Punës, ndërsa në vendimin nr. (***) datë 26.10.2016, për të njëjtat rrethana, kualifikimi i marrëdhënies kontraktore midis palëve ndërgjyqëse i referohet nenit 141 dhe në vijim neneve 143/1, 144, 145, 155/1/3 të Kodit të Punës.

- Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me qëndrimin e mbajtur prej tij, pasi: (i) dukej se për të njëjtat rrethana në këto vendime kishte qëndrime të ndryshme, sa i takonte analizës juridike, referuar në normat ligjore dhe jurisprudencën rregullatore; (ii) dukej se ishte gjykuar në tejkalim të afatit 30-ditor të parashikuar nga ligji nr. 49/2012 (i ndryshuar), pasi konstatoi se ky rast ishte regjistruar përpara rastit K. K., ndërsa gjykimi kishte përfunduar pas tij.

- Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij ndër të tjera parashtroi se janë tri raste të gjykuara prej tij me këtë palë ndërgjyqëse; specifikoi se ndryshimi midis vendimit nr. (***) datë 2.3.2016, me vendimin nr(***), datë 26.10.2016, dhe me vendimin nr. (***) datë 24.5.2017 qëndron në kërkimet e padisë së paditësit K. K. në raport me kërkimet e paraqitura në paditë e ngritura nga N. N. dhe M. K. . Pikërisht për këtë shkak, vlerësimi i kërkimeve të paditësit K. K. ishte bazuar në shkak ligjor të ndryshëm nga kërkimet e parashtruara nga N. N. dhe M. K. . Për shkak se kërkimet e padisë së paditësit K. K. kishin qenë të ndryshme nga kërkimet e padive përkatëse të paditësve N. N. dhe M. K. vlerësimi ka qenë i ndryshëm (*në të kundërt, nëse do të kishim dy qëndrime të ndryshme në çështjet N. N. dhe M. K., atëherë do të kishte dy qëndrime të ndryshme për kërtime të njëjta*). Lidhur me pikën (ii) subjekti ka parashtruar të gjitha veprimet e ndërmarra për çështjen në fjalë, si dhe ka paraqitur si prova: vendimin nr. (***) datë 15.1.2016, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; urdhrin nr. (***) prot., datë 18.4.2016, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për arsyet e rishortimit të çështjes në fjalë; ka shpjeguar se të gjitha veprimet e ndërmarra janë të dokumentuara në dosjen gjyqësore nëpërmjet raportit të regjistrit të veprimeve (RIV) të printuar nga Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, ICMIS.

⁶⁷ Referojuni denoncimit nr. (***) prot., datë 15.1.2018.

Për sa më sipër, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse, nuk rezultuan elemente që të kishin cenuar anën procedurale të procesit, rezultoi se subjekti e mbështet vendimin e dhënë sipas bindjes dhe logjikës⁶⁸ së tij, në konsideratë të objektit të kërkimit të palëve, ndërsa ligjshmëria e vendimmarrjes lidhur me themelin e çështjes vendoset nga shkallët më të larta gjyqësore, për sa kohë që denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit.

1.2.dh Lidhur me denoncimin nr. (***) prot., datë 15.2.2019, të një grupi gjyqtarësh të Gjykatës Administrative të Apelit, ku ndër të tjera pretendohet se në çështjen gjyqësore nr. (***)-2016, e cila i përket palëve ndërgjyqëse me paditës shtetasin B. V., me të paditur: Presidentin e Republikës, ku ndër të tjera është pretenduar: “...subjekti kishte bërë vendimin, duke e ndërlikuar juridikisht situatën e krijuar”.

Faktet dhe rrethanat lidhur me këtë çështje rezultojnë

Paditësi B. V. ka qenë oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Bazuar në njoftimin e datës 25.2.2015 të Prokurorit të Përgjithshëm, për konkurrimin e kandidatëve për 9 vende vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, shtetasi B. V. ka depozituar dokumentacionin e tij në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila, pas shqyrtimit dhe pas testimin me shkrim e me gojë, e propozon (*të përfshirë në një listë me 9 kandidatë*) te Presidenti i Republikës, për ta dekretuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Presidenti i Republikës, në datën 2.11.2015, ka vijuar me dekretimin e tetë kandidatëve të tjerë, duke mos u shprehur për kandidaturën e shtetasit B. V. .

Në datën 22.12.2015, shtetasi B. V. ka depozituar padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: konstatim i paligjshmërisë së veprimit administrativ të Presidentit të Republikës, për rrëzimin në heshtje të kandidaturës së paditësit, i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm për t’u emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Në datën 14.4.2016, paditësi B. V. e ka ndryshuar objektin e padisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar në rrugë gjyqësore: *të detyrohej Presidenti i Republikës që të marrë në shqyrtim propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm... për emërimin prokuror të tij; si dhe të detyrohej Presidenti i Republikës për t’u shprehur në lidhje me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin prokuror.*

Për të mbështetur këto kërkime, paditësi ka referuar si bazë ligjore:

- pikën 3⁶⁹, të nenit 149, të Kushtetutës së Republikës;
- nenet 20 dhe 21, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”⁷⁰ (i ndryshuar);

⁶⁸ Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit rezulton se vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

⁶⁹ Pika 3, neni 149, Kushtetuta e Republikës (pa ndryshimet e pësuar në vitin 2016): “Prokurorët e tjerë, emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm”

⁷⁰ Ligji nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar):

Neni 20 (ndryshuar me ligjin nr. 9102, datë 10.7.2003) Konkurrimi: “1. Prokurori i Përgjithshëm shpall publikisht vendet vakant për prokurorë, së paku një muaj para datë së caktuar për zhvillimin e konkurrit. Shpallja bëhet të paktën në dy gazeta me shpërndarje kombëtare dhe me tirazh të mjaftueshëm, si dhe në Radio Televizionin Publik.

Depozitimi i kërkesave, të shoqëruara me dokumentet e kërkuara për pranimin në konkurrim, duhet të behët nga konkurrenuesit jo me vonë se dy javë nga data e shpalljes publike të vendit vakant.

- udhëzimin nr. 3, datë 11.2.2015, “Për procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokuror që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë ose oficerë të policisë gjyqësore”;
- vendimin nr. 25, datë 13.2.2002, të Gjykatës Kushtetuese.

Ka rezultuar se për bazën e këtij objekti gjykimi ka vijuar dhe është përfunduar gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. (***) datë 23.5.2016, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është ankimuar nga Presidenti i Republikës në Gjykatën Administrative të Apelit, ku subjekti ka pasur cilësinë e kryesuesit.

Rezulton se trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm, datë 24.1.2019, bazuar në nenin 199,⁷¹ të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur që të bëhet kalimi procedural nga pala Presidenti i Republikës, te Presidenti i Republikës dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe të vijohet me gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

Komisioni ka konstatuar se nuk jemi përpara zëvendësimit procedural, por përpara zbatimit të nenit 161⁷² të po këtij kodi, për shkak të shtimit të palës ndërgjyqëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë, krahas palës që ishte dhe ka vijuar të jetë në proces, Presidentit të Republikës.

Ndërsa janë shtuar palët ndërgjyqëse, gjykimi ka vijuar me të njëjtën bazë ligjore të përdorur prej nisjes së procesit gjyqësor, me të cilën vepronte Presidenti i Republikës.

2. Për plotësimin e vendeve vakante merret në shqyrtim, diskutohet dhe vendoset për kandidaturat e paraqitura nga prokurorët. Në mungesë ose pas shqyrtimit të këtyre kandidaturave, shqyrtohen, diskutohen dhe vendoset për kandidatët e tjerë që përmbushin kriteret ligjore për t'u emëruar prokurorë.

3. Këshilli i Prokurorisë bën vlerësimin e kandidaturave dhe mendimin e tij ia paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të shprehet brenda 15 ditësh.

4. Rregullat e detajuara të paraqitjes, të përzgjedhjes, të verifikimit dhe të testimit të kandidaturave caktohen nga Prokurori i Përgjithshëm”.

Neni 21 (ndryshuar me ligjin nr. 10051, datë 29.12.2008) Emërimi: “1. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e këshillit të prokurorisë.

2. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë", për aftësi profesionale, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Ndërmjet prokurorëve, që kandidojnë për në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda dhe që plotësojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni, këshilli i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhin, sipas pikëve, kandidatit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit 43 të këtij ligji.

4. Presidenti, brenda 30 ditëve, dekreton emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar”.

⁷¹ Neni 199 i Kodit të Procedurës Civile aplikohet vetëm në dy situata:

1. kur njëra nga palët vdes – dhe në këtë rast thirren në gjykim trashëgimtarët;

2. kur personi juridik mbaron – dhe në këtë rast thirret në gjykim personi juridik a fizik që mbart të drejtat dhe detyrimet e atij që ka mbaruar.

⁷² Neni 161 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve të vitit 2017), parashikon:

“Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës) në rast se:

- a) kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta për objektin e padisë;
- b) të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e faktit ose e ligjit kanë po atë bazë.
- c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur.
- ç) nëse vendimi nuk mund të jepet përveçse kundrejt shumë personave, në rastin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme, këta të fundit duhet të thirren si të paditur në të njëjtin proces. Gjyqtari, kur konstaton se bashkëndërgjyqësia e detyrueshme në anën e të paditurve është e paplotë, i lë palës paditëse një afat deri në 20 ditë që ta rregullojë atë, sipas shkronjës “c”, të këtij neni, dhe nenit 154/a të këtij Kodi. Në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të mësipërm, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

Baza ligjore e përdorur nga paditësi nuk pasqyron asnjë ndryshim që ka pësuar Kushtetuta dhe legjislacioni i posaçëm që rregullon kriteret dhe procedurën e emërimit⁷³ të prokurorëve, gjatë vitit 2016, me të cilën vepron Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. (***) , datë 6.2.2019, gjykata ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me saktësimin që: të detyrojë Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të emëruar paditësin si prokuror.*

Nga Komisioni u konstatuan mospërputhje mes kërimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës, pasi paditësi nuk ka kërkuar që t'i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë që të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori.

Gjykimi në apel nuk ka pësuar asnjë ndryshim në objektin dhe bazën ligjore të padisë.

Komisioni, nga analiza e fakteve, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë shpjegimet e tij pasi⁷⁴: (i) dukej se detyrimi i lënë KLP-së, që të emëronte paditësin prokuror nuk përputhej me objektin e kërkesëpadisë dhe me detyrimet që ka ky institucion në bazë të ligjit; (ii) dukej se gjykata ka marrë rol aktiv lidhur me saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë, duke detyruar KLP-në⁷⁵ të bëjë emërimin e paditësit si prokuror, si dhe në tejkalimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces; (iii) dukej se dispozita ligjore, neni 199 i Kodi i Procedurës Civile, referuar në arsyetimin e vendimit nuk përputhej me ndërgjyqësinë e krijuar, shtim të palëve sipas nenit 161 të po këtij kodi.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij të dërguara në datën 16.4.2019, por edhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera ka parashtruar⁷⁶ se gjykata, gjatë zhvillimit të gjykimit, i kishte dhënë mundësinë përfaqësueses së kësaj pale për të bërë evident qëndrimin e institucionit të KLP-së. Ky institucion, me vendimin nr. (***) , datë 25.3.2019,⁷⁷ ka zbatuar vendimin gjyqësor, duke mos ushtruar rekurs nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse. Saktësimi i pikës 3, të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë/kalimi procedural, kishte qenë i diktuar nga ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që ndodhën, pas zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë dhe para përfundimit të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, e që sollën si pasojë kalimin e kompetencës së emërimit të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, nga Presidenti i Republikës të Këshilli i Lartë i Prokurorisë (germa “c”, e nenit 159/2, e ligjit nr. 115/2016). Sipas subjektit, nëse Gjykata nuk do të saktësonte organin që duhet të ekzekutonte vendimin, në kushtet e reja ligjore të krijuara atëherë vendimi gjyqësor do të mbetej i pazbatueshëm. Ky vendim përbën precedent bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 8737/2001 i ndryshuar, si dhe saktësimi i pikës 3 të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ishte i detyrueshëm, në bazë të parimit të vazhdimësisë së institucioneve, nëpërmjet përcaktimeve të dispozitave kushtetuese që kaluan kompetencën për emërimin e prokurorëve nga Presidenti të KLP-ja, përcaktimeve të nenit 199/2 të Kodi i Procedurës Civile, në lidhje me

⁷³ Neni 148/ç, Kushtetutës, shtuar me ligjin nr. 76/2016, neni 36, sipas të cilit:

“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj”.

Germa “a”, e pikës 1, e nenit 149/a të Kushtetutës, ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, neni 40, sipas të cilit:

“1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve;”

⁷⁴ Referojuni rezultatet e hetimit administrative.

⁷⁵ Neni 148/ç, Kushtetutës, shtuar me ligjin nr. 76/2016, neni 36 i tij.

⁷⁶ Referojuni shpjegimeve të plota të subjektit, datë 16.4.2019.

⁷⁷ Procesverbali nr. (***) , datë 25.3.2019, i seancës plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, publike.

përcaktimet e neneve 159/c të ligjit nr. 115/2016, si dhe dispozitave të ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar, si dhe vendimi nuk i ishte referuar ligjit nr. 96/2016 për zgjidhjen e çështjes në themel.

Trupi gjykues, në vlerësim të veprimeve procedurale të ndërmarra nga paditësi, krahasuar me legjislacionin e zbatueshëm, arsyeton:

- Juriprudenca ligjore e përdorur nga subjekti në arsyetimin e vendimit qartësojnë se Presidenti nxjerr akte administrative me karakter individual, në të cilën përfshihen edhe *dekretet* për emërimin apo shkarkimin e prokurorëve nga detyra dhe, për pasojë, ato duhet të jenë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor. Në asnjë rast nuk pasqyrohet se heshtja është e njëjtë me emërimin apo me shkarkimin që të trajtohet si një akt me karakter administrativ kur një i tillë nuk ka dalë dhe për pasojë kur diçka që nuk ekziston nuk mund të jetë objekt ankimi. Po sipas jurisprudencës së përdorur nga subjekti, vendimi nr. 25, datë 13.2.2002, i Gjykatës Kushtetuese, dekreti duhet të jetë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor, si dhe e drejta e prokurorëve për t'u ankuar buron nga Kushtetuta, ndërkohë që rezulton se paditësi ishte me statusin e oficerit të policisë gjyqësore. Nisur nga ky fakt, si dhe nga prezumimit të heshtjes së Presidentit, si një vendimmarrje pranuese, trupi gjykues vlerëson se në dukje kemi të bëjmë me një padi pa objekt, pra, pa një akt administrativ për t'u kundërshtuar.

- Trupi gjykues çmon se ka mospërputhje mes objektit të kërimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës.

- Për pretendimin e subjektit në seancën dëgjimore për ndryshimin e ndërgjyqësisë se e ka iniciuar paditësi, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim do të çonte në zbatimin e nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile, pra, shtim të palëve ndërgjyqëse, dhe jo sipas nenit 199/2 të po këtij kodi, zëvendësimin e tyre.

Subjekti pretendoi se paditësi e ka kërkuar ndryshimin e ndërgjyqësisë, por në fakt nuk rezulton një kërkim i tillë prej tij; nuk rezulton që ai të këtë kërkuar që t'i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që e detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë që të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori. Pretendimi i subjektit se ka vepruar me nenin 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues çmon se kjo dispozitë imponon zëvendësimin e palës që nuk gëzon attribute lidhur me objektin e kërimit të padisë. Në këtë drejtim trupi gjykues konstaton se në rastet e padive të marrëdhënieve të punës sipas deklarimeve të subjektit në seancë, se gjykata i përmbahet kërimit të palëve dhe nuk i tejkalon ato, kërkimet kanë qenë me objekte të ndryshme dhe, për pasojë, është vendosur në mënyra të ndryshme, ndërsa rezulton se në këtë rast nuk ka mbajtur të njëjtin qëndrim, sikurse përcaktohet në nenin 6⁷⁸ të Kodit të Procedurës Civile, por ka vepruar me iniciativën e saj pa u kërkuar ndryshimi i objektit nga paditësi.

Trupi gjykues në tërësi të çështjes çmon se gjykata/subjekti, në vendimin e saj në momentin e zëvendësimit të palës ndërgjyqëse nuk ka arsyetuar rolin e kompetencat e palës ndërgjyqëse/Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe arsyet e vendimmarrjes duhet të bazoheshin në ligjin e ri për statusin nr. 96/2016, i cili kërkonte detyrimisht që paditësi të gëzonte statusin e magjistratit, ndërkohë konstaton se një nga dispozitat ligjore që referon subjekti në prapësime, specifikisht germa "c", e nenit 159/2, e ligjit nr. 115/2016, në momentin e gjykimit, datë 6.2.2019, ishte shfuqizuar me vendimin nr. 41⁷⁹, datë 16.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim, lidhur me këtë dosje gjyqësore, trupi gjykues për sa më sipër arsyetuar, çmon se ekzistojnë mangësi profesionale, të cilat janë të lidhura me:

⁷⁸ Gjykata duhet të shprehet vetëm për atë që kërkohet dhe për gjithçka që kërkohet.

⁷⁹ Fletorja zyrtare nr. 121, viti 2017, 24 maj.

- i. ekzistencën e mospërputhjeve mes kërkimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës, pasi paditësi nuk ka kërkuar që t'i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që e detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori;
- ii. rolin aktiv të gjykatës/subjektit lidhur me saktësimin e pikën 3 të dispozitivit të gjykatës së shkallës së parë, duke e detyruar KLP⁸⁰-në të bëjë emërimin e paditësit si prokuror;
- iii. tejkalimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces;
- iv. mosarsyetimin e rolit dhe të kompetencave të palës ndërgjyqëse/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në momentin e zëvendësimit të saj, sipas ligjit nr. 96/2016.

Çështje të tjera të hetimit - mbi ekzistencën e konfliktit të interesit

2. Komisioni hetoi edhe për rrethanat që, sipas ligjit, konsiderohen si konflikt interesi, duke kryer verifikime të dhënave nga sistemi elektronik i Gjykatës Administrative të Apelit, për çdo proces që ka pasur kjo gjykatë, në të cilin të ketë qenë pjesëmarrës secili person fizik apo juridik që rezultoi palë kontraktuese me subjektin e rivlerësimit apo me bashkëshorten e tij apo me familjarë të tjerë të subjektit, me babanë e këtij të fundit, me bashkëshorten e tij apo raste të tjera.

2.1 Nga verifikimet e kryera sipas pikës 2, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatorit kishte gjykuar çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse; shoqërinë “K.” sh.p.k., vendimi nr. (***) datë 15.3.2017.

2.2 Rezultoi se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë shtetasi Sh. K., administrator i shoqërisë “K.”, sh.p.k., ishte palë blerëse e apartamentit në pronësi të bashkëshortes, sipas kontratës noteriale nr. (***) datë 21.10.2015, në shumën 110.000 euro, të shlyera në llogarinë bankare të noteres.

2.3 Lidhur me këtë çështje, Komisioni kërkoi trajtim të rrethanave sipas ligjit të konfliktit të interesit nga Institucionit i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Interesave, i cili pas trajtimit të rastit ka konkluduar se në lidhje me gjykimin dhe vendimmarrjen është vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

2.4 Po nga faqja zyrtare e Gjykatës Administrative të Apelit, u konstatuan çështje të gjykuara nga subjekti si relator apo anëtar, më palë ndërgjyqëse institucionin ku bashkëshortja e tij sipas deklaratimit në deklaratat periodike të pasurisë dhe vërtetimit të të ardhurave të saj, kishte dhe ka funksion, në strukturat tatimore⁸¹;

2.5 Lidhur me këto konstatime Komisioni kërkoi dhe verifikoi 6 dosje gjyqësore⁸², ku pas studimit konstatoi se në tre çështje subjekti kishte kërkuar dorëheqjen, dhe disponoheshin 2 vendime të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, për pranimin e dorëheqjes me arsyetimin se, akti objekt gjykimi ishte nxjerrë nga institucioni, ku bashkëshortja e subjektit ushtronte detyrën në

⁸⁰ Neni 148/ç i Kushtetutës, shtuar me ligjin nr. 76/2016, neni 36 i tij.

⁸¹ Për periudhën viti 2010 – tetor 2013, kishte mbajtur funksionin e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; në tetor 2013, kishte mbajtur funksionin e drejtorit rajonal në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj; në vitin 2014 kishte mbajtur funksionin e drejtorit në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj; në vitin 2015 kishte mbajtur funksionin e drejtorit rajonal në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj; në vitin 2016, kishte mbajtur funksionin e drejtorit në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj; për periudhën viti 2017 - shkurt 2019, rezultoi se në funksionin e drejtorit në Drejtorinë e Apelit Tatimor dhe si anëtar në Komisionin e Shqyrtimit të Apelit Tatimor.

⁸² Referojuni rezultatet e hetimit për detaje të çështjeve.

këto Drejtori përkatëse, dhe 1 rast⁸³ ku ishte refuzuar dorëheqja me arsyetimin se nuk provohej që bashkëshortja e subjektit të kishte nënshkruar aktin administrativ objekt gjykimi;

2.6 Ndërkohë Komisioni konstatoi se në tre rastet e tjera, proceset me palë ndërgjyqëse Federata Shqiptare e Judos, Shoqëria “L.V.” sh.p.k., dhe Shoqëria “A. U.” me objekt gjykimi, kundërshtimin e akteve administrative të nxjerra nga organet tatimore nuk rezultonin veprime të subjektit për të kërkuar dorëheqjen;

2.7 Në vijim të hetimit për rrethana të mundshme të konfliktit të interesit Komisioni, nga të dhënat e publikuara në faqe zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit, verifikoi të gjitha çështjet e gjykuara, me institucionin ku bashkëshortja e subjektit kishte mbajtur dhe mban funksion, duke i kategorizuar sipas funksionit të saj dhe pozicionit⁸⁴ të subjektit në këto çështje (*reflektuar në detaje sipas aneksit nr. 1 në rezultatet e hetimit*).

2.7.1 Çështje me palë Komisionin për shqyrtimin e apeliemeve tatimore (ku bashkëshortja, në cilësinë e drejtoreshës së apeliimit tatimor nga viti 2017 e aktualisht është anëtare *de jure*), ku, sipas të dhënave të faqes *online* të gjykatës, subjekti shfaqej si relator i çështjes; ose ku përbërja e trupit gjykues nuk reflektohej dhe nuk ishte e qartë nëse kishte marrë pjesë në gjykimin me nr. rendor 1-11, të aneksit nr. 1.

2.7.2 Çështje me palë Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë ku subjekti shfaqej në cilësinë e relatorit, me fokus: a) akte të drejtorisë rajonale në kohën që bashkëshortja kishte qenë Drejtoreshë Rajonale (vitet 2013 dhe 2015); b) vendime të gjykatës në kohën kur kjo drejtori drejtohej nga bashkëshortja e subjektit; nr. rendor 11-16 të aneksit nr. 1.

2.7.3 Çështje me palë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për akte që ishin nxjerrë në kohën kur bashkëshortja ka pasur funksionin e zëvendës drejtores së Përgjithshme të kësaj drejtorie (2010 – tetor 2013); nr. rendor 17-30 të aneksit nr. 1.

2.8 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për çështjet gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K.” sh.p.k., Federatën Shqiptare të Judos, shoqërinë “L. V.” sh.p.k., shoqërinë “A. U.” sh.p.k., dhe të gjithë çështjet e kategorizuara sipas pikës 2.7 të detajuara në aneksin nr. 1, të rezultateve të hetimit, pasi dukej se mund të kishte vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (ndryshuar), si dhe të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

2.9 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe të provave të depozituara në datën 16.4.2019, ndër të tjera ka argumentuar⁸⁵ se:

2.9.1 Për procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K.” sh.p.k., ku administratori i saj rezultonte palë blerëse e apartamentit në pronësi të personit të lidhur, në kontratën noteriale nr. (***) datë 21.10.2015, si një çështje e regjistruar në vitin 2016, e përfunduar me vendimin nr. (***) datë 15.3.2017, subjekti ka parashtruar⁸⁶ një analizë të fakteve dhe rrethanave në raport me dispozitat ligjore të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, “Për rastet për përjashtim të gjyqtarit”, duke arsyetuar se nga çështja në gjykim as subjekti dhe as ndonjë prej personave të lidhur me të nuk mund të kishin dhe as nuk kanë pasur realisht asnjë lloj interesi nga vendimmarrja në rastin konkret. Sipas nenit 72 (*i cili edhe pas ndryshimeve në kuadër të reformës në drejtësi është i pandryshuar në lidhje me nenin 72 të tij*), pika 3 e tij, ka parashikuar vetëm ekzistencën e marrëdhënieve të huas dhe të kredisë (*të cilat duhet të ekzistojnë në kohën*

⁸³ Rasti i çështjes me palë ndërgjyqëse shoqëria “T. B.” sh.a., vendimi i kryetarit të Gjykatës së Lartë nr. (***) prot., datë 21.11.2016.

⁸⁴ Referenca i është përmbajtur të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit.

⁸⁵ Referojuni shpjegimet e subjektit të dërguar me *e-mail*-in e datës 16.4.2019.

⁸⁶ Referojuni shpjegimeve të subjektit.

e gjykimit të çështjes) si shkak për mospjesëmarrje në gjykim. Ka parashtruar një analizë të fakteve për veprimin juridik kontratën nr. (***) , datë 21.10.2015, në të cilën janë përmbushur të gjitha detyrimet mes palëve në momentin e lidhjes së kontratës. Kjo pasuri ishte rivlerësuar në vitin 2011 bazuar në një akteksertimi në një vlerë më të lartë se çmimi i referencës së zonës dhe po ashtu sikurse kishte rezultuar nga provat e hetimit administrativ dhe shkresa e ILDKPKI-së, blerësi e ka rishitur atë pas tre muajsh në shumën 120.000 euro. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës kontrata të ngjashme me çmime thuajse të përafërta, kontratën nr(***) , datë 3.2.2016, kontratën nr. (***) , datë 7.10.2016, njoftimin për shitje në gazetën “Ç.”, datë 3.6.2015, sipas të cilit apartamenti ishte njoftuar për shitje në shumën 111.300 euro, me çmim 1050 euro/m².

Në lidhje me themelin e çështjes subjekti ka parashtruar se Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. (***) , datë 15.3.2017, ka pranuar pjesërisht këtë padi, nëpërmjet një vendimi që rezulton praktikë e konsoliduar gjyqësore, duke depozituar 7⁸⁷ vendimet e nxjerra nga Gjykata e Lartë, si dhe nga Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt-padi të njëjtë si në rastin e çështjes me palë shoqërinë “K.” sh.p.k. Lidhur me qëndrimin e ILDKPKI-së subjekti ka shpjeguar se ky institucion nuk ka kompetencë për të gjykuar në lidhje me heqjen dorë nga gjykimi, si dhe mosmarrja në analizë të plotë e të gjitha provave dhe e fakteve nga ana e tij, të disponuara përmes dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, kanë pasur si rezultat kalimin e plotë të kompetencave, si dhe konkluzione tërësisht të kundërligjshme.

2.9.2 Për të tria çështjet me palë ndërgjyqëse Federatën Shqiptare e Judos, shoqërinë “L. V.” sh.p.k., shoqërinë “A. U.” sh.p.k., ka shpjeguar se nuk kishte ndërmarë veprime për heqje dorë nga gjykimi pasi nuk kishte qenë në asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi referuar palëve të paditura të strukturave tatimore, në kohën e gjykimeve bashkëshortja e tij nuk ka ushtruar asnjë detyrë pranë këtyre institucioneve, pasi kishte qenë në funksione të tjera, si dhe lidhur me aktet objekt gjykimi, nuk ka rezultuar që bashkëshortja e tij të kishte kryer ndonjë veprim apo të kishte nënshkruar ndonjë akt që të jetë shqyrtuar në gjykim. Për çdo rast ka referuar si precedent vendimin e refuzimit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë në çështjen gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “T. B.” sh.a. Tiranë me argumentin se *nuk provohet që bashkëshortja e tij të kishte nënshkruar aktin administrativ objekt gjykimi.*

2.9.3 Për 10 çështjet sipas kategorizimit sa më sipër arsyetuar pika 2.7.1 e pasqyruar në aneksin nr. 1 (nr. rendor 1-10), ndër të tjera subjekti ka depozituar dokumentacion; urdhrat e brendshëm për shortimin e çështjeve, ku sipas tyre në 8 raste nuk ka qenë anëtar i trupit gjykues, kurse për çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse “P. T. S. Albania”, dhe me palë të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si një çështe e regjistruar në nëntor të vitit 2018, ka qenë çështje paveprimi, pasi po shqyrtoheshin dosjet e korrikut të vitit 2018; për rastin me palë ndërgjyqëse “Raiffeisen Bank”, subjekti ka shpjeguar se është anëtar i trupit gjykues, sipas urdhrit nr. (***) të datës 29.5.2018 për ndarjen e trupit gjyqësor, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje dhe vendimin e miratimit të saj nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, duke bashkëlidhur edhe dokumentacion përkatës.

⁸⁷ Vendimin nr. (***) i vendimit ((***)), datë 10.4.2014, të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. (***) i vendimit ((***)), datë 5.2.2015, të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. (***) , datë 27.9.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit; vendimin nr. (***) , datë 31.5.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit; vendimin nr. (***) , datë 6.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; vendimin nr. (***) , datë 20.4.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; vendimin nr. (***) , datë 20.4.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit.

2.9.4 Për 6 çështjet sipas kategorizimit sa më sipër arsyetuar, pika 2.7.2, e pasqyruar në aneksin nr. 1 (nr. rendor 11-17), ndër të tjera subjekti ka shpjeguar se nuk kishte ndërmarrë veprime për heqje dorë nga gjykimi pasi nuk kishte qenë në asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi referuar palëve të paditura të strukturave tatimore, në kohën e gjykimeve bashkëshortja e tij nuk kishte ushtruar asnjë detyrë në këto institucione, pasi kishte qenë në funksione të tjera⁸⁸, si dhe lidhur me aktet objekt gjykimi nuk rezulton që bashkëshortja e tij të kishte kryer ndonjë veprim apo të kishte nënshkruar ndonjë akt që të jetë shqyrtuar në gjykim. Subjekti ka referuar si precedent vendimin e refuzimit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë në çështjen gjyqësore me palë paditëse shoqërinë “T. B.” sh.a. Tiranë me argumentin se *nuk provohet që bashkëshortja e tij të kishte nënshkruar aktin administrativ objekt gjykimi.*

2.9.5 Për çështjet sipas kategorizimit në aneksin nr. 1, me nr. rendor (17-30), sa më sipër arsyetuar, pika 2.7.3, ndër të tjera subjekti ka shpjeguar se nuk kishte ndërmarrë veprime për heqje dorë nga gjykimi, pasi nuk kishte qenë në asnjë prej rasteve të përcaktuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, pasi referuar palëve të paditura të strukturave tatimore, në kohën e gjykimeve, bashkëshortja e tij nuk kishte ushtruar asnjë detyrë pranë këtyre institucioneve. Për shkak të rregullimeve ligjore të funksionit të institucioneve tatimore, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (*i ndryshuar*) neni 18 i tij, “Drejtoria e apelimit tatimor është në përbërje të administratës tatimore qendrore dhe është e pavarur në vendimmarrje. Drejtori i drejtorisë së apelimit tatimor emërohet nga ministri i Financave.” Meqenëse Drejtoria e Apelimit Tatimor⁸⁹ ndodhej në atë kohë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kjo kishte qenë arsyeja që si palë e paditur është vendosur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2.10 Komisioni, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, rihapi hetimin administrativ, pasi konstatoi se pretendimet e subjektit lidheshin me mosmbajtjen e funksioneve në strukturat tatimore si palë të paditura në momentin e gjyqimit, sikurse ishin rastet me palë ndërgjyqëse Federatën Shqiptare të Judos, shoqërinë “L. V.” sh.p.k., dhe shoqërinë “A. U.”, si dhe konstatoi se ato duhej të vlerësoheshin në raport me detyrat sipas pozicioneve të punës që bashkëshortja ka pasur dhe ka mbajtur aktualisht.

2.11 Për sa më sipër, Komisioni kërkoi dokumentacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe nga Drejtoria e Apelimit Tatimor⁹⁰ për pozicionet e punës së bashkëshortes së subjektit, në strukturat tatimore, përshkrimin e detyrave dhe strukturën e institucionit ku ka punuar.

2.12 Këto institucione informuan për përshkrimin e detyrave, strukturën përkatëse të institucionit sipas pozicioneve të punës së bashkëshortes së subjektit në strukturat tatimore sipas periudhave përkatëse:

3.4.2006 – 20.6.2006 – Inspektore Tatimore në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM);
20.6.2006 – 3.4.2007 – përgjegjëse e zyrës së kontrollit në DTM;
3.4.2007 – 16.4.2007 – kryetare në DTM-së;

⁸⁸ Për periudhën 10.10.2013 – 11.1.2013 ka mbajtur funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj. Për periudhën 19.3.2010 – 10.10.2013 ka mbajtur funksionin e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Tatimeve.

⁸⁹Referojuni shpjegimeve të subjektit datë 16.4.2019.

⁹⁰ Kërkesa nr. (***) prot., datë 3.5.2019, të UK Kavajë, të ardhurat A. Gj.; UK Kavajë, komunikim me e-mail, datë 13.5.2019 (KPK (***) , të ardhurat A. Gj.; kërkesë nr. (***) prot., datë 3.5.2019, DPT për marrëdhëniet e punës së M. K. .

DPT – Kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 9.5.2019 (KPK (***)); kërkesa nr. (***) prot., datë 3.5.2019, DAT, për marrëdhëniet e punës se M. K. .

DAT – kthim përgjigjeje nr. 1849-1 prot., datë 7.5.2019 (KPK (***)).

16.4.2007 – 18.9.2007 – përgjegjëse e zyrës së kontrollit në DTM;
18.9.2007 – 24.1.2008 – kryetare e DTM-së;
24.1.2008 – 18.2.2008 – inspektore e zyrës së analizës së riskut në DTM;
18.2.2008 – 13.7.2009 – drejtore në Drejtorinë e Apelimit në DPT;
13.7.2009 – 19.3.2010 – drejtore e kontrollit tatimor në DTM;
19.3.2010 – 10.10.2013 – zëvendësdrejtore e Përgjithshëm të Procedurave të IT-së në DPT;
10.10.2013 – 16.1.2014 – drejtore në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj (DRTTM);
16.1.2014 – 4.1.2017 – drejtore e DRTTM-së;
4.1.2017 – lirohet nga detyra me kërkesën e saj.
Nga data 24.1.2017 e në vijim ushtronte detyrën e drejtores në DAT pranë Ministrisë së Financave, shoqëruar me aktet e emërimit, të fillimit të marrëdhënies financiare (datë 27.4.2017), detyrat dhe struktura organike e institucionit.

2.13 Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar, nisur nga palët objekt gjykimi dhe nga aktet në dosje ku kundërshtoheshin akte të Drejtorisë së Apelimit Tatimor dhe drejtoritë rajonale, Komisioni konstatoi se në datat e gjykimit të tri⁹¹ çështjeve, ato ishin gjykuar përpara se bashkëshortja të fillonte punë në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, që sipas aktit të emërimit datonte më 27.4.2017.

2.14 Sipas dokumentacionit të detyrave që ka mbajtur bashkëshortja e subjektit, rezultoi se në kohën e gjykimit të tria rasteve ajo nuk kishte ushtruar detyrë në këto institucione pasi, sipas vendimit nr. 1, datë 4.1.2017, të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nënshkruar nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm, bashkëshortja e subjektit ishte liruar nga detyra e mëparshme në pozicion me kërkesën e saj.

2.15 Nisur nga organigrama e institucioneve tatimore, u vërejt se bashkëshortja në kohën e gjykimeve të tri çështjeve nuk mbante ndonjë pozicion në strukturat tatimore.

2.16 Në hetimin e thelluar për verifikimin e ekzistencës ose jo të rrethanave që mund të konsiderohen konflikt interesi, për dyshimet se ajo mund të kishte ushtruar detyrën “de facto”, deri në një moment të pozicionimit të saj në detyrën e drejtores së apelimit tatimor (27 prill 2017), Komisioni kërkoi dhe mori dosjet e tria vendimeve të nxjerra nga sistemi elektronik i të dhënave të institucionit⁹².

2.17 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informoi Komisionin se vendimet e shkëputura nga sistemi elektronik i të dhënave janë paraqitur vetëm si modele të mënyrës së hartimit formal të tyre dhe nuk i përkisnin ndonjë subjekti të caktuar, si dhe depozitoi vendimet dhe praktikat përkatëse për subjektet tatimpaguese: G. sh.p.k. (nr. (***) prot., datë 12.6.2017), F. D. (nr. (***) prot., datë 17.7.2017) dhe M. K. (nr. (***) prot., datë 20.7.2017).

2.18 Nga analizimi i dosjeve, rezultoi se nga Drejtoria e Apelimit Tatimor për të tria rastet kishte vendime të nënshkruara nga bashkëshortja e subjektit, por ato rezultojnë pas datës së emërimit të saj. Nga aktet e tjera, pjesë e çdo dosjeje, rezultoi gjithashtu se bashkëshortja e subjektit kishte nënshkruar akte pjesë të procedurës së vlerësimit të tyre, por edhe ato datonin në kohën pas emërimit të saj në këtë detyrë.

Komisioni, duke analizuar:

✓ **rrethanat e gjykimit të çështjes (regjistruar në datën 9.5.2018)** me palë paditëse “Raiffeisen Bank”, për të cilën subjekti në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues kishte dhënë

⁹¹ Federata Shqiptare e Judos, Shoqëria “L. V.” sh.p.k. dhe shoqëria “A. U.”.

⁹² Kërkesë nr. (***) prot., datë 8.5.2019, të DAT-it, për vendime M. K. .

DAT – kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 9.5.2019 (KPK (***)), vendime të DAT-it.

dorëheqjen pas afro 8 muajve datë 13.2.2019, dhe për këtë çështje, rezultoi se në datën e aktit administrativ objekt gjykimi, si dhe në datën e regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, bashkëshortja e subjektit mbante pozicionin e drejtores së Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave, si dhe të anëtares së KSHAT-it pranë Ministrisë së Financave;

✓ **rrethanat e shortimit e çështjes me palë paditëse “P. T. S. Albania” sh.a.** dhe me të paditur DRTTM-në, KSHAT-in, pranë MF-së, për të cilën subjekti, në cilësinë e relatorit, u shpreh: “...për dosjen gjyqësore nuk është kryer asnjë veprim, aktualisht janë duke u gjykuar dosjet gjyqësore të regjistruara në Korrik 2016...” dhe bashkëshortja e tij mbante gjithashtu pozicionin e drejtores së Apelit Tatimor pranë Ministrisë së Financave, si dhe anëtare e KSHAT-it, pranë MF, kreu hetime të mëtejshme;

2.19 Në lidhje me komunikimin e dosjeve gjyqësore te gjyqtari relator dhe anëtar i trupit gjykues, pas shortimit të tyre, Komisioni kërkoi për deklarim kancelarin e Gjykatës Administrative të Apelit, i cili dha deklaratimet e tij për mënyrën e funksionimit të brendshëm të gjykatës, sa i takonte regjistrimit të çështjeve, shortimit të tyre dhe komunikimit të tyre tek gjyqtari relator, administrimi i dosjes nga relatori dhe ndihmësat ligjorë, komunikimi i dosjes dhe relacionit tek anëtarët e tjerë të trupës gjyqësore, si dhe për mënyrën e heqjes dorë nga gjykimi për rastet e parashikuara me ligj, apo me kërkesën e palëve⁹³. Sipas deklaratimit të kancelarit të GJAA-së, i pari që merrte dijeni për materialet e dosjes dhe për ekzistencën e shkaqeve të përjashtimit (sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile) ishte gjyqtari relator. Anëtarët e tjerë të trupit gjykues nuk kishin dijeni për këto elemente derisa iu komunikojë fizikisht dosja gjyqësore dhe relacioni i gjyqtarit relator. Nga momenti i shortimit dhe deri në momentin e komunikimit të dosjes gjyqësore dhe të relacionit për këtë dosje, mund të kalonte një kohë e konsiderueshme, me raste deri në tre vjet.

2.20 Në rastin me palë paditëse “Raiffeisen Bank”, nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit rezultoi se relator ishte një subjekt tjetër rivlerësimi, dhe sipas deklaratimit të kancelarit, dosja ishte trajtuar me procedurë të përshpejtuar për shkak të dy kërkesave të palës paditëse.

2.21 Sipas deklaratimit të kancelarit u konstatua se subjekti, në cilësinë e relatorit të çështjes me palë paditëse “P. T. S. Albania”, kishte dijeni për palët ndërgjyqëse.

2.22 Komisioni verifikoi edhe tri vendime të tjera ku subjekti rezultonte relator ose anëtar trupi, me qëllim analizimin e rrethanave që mund të konsiderohen konflikt interesi, në raport me detyrën që ka ushtruar bashkëshortja në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ objekt gjykimi dhe në momentin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit⁹⁴ dhe, specifikisht:

- **vendim nr(***)**, datë **23.12.2014**, që i përkiste çështjes me palë paditëse: “D. & S. T.” sh.p.k.; palë të paditura: DRT-ja Tiranë dhe DPT-ja; objekt gjykimi: akti administrativ nr. (***) datë 25.9.2012, i DRT-së Tiranë dhe akti administrativ nr. (***) datë 14.1.2013 i Drejtorisë së Apelit në DPT;

- **vendim nr. (***)**, datë **2.12.2015**, që i përkiste çështjes me palë paditëse: A. R.; palë të paditura: DRT-ja Vlorë, DAT-ja pranë DPT-së; objekt gjykimi: akti administrativ nr. (***)

⁹³ Procesverbal datë 7.5.2019, dëshmia e z. L. S. .

⁹⁴ Kërkesë nr. (***) datë 3.5.2019, Gjykata Administrative e Apelit, 3 çështje (konflikt interesi).

Gjykata Administrative e Apelit, kthim përgjigjeje nr. (***) prot., datë 7.5.2019 (KPK (***)), 3 vendime:

vendimi nr. (***) datë 23.12.2014, Gjykata Administrative e Apelit (KPK (***)).

vendimi nr. (***) datë 10.9.2016, Gjykata Administrative e Apelit (KPK (***)).

vendimi nr. (***) datë 2.12.2015, Gjykata Administrative e Apelit (KPK (***)).

datë 20.8.2011 (gjobë) i DRT-së Vlorë dhe akti administrativ nr. (***), datë 28.12.2011 (vendim i drejtorit të DAT-it) i DAT-it në DPT;

- **vendim nr. (***), datë 10.9.2016**, që i përkiste çështjes me palë paditëse: “G.” sh.p.k.; palë të paditura: DRT-ja Berat, DAT-i pranë DPT-së; akti administrativ nr. (***), datë 23.3.2012 i DRT-së Berat dhe akti administrativ nr. (***), datë 17.8.2012 (vendim i drejtorit të DAT-it) i DAT-it në DPT.

2.23 Nga analizimi i çështjeve e specifikisht datave e lëshimit të akteve administrative, krahasuar me datat e gjykimit (sipas datës së secilit vendim), komisioni konstatoi se *në datat e akteve të dala objekt gjykimi*, bashkëshortja e subjektit, ka mbajtur pozicionin e zëvendësdrojtores së përgjithshme të Departamentit të Procedurave të Teknologjisë së Informacionit në DPT, ndërsa në datat e gjykimit, ka mbajtur pozicionin e drejtorit në DRTTM.

2.24 Në vlerësim të rrethanave sa më sipër arsytuar Komisioni për tri vendimet gjyqësore: vendimi nr. 4594, datë 23.12.2014, vendimi nr. 2564 datë 2.12.2015, vendimi nr. 2574 datë 10.9.2016, si dhe për rastin me palë paditëse “P. T. S. Albania”, i kërkoi shpjegime subjektit, pasi dukej se ishte në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe ligjit nr. 96/2016, sipas paragrafit 4 të nenit 75.

2.25 Në përfundim të hetimit administrativ për vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, shkronja b, pika 3, neni B, për gjendje të mundshme konflikti interesash të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, me shkresën nr. (****) prot., datë 31.5.2019, administroi opinionin e dhënë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, të cilin ia vuri në dispozicion subjektit.

2.26 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet e tij të datës 10.6.2019, dhe në seancën dëgjimore, ndër të tjera ka dhënë shpjegime:

- i) Për procedurën⁹⁵ standarde të lëvizjes së çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit.
- ii) Për kohën e ndërmarrjes së veprimit të heqjes dorë (të paraqitjes së kërkesës për heqje dorë, pasi, sipas subjektit lidhet me fillimin e studimit të dosjes, pasi konstatohej shkak, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile apo që vlerësohej nga vetë gjyqtari sipas nenit 73, të Kodit të Procedurës Civile), të bazuar për parimin e së vërtetës objektive, për të shmangur në çdo rast paraqitjen e kërkesave fiktive apo të pabazuara, të cilat mund të shkaktonin shmangie nga përmbushja e detyrës.
- iii) Për ngarkesën e lartë të çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit,⁹⁶ prej së cilës vinte pasojë që çështjet qëndronin në kryesekretari dhe për bazën e kërkesës së gjyqtarit relator ato të tërhiqeshin për studim e, për rrjedhojë, në thelb nuk kishte vonesë në paraqitjen e kërkesës për heqje dorë, por vetëm vonesë për shqyrtimin e çështjes, e cila lidhej me situatën e ngarkesës, arsye që referojnë edhe rastin e çështjes me palë paditëse “Raiffeisen Bank”, ku sipas subjektit ai ka dhënë dorëheqjen pikërisht në momentin e njohjes me relacionin e gjyqtarës relatore. Ka parashtruar se nëse çështja do të shqyrtohej brenda një afati 30-ditor (siç kishte gjykuar të gjitha çështjet ku kishte qenë gjyqtar relator në vitet 2014, 2015, 2016), atëherë edhe kërkesa do të ishte në këtë hark kohor prej 30 ditësh. Në lidhje me çështjen e identifikuar “P. T. S. Albania” subjekti ka shpjeguar se në momentin e marrjes në dijeni kur kishte verifikuar aktet e dosjes, përpara radhës së gjykimit, kishte paraqitur kërkesën për heqje

⁹⁵ Referojuni shpjegimeve të tij të datës 10.6.2019.

⁹⁶ Që nga viti 2014 ngarkesa e gjykatës që përbëhet nga dosjet që presin për gjykim ka qenë në rritje, nga 12000 deri në 13000 dosje.

dorë, e, për rrjedhojë, nuk mund të ishte në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, pasi vetëm në kushtet e kryerjes së veprimeve mund të vlerësohet konflikti i interesit bazuar në nenin 4/2⁹⁷ të ligjit, nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

iv) Subjekti ka parashtruar përmes një analize juridike se ka përmbushur testin objektiv dhe subjektiv për ofrimin e garancive të mjaftueshme për të përjashtuar çdo lloj dyshimi legjitim në lidhje me paanshmërinë e tij, duke cituar vendime⁹⁸ të gjykatave europiane të të drejtave të njeriut, për standardet e paanshmërinë.

v) Subjekti ka shpjeguar nën një analizë ligjore për çdo dyshim të komisionit, duke arsyetuar tri çështje,⁹⁹ specifikisht; nëse qenia e bashkëshortes së tij në një detyrë apo në detyra të ndryshme në administratën tatimore ishte një premisë për lindjen e konfliktit në dukje të interesit, *apriori*, apo nuk ishte premisë për lindjen e konfliktit të interesit vetëm ky fakt, pa u shoqëruar me një shkak tjetër; nëse qenia e bashkëshortes së tij në detyrën e zëvendësdrotores së përgjithshme të tatimeve përbënte premisë për lindjen e konfliktit të interesit; për garancitë e mjaftueshme që kishte ofruar për përjashtimin e çdo dyshimi të ligjshëm në lidhje me paanshmërinë e tij, për të cilën subjekti ka paraqitur një numër të konsiderueshëm kërkesash për dorëheqje nga subjekti për periudhën 2013 e aktualisht.

2.27 Trupi gjykues, në vlerësim të të gjithë situatës në kuadër të hetimit të thelluar, dhe të shpjegimeve të subjektit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, arsyeton:

2.27.1 Në lidhje me procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K.” sh.p.k., në konsideratë të fakteve: i) se në kohën e gjykimit ka rezultuar përmbushja e të drejtave dhe e detyrimeve sipas kontratës noteriale nr. (***), datë 21.10.2015; ii) se kjo pasuri ishte rivlerësuar dhe po ashtu ishte shitur pas tre muajve nga pala blerëse në një çmim më të lartë; iii) se nga provat e paraqitura nga subjekti kontratat e ngjashme me çmime të përafërta tregojnë se nuk ka një çmim preferencial, iv) se në lidhje me vendimmarrjen kjo gjykatë e ka pranuar pjesërisht këtë padi; v) se provat e paraqitura nga subjekti, vendimet e Gjykatës e Lartë, si dhe Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt padie të njëjti, tregojnë se është mbajtur i njëjti qëndrim.

Sa më sipër, në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, trupi gjykues çmon se faktet e rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit.

2.27.2 Në lidhje me çështjen “Raiffeisen Bank”, trupi gjykues çmon se, referuar dispozitave ligjore të nenit 4/2, të ligjit, nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, cili parashikon: “...për qëllime të këtij ligji, vendimmarrje për një akt do të vlerësohet në çdo rast çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja e aktit, si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit për konfliktin e interesit...”, në analizë të dokumentacionit në dosje, në kushtet që subjekti ka qenë anëtar i trupës, si dhe ka dhënë dorëheqjen nga kjo çështje, në momentin e rënies në dijeni të fakteve

⁹⁷ Ky nen përcakton: “Për qëllime të këtij ligji, vendimmarrje për një akt do të vlerësohet në çdo rast çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja e aktit, si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit.”

⁹⁸ Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium, vendim i datës 23 qershor 1981, seria A, nr. 43, p. 25, § 58). Vendim i datës 7.8.1996, Reports 1996-III, p. 951-52, § 58, dhe Wettstein v. Switzerland, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII; Kyprianou v. Cyprys [GC], nr. 73797/01, §§ 118 -119, ECHR 2005). Shihni Piersack v. Belgium, vendimi i datës 1.10.1982, seria A, nr. 53, § 30, dhe Kyprianou v. Cyprus [GC], nr. 73797/01, § 118-119, ECHR 2005-...

⁹⁹ Referojuni shpjegimeve të subjektit të datës 10.6.2019.

dhe të rrethanave, që sipas deklaramit të kancelarit të gjykatës, anëtari i trupit gjykues merrte dijeni kur i komunikohet fizikisht dosja gjyqësore dhe relacioni i gjyqtarit relator, janë përmbushur kërkesat e paanshmërisë së tij përpara dhënies së vendimmarrjes.

2.27.3 Në lidhje me çështjen e “P. T. S. Albania”, trupi gjykues çmon se rrethanat objektive të ngarkesës që ka Gjykata Administrative, të cilën subjekti e parashtron si fakt të njohur publikisht, por edhe të provuar me dokumentacion¹⁰⁰, si dhe moskryerja e asnjë veprimi lidhur me këtë dosje, situata e konfliktit të interesit duhet të vlerësohet duke konsideruar të gjitha faktet dhe rrethanat si në thelb, ashtu edhe në dukje, si dhe nuk duhet të jetë e veçuar nga raporti midis detyrës së zyrtarit dhe vendimmarrjes. Në këtë kuptim është detyrë e çdo zyrtari të vlerësojë rrethanat e pasjes ose jo të kërkesave të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile apo të vlerësimit se çfarë kuptohet me vendimmarrje sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

2.27.4 Në lidhje me gjithë situatën e çështjeve të tjera të analizuara apo të pasqyruara në aneksin nr. 1 të rezultateve të hetimit trupi gjykues çmos se: në kushtet që gjatë hetimit administrativ në asnjë rast nuk u provua se subjekti kishte gjykuar çështje që mund të lidheshin me detyrën që kishte ushtruar bashkëshortja të çfarëdolloj forme (mendimi, opinioni, vullneti, veprimi procedural, teknik) në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ, si dhe në momentin e gjykimit të çështjes, subjekti ka përmbushur kërkesat e nenit 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile.

2.27.5 Trupi gjykues, në të gjithë situatën objekt vlerësimi, në raport me zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë paanshmërinë e subjektit, Kodi i Procedurës Civile dhe atë të konfliktit të interesit sipas ligjit nr. 9367/2005, çmon se paanshmëria e gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje duhet vlerësuar bazuar në dy testet: në testin subjektiv, i cili ka të bëjë me qasjen subjektive, me qëndrimin personal të një gjyqtari të caktuar në një rast të caktuar; si dhe në testin objektiv që ka të bëjë me faktin nëse ai ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmërinë në gjykim. Në përmbushjen e këtyre dy testeve trupi gjykues ka analizuar faktet dhe rrethanat e të gjithë hetimit të thelluar, në raport me garancitë e mjaftueshme që ofron subjekti për paanshmërinë. Gjatë këtij vlerësimi trupi gjykues, i është referuar standardizimit të qasjes ligjore që kanë vendosur vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut për “Paanshmërinë”. Në lidhje me testin subjektiv, GJEDNJ-i ka përcaktuar se: paanshmëria duhet të prezumohet derisa të ketë prova për të kundërtën, ndërsa në lidhje me testin objektiv, GJEDNJ-i përcakton garancinë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo lloj dyshimi të ligjshëm (shikoni si shembull *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium*, vendim i datës 23 qershor 1981, seria A, nr. 43, p. 25, § 58).

Trupi gjykues çmon se për sa kohë në hetimin e thelluar nuk u provua, që pozicioni i bashkëshortes së subjektit kishte lidhje me çështje të caktuara, të çfarëdolloj forme dhe, për më tepër të shfaqej ndonjë interes i drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i ndikuar apo i pritshëm, nga aktet objekt gjykimi, subjekti i rivlerësimit ofron garanci lidhur me përmbushjen e testit objektiv.

Lidhur me testin subjektiv, nën jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, trupi gjykues çmon se vetëm qenia e personit të lidhur në një detyrë apo në detyra të ndryshme në administratën tatimore, nuk mund të jetë arsye për rrethana konflikt interesi, pasi pavarësisht sjelljes së gjyqtarit, dyshimet për paanshmërinë e tij duhet të jenë objektivistisht të justifikueshme, siç parashikohet në vendimin e gjykatës europiane të drejtave të njeriut, datë 7

¹⁰⁰ Referojuni shkresës (***), datë 18.9.2018, shkresës nr. (***), datë 26.4.2018, shkresës nr(***), prot., datë 2.10.2018, shkresës nr. (***) prot., datë 26.4.2018 të mbajtura midis Gjykatës Administrative të Apelit dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.

gusht 1996, Reports 1996-III, p. 951-52, § 58, dhe Wettstein v. Switzerland, nr. 33958/96, § 44, CEDH 2000-XII; Kyprianou v. Cyprys [GC], nr. 73797/01, §§ 118 -119, ECHR 2005).

Nisur nga parashikimi i nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, “heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes”, “*gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij,*” trupi gjykues çmon se ky vlerësim është tërësisht i lidhur me anën subjektive të zyrtarit, bindjen e brendshme të tij, për vlerësimin e rrethanave, shkaqeve për të mos qenë në kushtet e konfliktit të interesit edhe në dukje. Në këtë kuptim vlerësimi i tyre duhet të jetë objektiv dhe për shkaqe të justifikueshme, pasi në të kundërt ajo do të përbëjë në vetvete “konflikt interesi” me atë të shmangies nga përmbushja e detyrës. Po këtë argument trupi gjykues e gjen të parashikuar në manualin shpjegues për parandalimin e konfliktit të interesit sipas ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, që citon: “*Vlen të theksohet që, megjithëse shmangia e konfliktit të interesit është tejet e rëndësishme, do të ishte po aq e dëmshme për interesin publik që ky detyrim të përdoret si “justifikim” apo “pretekst” nga zyrtari apo eprori i tij që t’i shmanget kryerjes së detyrës. Një sjellje e tillë është në vetvete konflikt interesi*”.

Nën analizë të gjithë situatës objekt vlerësimi për garancitë që duhet të ofrojë një zyrtar/subjekt për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmërinë në gjykim, trupi gjykues në konsideratë të fakteve dhe rrethanave, si dhe provave të tilla, si:

- i) paraqitja e një numri të konsiderueshëm kërkesash për dorëheqje nga subjekti për periudhën 2013 e aktualisht;
- ii) faktet që nga hetimi i thelluar i të gjitha çështjeve në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit, e dosjeve të analizuara e studiuara, në asnjë rast nuk rezultoi gjykim i tyre për akte të dala apo të kundërshtuara për pozicionin që ka mbajtur bashkëshortja;
- iii) paraqitja e kërkesës së subjektit për dorëheqje edhe në rast se kur bashkëshortja nuk ka nënshkruar akte objekt gjykimi;
- iv) kërkesat për dorëheqje nga subjekti edhe në rastet kur nuk lidheshin me akte të strukturave tatimore;
- v) ngarkesa e lartë e çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, e prezantuar nga subjekti në cilësinë e kryetarit përpara organeve përkatëse, fakte këto publike;
- vi) në asnjë prej dosjeve të hetuara nga Komisioni, por edhe nga denoncimet nuk rezulton kërkesa për përjashtim të subjektit me këtë objekt;
- vii) konkludimi i organit të rivlerësimit në raportin profesional se gjatë periudhës së vlerësimit, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve, nuk janë konstatuar elemente që të vinin në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit;

*Si dhe në konsideratë të standardizimit të qasjes ligjore të vlerësimit të paanshmërinë së gjyqtarit nga vendimet e gjykatave europiane të të drejtave të njeriut, sa më sipër cituar, **trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmërinë në gjykim.***

Për sa i përket interesit publik, trupi gjykues çmon se ky interes kërkon jo vetëm plotësimin e kushteve të paanshmërisë, por edhe gjykimin e çështjeve brenda afateve ligjore, duke mos iu shmangur detyrës, qoftë edhe nga ngarkesa e lartë e çështjeve që kjo gjykatë ka në raport me

numrin e gjyqtarëve, fakte këto të njohura publikisht dhe prezantuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryetarit të kësaj gjykatë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.¹⁰¹

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues në vlerësimin të përmbajtjes së çështjes administrative me palë ndërgjyqëse paditës shtetasin B. V. dhe të paditur Presidentin e Republikës, përfunduar me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me nr. (***) , datë 6.2.2019, çmon se ekzistojnë mangësi të cilat janë të lidhura:

- ✓ me ekzistencën e mospërputhjeve mes kërimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës, pasi rezulton se paditësi nuk ka kërkuar që t'i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë që të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori.
- ✓ me rolin aktiv të gjykatës/subjektit, lidhur me saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke detyruar KLP-në¹⁰² të bëjë emërimin e paditësit si prokuror;
- ✓ me tejkalimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces;
- ✓ me mosarsyetimin e rolit dhe të kompetencave të palës ndërgjyqëse/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në momentin e zëvendësimit të saj, sipas ligjit nr. 96/2016.

Sa më sipër arsyetuar e vlerësuar, bazuar në parashikimet ligjore të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016: “Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”; pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016 përcakton: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet, duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për marrë vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës dhe aftësinë për të për të analizuar jurisprudencën. Pika 4, e nenit 72, të ligjit nr. 96/2016 përcakton: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar për korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

Trupi gjykues çmon vetëm mangësitë e gjetura në çështjen gjyqësore, duke vlerësuar se këto mangësi përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr. 96/2016, i cili rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:

- pikën 1, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;
- Nenin 40 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit “...objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etiko-profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve e prokurorëve”.
- Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arrijten e një niveli minimal kualifikues”.

¹⁰¹ Referojuni shkresës nr. (***) , datë 18.9.2018, shkresës nr. (***) , datë 26.4.2018, shkresës nr. (***) prot., datë 2.10.2018, shkresës nr. prot. (***) , datë 26.4.2018, të mbajtura midis Gjykatës së Apelit Administrativ, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Avokatit të Popullit.

¹⁰² Neni 148/Ç, i Kushtetutës, shtuar me ligjin nr. 76/2016, neni 36 i tij.

- Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias), pas rekomandimit të relatorit të çështjes:

Konkludoi se:

-Për kriterin e vlerësimit etiko-profesional, bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë”.

- Sa i përket çështjes administrative me palë ndërgjyqëse paditës shtetasin B. V. dhe të paditur Presidentin e Republikës, përfunduar me vendimin nr. (***) datë 6.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për mangësitë e evidentuara sa më sipër arsyetuar, bazuar në germen “c”, të pikës 1, të nenit 40, si dhe në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe të ligjit nr. 96/2016, çmon ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, çmon se:

- *Për kriterin e pasurisë* nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm subjekti i rivlerësimit, ka plotësuar me vërtetësi dhe saktësi deklaratën “Vetting” dhe ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në përputhshmëri të plotë me deklaratimet periodike, si dhe të mbështetur në dokumentacion ligjor që në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në ILDKPKI, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016. Hetimi i thelluar administrativ i Komisionit për burimet e bashkëshortes para martese apo konstatimi i pasaktësisë së saj, në një nga pasuritë e deklaruara dhe që nuk cenonte burimin e ligjshëm, nuk passjell pasojë ligjore për subjektin e rivlerësimit e, për rrjedhojë, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- *Për kriterin e kontrollit të figurës*, trupi gjykues në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucioneve përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë, edhe pas hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- *Për kriterin profesional*, nisur nga vlerësimi pozitiv i organit vlerësues se subjekti ka aftësi ligjore për të gjykuar, bazuar në standardet e jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, të Kushtetutës, dhe KEDNJ-it, të konstatuara edhe gjatë hetimit të Komisionit për këtë kriter, por edhe nga denoncimet, të cilat ishin të lidhura kryesisht me themelin e çështjes (jo pak herë u konstatua se ato kishin përmbajtjen e rekurseve që kishin paraqitur në Kolegjin e Lartë Administrativ), çmon se subjekti i ka përmbushur kushtet ligjore të pikës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/ kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.
2. Transferimin e dosjes që i përket çështjes administrative me palë ndërgjyqëse: paditës shtetasin B. V. dhe të paditur Presidentin e Republikës, përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 6.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të kryhet ankim në Kolegjin e Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici
Kryesues/Anëtar në pakicë

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Brunilda Bekteshi
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta

MENDIM PAKICE

Unë, komisioneri Olsi Komici, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit të datës 18.6.2019 të marrë nga shumica e trupit gjykues, nëpërmjet të cilit është vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në vijim do të shpjegoj qëndrimin tim të arsyetuar kundër konkluzioneve dhe vendimit të shumicës së trupit gjykues, pa përsëritur argumentet dhe konkluzionet e dhëna nga shumica për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim.

Kundërshtitë e mia në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues kanë të bëjnë me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe atë profesional, duke i renditur si më poshtë.

I. Vlerësimi i pasurisë

Në pikën 3 të vendimit, e cila ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë, është pasqyruar deklarimi i subjektit i pasurisë të llojit “Apartament banimi” (*dubleks*) me sip. 205.33 m² dhe truall me sip. 521.08 m², me adresë: Kompleksi Rezidencial “L.” (buzë plazhit të Gjirit të Lalzit), I., Durrës; pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , Durrës; sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***) , datë 4.6.2012 dhe, më pas, kontratës së shitjes nr. (***) , datë 20.8.2015; vlera e blerjes së apartamentit 82.132 euro; vlera e blerjes së truallit 956.457 lekë; pjesa takuese: 50%.

Burimet e krijimi të deklaruar rezultojnë:

35.000 euro – të ardhura nga shitja e apartamentit me nr. pasurie (***) , z.k. (***) , me sip. 48.27 m², sipas kontratës nr. (***) , datë 27.5.2011; me adresë: Komuna Sh., Lezhë, për të cilin në deklaratën “Vetting” subjekti ka sqaruar se:

Apartamenti me sip. 48,27 m²** është blerë në shumën 2.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. () , datë 25.1.2010. Shuma 2.000.000 lekë me të cilën është blerë ky apartament është marrë nga vendimi nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

* **Vendimi nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** ka të bëjë me pjesëtimin e pasurisë apartament, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. (***) , datë 3.6.2002. Ky apartament është blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. (***) datë 6.12.2003 nga të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës 1999 – 2003. Adresa: Rr. “M. Gj.”, p. (***) , k. (***) , Tiranë.

30.000 euro – kursime të bashkëshortes të krijuara përpara martesë (të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, të ardhura këto të realizuara nga shitja e shtëpisë private me 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m², pasuria nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , në shumën 220.000 euro), sipas kontratës nr. (***) , datë 9.6.2008. me adresë: Rr. “M. K.”, pranë F. B., Q., L., Tiranë.

1. Në lidhje me burimin e krijimit: “*Vendim nr. (***) akti dhe nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka të bëjë me pjesëtimin e pasurisë apartament, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. (***) , datë 3.6.2002*”, shumica, në vendim, ka argumentuar se si burim i ligjshëm financiar të përdorur për blerjen e apartamentit në komunën Sh., L., kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 25.1.2010, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë, ka shërbyer shumë prej 2.900.000 lekësh e përfituar nga subjekti si rezultat i procedurës së

pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore me marrëveshje të miratuar me vendimin nr. (***) , datë 19.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3.2.7 Me aktmarrëveshjen e datës 6.6.2006 mes palëve Kastriot Selia dhe A. Gj., evidentohet fakti i përfundimit të gjykimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim të datës 11.5.2006, në të cilin janë përfshirë apartamenti dhe orenditë shtëpiake. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje palët kanë rënë dakord që apartamenti dhe orenditë të kalojnë në pronësi të palës A. Gj., ndërsa kjo e fundit detyrohej t'i paguante palës Kastriot Selita shumën prej 2.900.000 lekësh. Kjo aktmarrëveshje parashtrohet në gjykatë në fazën e dytë të pjesëtimit, e cila, me vendimin nr. (***) , datë 19.6.2006, "Faza e dytë e pjesëtimit", ka vendosur që ta pranojë atë sipas përmbajtjes që kanë përcaktuar palët.

3.2.8 Në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, të dhëna nga ish-bashkëshortja, subjekti deklaroi: "*Burimi i ligjshëm i shumës 2.900.000 lekë ish-in vendimet¹⁰³ e pjesëtimit të pasurisë të cituara më sipër*".

3.2.9 Për mënyrën e përmbushjes së marrëveshjes së datës 6.6.2006, në deklarinimin¹⁰⁴ e saj, shtetasja V. T., në cilësinë e avokates së subjektit të rivlerësimit, deklaroi se pas miratimit të marrëveshjes së pjesëtimit të pasurive me vendim gjyqësor, ajo kishte qenë personi që kishte marrë fizikisht shumën 2.900.000 lekë nga znj. A. Gj., e cila e kishte tërhequr nga "Raiffeisen Bank" dhe, më pas, avokatja ia kishte dorëzuar subjektit.

3.2.10 Rezulton se "Raiffeisen Bank"¹⁰⁵ e ka konfirmuar se shtetasja A. Gj. ka derdhur shumën 2.900.000 lekë në datën 13.6.2006 dhe tërheqjen e po kësaj shume në datën 19.6.2006.

Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2005 subjekti ka deklaruar se është zgjidhur martesja dhe se në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Gjendjes Civile¹⁰⁶ Durrës (ZGJC2), pasqyrohet statusi i subjektit "i divorcuar", sipas vendimit gjyqësor nr. (***) , datë 14.9.2005, zbatuar më 3.2.2006.

[...]

3.2.19 Komisioni, për verifikimin e burimeve të ligjshme, të pasurisë në fjalë, por edhe të verifikimit të shumës 2.900.000 lekë (*e ardhur nga pjesëtimi i pasurisë mes ish-bashkëshortëve*), i kërkoi shtetasës Aida Gjeka të paraqitej për të dhënë deklarinimin e saj për çështjet e ngritura në rezultatin e hetimit, por pas njoftimit, rezultoi se shtetasja në fjalë e nënshkroi marrjen dëgjoni, por nuk u paraqiti.

- Lidhur me burimin e shumës prej 2.900.000 lekësh, nisur nga faktet, rrethanat dhe provat që kanë krijuar këtë burim, trupi gjykues arsyeton:

- Lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi, trupi gjykues vlerëson se fillimisht duhet të çmohen tri situata kryesore në kuptim të ligjit nr. 84/2016:

➤ *Së pari, cila ka qenë pozita e subjektit në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave?*

➤ *Së dyti, a ka rrethana se ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur?*

➤ *Së treti, a është subjekti në kushtet e pamundësisë për të justifikuar këtë burim?*

¹⁰³ Vendimi I pjesëtimit (faza e parë) nr. (***) , datë 11.5.2006, vendimi i pjesëtimit (faza e dytë) nr. (***) akti, nr. (***) vendimi, datë 19.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁰⁴ Referojuni deklarinimit të shtetasës V. T., dhënë përmes e-mail-it, datë 11.1.2019.

¹⁰⁵ Shkresa nr. (***) prot., datë 15.1.2019.

¹⁰⁶ Referojuni shkresës (***) , datë 15.10.2018.

➤ ***Së katërti, a është subjekti në kushtet e pamundësisë për të justifikuar këtë burim?***

Lidhur me situatën e parë, në analizë të fakteve e të provave sa më sipër, shumica e trupit gjykues çmon se pozita e subjektit, në momentin e përfitimit të këtyre të ardhurave, është vetëm ajo e një pale në një transaksion, që shkaktohet si rrjedhojë e përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga një vendim gjyqësor, i cili është marrë pas divorcit të palëve ndërgjyqëse, që ushtrojnë të drejtat dhe liritë civile të parashikuara në Kodin Familjes, Kodin Civil, nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e gjykatës dhe të shërbimit përmbarimor.

Lidhur me situatën e dytë, nga arsyetimi i mësipërm, si dhe në analizë të provave, trupi gjykues vlerëson se në çmuarjen ligjore të shumës 2.900.000 lekë duhet të mbahen në konsideratë faktet e provuara gjatë hetimit se kjo shumë është një vlerë që nuk ka qenë gjendje në sistemin bankar apo dhe e deklaruar gjatë deklarimeve periodike para divorcit, por ka qenë shumë e hyrë jashtë pasurisë bashkëshortore, si dhe në periudhën që është miratuar aktmarrëveshja e formalizuar me vendim gjyqësor, palët nuk e kishin më statusin e bashkëshortëve. Në vlerësimin e rrethanave, trupi gjykues çmon se raporti mes palëve ndërgjyqëse nuk përbën marrëdhënie të posaçme interesi, sipas ligjit nr. 84/2016, ku palët nuk ndërvaren nga njëri-tjetri në ushtrimin e së drejtës së pjesëtimit, pasi çdo qytetar ka të drejtë (legjitimohet) që të realizojë të drejtat pasurore nëpërmjet gjykatës, pavarësisht dëshirës apo interesit të palës kundërshtare. Në këto argumente, trupi gjykues çmon se nuk ka rrethana për të cilat ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur.

Lidhur me situatën e tretë, Komisioni vlerëson se, për sa kohë subjekti nuk ka qenë në një marrëdhënie huamarreje apo përfitimi të ndonjë dhurimi nga një person i tretë, ai nuk mbart detyrimin që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të marra nga të tretët.

Lidhur me situatën katërt, trupi gjykues nisur nga faktet: (i) se për përjashtimin e çdo dyshimi për këtë burim kërkoi thirrjen e ish-bashkëshortes së subjektit për të dëshmuar për burimin e ligjshëm, e cila, me gjithë marrjen dijani duke nënshkruar njoftimin, nuk u paraqiti; (ii) se subjekti ka deklaruar dhe ka dëshmuar pamundësinë e tij për të provuar burimin e krijimit të shumës së blerjes së pjesës së pasurisë në bashkëpronësi, për shkak të cenimit të privatësisë së ish-bashkëshortes, bazuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, çmon se nuk ka rrethana që të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, për sa kohë nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pamundësia ligjore dhe objektive e subjektit rezulton në nivel provueshmërie.

3.2.22 Në vijim të hetimit administrativ rezulton se në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka sqaruar se me shumën 2.900.000 lekë, që i ka dorëzuar fizikisht ish-bashkëshortja, znj. A. Gj. (me ndërmjetësimin e avokates V. T.), ai ka kryer transaksionin: kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme, nr. (***), datë 25.1.2010, me palë shitëse shoqërinë “C.” sh.p.k., me administrator F. C. dhe palë blerëse Kastriot Selita, me objekt apartamentin me sip. 48.27 m², me nr. pasurie (***), në komunën Sh. të L., me vlerë 2.000.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

Për sa më sipër argumentet e mia kundërshtuese dhe konkluzionet janë:

Në aktmarrëveshjen e datës 6.6.2006, lidhur ndërmjet subjektit dhe shtetasës A. Gj., përcaktohet se me vendimin e datës 11.5.2006 të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili ka marrë formë të prerë, është vendosur lejimi i pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore të sendit të paluajtshëm: apartament 1+1, me sip. 73 m², i ndodhur në Tiranë, dhe i pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore

të 7 sendeve të luajshme. Në këtë aktmarrëveshje, palët, duke marrë për bazë edhe vendimin e fazës së parë të pjesëtimit, bien dakord që apartamenti dhe sendet e luajshme do të kalojnë në pronësi të znj. A. Gj., ndërsa kjo detyrohet t'i paguajë z. Kastriot Selita shumën prej 2.900.000 lekësh.

Konstatohet se shuma prej 2.900.000 lekësh nuk është pjesë e pasurisë bashkëshortore objekt pjesëtimi. Gjithashtu, kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të pasurisë si kursim apo si e ardhur.

Aktmarrëveshja e datës 6.6.2006 për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore është e lidhur ndërmjet të dy palëve me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar.

Vendimi nr. (***), datë 19.6.2006, "Faza e dytë e pjesëtimit", i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka bërë gjë tjetër përveçse ka miratuar marrëveshjen e datës 6.6.2006.

Pra, të dyja palët kanë shprehur dakordësinë e tyre duke arritur në një marrëveshje të lirë e të pavesuar, si dhe të miratuar nga gjykata, që të gjitha sendet e paluajshme e të luajshme, pasuri bashkëshortore, të merren nga znj. A. Gj., e cila në këmbim detyrohet t'i japë z. Kastriot Selita, shumën prej 2.900.000 lekësh.

Ndodhur në këto kushte, kemi të bëjmë me një marrëdhënie të mirëfilltë interesi, çka të çon në konkluzionin se znj. A. Gj. kalon automatikisht në statusin e personit tjetër të lidhur që ka lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit që rrjedh nga një interes pasuror. Kjo përforcohet edhe me faktin se shuma prej 2.900.000 lekësh futet nga znj. A. Gj. në këtë marrëveshje jo si një pasuri bashkëshortore, por si një pasuri që vjen nga jashtë regjimit martesor.

Në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Në këtë kontekst subjekti nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të shumës prej 2.900.000 lekësh, dhënë atij nga znj. A. Gj., shumë e cila ka shërbyer fillimisht si burim financiar për blerjen e apartamentit në Sh., Lezhë e më pas për blerjen e apartamentit në Gjirin e Lalzit me kontratë sipërmarrje në vitin 2012 dhe kontratë shitblerje në vitin 2015. Burimi i ligjshëm i shumës së përfituar nga subjekti prej 2.900.000 lekësh nuk është deklaruar as në deklaratën periodike vjetore të pasurisë për vitin 2006. Subjekti ka gabuar kur si burim të ligjshëm të kësaj shume ka deklaruar vendimin e gjykatës për pjesëtim të pasurisë bashkëshortore.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një marrëveshje pjesëtimi pasurie bashkëshortore me vullnet të lirë dhe të pavesuar të palëve dhe me një shumë monetare që vjen nga jashtë pasurisë bashkëshortore, subjekti duhet të ishte siguruar për ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume nga znj. A. Gj. përpara lidhjes së kësaj marrëveshjeje, përpara se të pranonte këtë shumë, veprim të cilin subjekti nuk e ka kryer, për më tepër që deri në muajin shtator të vitit 2005 subjekti ka qenë në dijeni të të ardhurave të ligjshme në emër të ish-bashkëshortes.

Në një përlllogaritje të të ardhurave dhe të deklarimeve të shtetasës A. Gj. në deklaratat e pasurisë për vitet 2003 dhe 2004 rezulton se për vitin 2003 ajo ka deklaruar vetëm të ardhurat nga paga në shumën 45.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë të vitit 2004, ajo ka deklaruar një depozitë bankare në shumën 600.000 lekë, me vit krijimi vitin 2002 e në vazhdim, dhe me burim kursimet nga të ardhurat, gjithashtu edhe të ardhurat nga paga në shumën 651.380 lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se depozita bankare e vitit 2004 përfshin edhe kursimet nga të ardhurat për vitin 2004, marrë në konsideratë edhe një nivel mesatar të pagave në administratën shtetërore për vitin 2005 dhe 2006, krijohet bindja se shtetasja A. Gj. nuk i ka pasur mundësitë financiare që deri në datën 19.6.2006 të ketë kursyer shumën prej 2.900.000 lekësh, kaluar subjektit të rivlerësimit në po këtë datë.

Pretendimi i subjektit për aplikimin e nenit 32/2 në këtë rast, është i pavend, sepse kjo shumë/e ardhur është pranuar nga vetë ai në vitin 2006, në bazë të aktmarrëveshjes, me vullnetin e tij të lirë e, për rrjedhojë, në deklarimin e tij të pasurisë në vitin 2006 ai e kishte detyrimin ligjor të deklaronte ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume monetare.

Konkluzion

Në bazë të pikës 3, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës nuk identifikohet dhe nuk vërtetohet nga subjekti i rivlerësimit burimi i krijimit dhe ligjshmëria për shumën prej 2.900.000 lekësh, përfituar nga subjekti me aktmarrëveshjen e pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, datë 6.6.2006, miratuar me vendimin nr. (*), datë 19.6.2006, “Faza e dytë e pjesëtimit”, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çka ka çuar në blerjen nga subjekti të apartamentit, ndodhur në Sh., Lezhë, me burime të paidentifikuara e, pra, të paligjshme financiare e për pasojë mungesën e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në Gjirin e Lalzit sipas kontratës së sipërmarrjes të vitit 2012 dhe asaj të shitblerjes të vitit 2015.**

Për rrjedhojë, kemi të bëjmë me një balancë financiare negative në vitin 2006, kur kjo shumë deklarohet për herë të parë dhe në vitet kur kjo shumë është përdorur për të krijuar pasuri, konkretisht në vitet 2010 dhe 2011.

2. **Në lidhje me burimin e krijimit “30.000 euro, kursime të bashkëshortes të krijuara përpara martese (të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, të ardhura këto të realizuara nga shitja e shtëpisë private me 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m², pasuria nr(***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në shumën 220.000 euro), sipas kontratës nr. (***), datë 9.6.2008. Adresa: Rr. “M. K.”, pranë F. B., Q., L., Tiranë”.**

Në lidhje me këtë burim krijimi shumica e trupit gjykues argumenton se:

3.2.34 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se burimi i shumës 30.000 euro është: *“...Kursime të bashkëshortes të krijuara përpara martese, të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trangu familjar në vitin 2010, të ardhura këto të realizuara nga shitja e shtëpisë private me 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m², pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në shumën 220.000 euro, sipas kontratës nr. (***), datë 9.6.2008. Adresa: Rr. “M. K.”, pranë F. B., Q., L., Tiranë”.*

3.2.35 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2010, personi i lidhur ka deklaruar: *“Nga shuma totale e kursimeve cash, e deklaruar në vitin 2008, në shumën 60.000 euro dhe në deklarimin e vitit 2009, në shumën 6.000 euro, theksoj se shuma totale e gjendjes cash që unë zotëroj është 30.000 euro. Kjo gjendje cash është krijuar nga shitja e asetëve familjare të deklaruar në deklaratimet e mëparshme dhe kursimet e vitit 2009”.*

3.2.36 Në lidhje me këtë transaksion është bërë trajtimi në lidhje me burimin e të ardhurave për apartamentin të “P.A.”, më sipër arsyetuar.

3.2.37 Rezulton se personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008, shitjen e shtëpisë (vilë) së familjes në periudhën e vajzërisë blerësit A. M. . Shuma *neto* prej 204.365 eurosh provohet që të jetë shlyer ndaj babait të personit të lidhur, z. A. K. . Me këtë shumë u kryen disa transaksione, duke nisur me pagesën prej 120.000 eurosh për blerjen e dy apartamenteve nga shoqëria “U.” sh.p.k. (një për të bijën, M. K., dhe një për të birin, F. K.); likuidimin e një kredie të mbetur në shumën 21.798 euro, ndaj “NBG”-së në emër të personit të lidhur.

3.2.38 Lidhur me blerjet e tjera të realizuara me shumën 204.365 euro, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se: *“...shuma 4.365 euro shpenzuar për shpenzime*

*familjare (kryesisht për mobilim pjesor të apartamentit me sip. 126.5 m² të blerë nga shoqëria “U.” sh.p.k. sipas kontratës nr. (***)), pasi pas shitjes së shtëpisë private 2 kat + papafingo për një periudhë afro 4-vjeçare në këtë apartament ka jetuar e gjithë familja e bashkëshortes.*

- Gjendje cash, në vitin 2008 në shumën 60.000 euro, shumë e cila është ndarë ndërmjet dy fëmijëve znj. M. K. dhe z. F. K., në mënyrë të barabartë nga 30.000 euro secili, në momentin e ndarjes nga trangu familjar.”

3.2.39 Rezulton se nga të dhënat e “BKT”-së konfirmohet fakti se shtetasi z. A. K. ka tërhequr cash në data të ndryshme shumën 76.937 euro dhe ka kryer transfertën bankare prej 120.000 eurosh ndaj shoqërisë “U.” sh.p.k., për blerjen e dy apartamenteve, si më sipër.

3.2.40 Në rrethanat e mësipërme, konstatohet se babait të personit të lidhur, pas shpenzimeve të kryera, i ka mbetur diferenca prej 30.000 eurosh për t’ia kaluar së bijës me rastin e martesës, shumë kjo e përfituar nga shitja e shtëpisë private me dy kate plus papafingo.

3.2.41 Në përfundim, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ konkludoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me burimet financiare të krijuara prej kursimeve të bashkëshortes para martesë, për gjendjen cash prej 30.000 eurosh ishte i saktë, por nuk mbështetej në dokumente shkresore që vërtetonte dorëzimin e kësaj shume e, për rrjedhojë, i kaloi barrën e provës.

3.2.42 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij ka depozituar deklaratë noteriale të babait të bashkëshortes, nëpërmjet të cilës konfirmohet dorëzimi fizik i shumës 30.000 euro cash.

3.2.43 Për faktin e dorëzimit të kësaj shume të bashkëshortja, si dhe për burimin e transaksionit të saj (nga shitja e shtëpisë blerësit A. M.), të konfirmuar nga z. A. K. me deklaratën noteriale, Komisioni u thellua në hetimin dhe analizën nëse kalimi i kësaj shume (30.000 euro – pjesë e shumës neto, afërsisht 205.000 euro), në kushtet kur transaksioni që e kishte prodhuar atë iu nënshtrua likuidimit të detyrimit tatimor, mund të përbëjë në thelb një transaksion të ri që, si i tillë, t’i nënshtruhej tatimit për të ardhurat sipas pikës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar) dhe sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), duke i kërkuar subjektit shpjegime për rezultatet shtesë.

3.2.44 Për një vlerësim sa më objektiv, Komisioni mori paraprakisht edhe mendimin e dy institucioneve të specializuara: të Ministrisë së Financave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3.2.45 Subjekti i rivlerësimit, përmes shpjegimeve të depozituara në datën 10.6.2019, ndër të tjera argumentoi se shuma 30.000 euro është marrë në momentin e ndarjes nga trangu familjar i bashkëshortes, nga babai i saj z. A. K. . Për të paraqitur me saktësi faktet e ndodhura, sqaron se kjo shumë nuk është një dhuratë martesë, por është shuma e përftuar nga bashkëshortja në momentin e ndarjes nga trangu familjar. Burimi i shumës 30.000 euro kishte qenë pikërisht shuma neto 204.365 euro, e cila rezulton si diferencë ndërmjet çmimit të shitjes së shtëpisë private në pronësi të babait të bashkëshortes sipas kontratës së shitjes, nr. (***), datë 9.6.2008 në shumën 220.000 euro me shumën e paguar për tatimin në shitje prej 1.902.280 lekësh. Subjekti ka parashtruar se bazuar në pikën “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), si dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), ky transaksion nuk ka siguruar të ardhura tatimore shtesë përderisa baza tatimore për llogaritjen e tatimit është 0 (shuma e marrë 30.000 euro – shumën për të cilën është paguar tatim 30.000 euro), pra, për rrjedhojë, edhe tatimi është 0 lekë. Sipas subjektit, e njëjta metodologji për llogaritjen e tatimit përdoret edhe nëse do t’i referohemi mënyrës së llogaritjeve që bëhen në rastin e dhurimit të pasurive të paluajtshme, përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë

së pasurisë së paluajtshme”, sipas të cilit fitimi kapital, ku baza tatimore për të cilën llogaritet tatimi është diferenca ndërmjet vlerës së pasurisë së dhuruar në momentin e dhurimit dhe çmimit të blerjes ose çmimit të referencës së pasurisë së dhuruar. Sipas subjektit nuk rezulton të ketë detyrim për pagesë të tatimit për shumën prej 30.000 eurosh të marrë nga bashkëshortja në momentin e ndarjes nga trangu familjar, për sa kohë që është paguar më parë tatimi për këtë shumë.

3.2.46 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave, në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të fakteve e provave, por dhe të ligjit të zbatueshëm arsyeton se sipas deklaramit të bashkëshortes në vitin 2005, provuar me deklaramin e saj në procesverbalin e datës 19.1.2007 në ILDKPKI, konfirmohet fakti se ajo ka dhënë kontributin më të madh në ndërtimin e kësaj pasurie. Ndërkohë, ka rezultuar se në vitin 2008 ajo nuk e ka deklaruar pjesën zotëruese të shumës prej 204.365 eurosh, që është çmimi i shitjes së shtëpisë, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010 ajo e ka deklaruar shumën 30.000 euro në pjesë takuese: 100 %. Nisur nga fakti se nga shitja e pasurisë është paguar tatimi për të ardhurat e përfituara, nuk gjen vend diskutimi i bashkëpronësisë së pasurisë, i pjesëve takuese apo i kontributit të dhënë për përfitimin e saj, për sa kohë që kanë gjetur zbatim dispozitat ligjore në fuqi lidhur me tatimin. Mbajtja e shumës 30.000 euro, deklaruar në vitin 2009 (pasi deri në vitin 2008 bashkëshortja ka deklaruar se të gjitha paratë i mbanin bashkë si familje), është gjeneruar nga një transaksion i vetëm, që është shitja e shtëpisë. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se raporti midis bashkëpronësisë dhe kontributit, për sa kohë që ajo nuk kundërshtohet, është vullnet i palëve dhe pranohet si i tillë, çka do të thotë se bashkëshortja e subjektit nuk e humb kontributin e saj, pavarësisht deklaramit të pjesës takuese 25 % në vitin 2005. Në këtë kuptim, kjo shumë përbën thjesht një ndarje brenda anëtarëve të familjes, për të cilën nuk ka asnjë arsye që të përcaktohen pjesët takuese. Nën këtë arsyetim, kjo shumë nuk përbën një të ardhur të tatueshme sipas pikës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), dhe pikës 2.3.9, të kapitullit 2.3, “Të ardhura të tatueshme”, të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), pasi shuma kryesore prej 220.000 eurosh, nga ku është shkëputur shuma 30.000 euro, është tatuar një herë dhe tatimi për herë të dytë, tërësisht apo pjesërisht, do të konsiderohej si problem me natyrë të theksuar diskriminimi nga zbatimi i ligjit në mënyrë të pabarabartë. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues gjen edhe mendimin e dhënë nga dy institucionet: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, të cilat kanë dhënë qëndrimin e tyre se një e ardhur e tatuar në burim nuk i nënshtrohet tatimit për herë të dytë.

Për sa ka argumentuar shumica e trupit gjykues sa më sipër, paraqes argumentet e mia për votën time kundër:

1. Dokumenti i pronësisë lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, i cili konfirmon regjistrimin e vilës së ndërtuar në Q., konfirmon si pronar të vetëm shtetasin A. K. . Po ashtu, edhe kartela e kësaj pasurie të paluajtshme, në seksionin C të saj, përcakton si pronar të vetëm shtetasin A. K. .

Në kontratën e shitblerjes me kusht nr. (***), datë 9.6.2008 të kësaj pasurie, si palë shitëse evidentohet vetëm shtetasi A. K. dhe jo të tjerë në cilësinë e bashkëpronarit.

Firmosja e shtetasve H., M. dhe F. K. në këtë kontratë shitblerjeje me kusht në rolin e dhënësit të pëlqimit, nuk i bën ata automatikisht bashkëpronarë në këtë pasuri. Në të tilla raste dhënia e pëlqimit nga personat e tjerë të trangu familjar për kryerjen e shitjes së pasurisë, kërkohet si garanci nga blerësi, që këta persona më vonë të mos kenë asnjë pretendim financiar apo të mos fillojnë ndonjë proces gjyqësor në lidhje me pasurinë ndaj blerësit.

Marrë për bazë argumentet si më sipër, të gjitha shumat monetare të përfituara nga shitja e vilës –që janë dhënë nga babai, A. K., dhe janë përfitur nga vajza e tij, M. K. – janë si më poshtë:

- 21.000 euro për mbylljen e kredisë;
- 60.000 euro për blerjen e apartamentit tek firma “U.”;
- 30.000 euro në momentin e shkëputjes nga trangu familjar.

Dhënia e këtyre shumave monetare mund të jetë bërë edhe në formë dhurimi (dhënia e shumës prej 30.000 eurosh nga babai te vajza e tij në momentin e shkëputjes nga trangu familjar), edhe në formë sponsorizimi, që në vetvete përbën edhe dhënien e shumës monetare pa kundërshpërblim për përballimin e shpenzimeve për qëllime të ndryshme (pagimi i shumës prej 21.000 eurosh për mbylljen e kredisë në “NBG” dhe pagesa e shumës prej 60.000 eurosh për blerjen e një apartamenti te shoqëria “U.” sh.p.k., ku në të dyja rastet pagesat i kryen babai dhe përfituese është e bija, bashkëshortja e subjektit).

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar), përcaktohet:

Neni 1

Objekti: *“Me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.”*

Neni 6

Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat personale: *“Tatimi mbi të ardhurat personale, që më poshtë do të quhen “të ardhura”, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.”*

Neni 8

E ardhura e tatueshme (ndryshuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007, Fletorja Zyrtare nr. 180, dhjetor 2007).

1. *Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:*

a) *pagat dhe shpërblimet e tjera [...]*

g) *të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.”*

Neni 8/1

Përfshihen nga tatimi mbi të ardhurat personale: (ndryshuar me ligjin nr. 177/2013, datë 28.12.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 203, datë 30.12.2013)

1. *Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.*

2. *Bursat e nxënësve dhe të studentëve.*

3. *Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.*

4. *Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike.*

5* *Shfuqizohet.*

6. *Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.*

7. *Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish të dënuarit politikë. (Ndryshuar me ligjin nr. 10072, datë 9.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 4.3.2009).*

8. *Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve. (Ndryshuar me ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 179, dhjetor 2010.)*

9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore.

10. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë. (Ndryshuar me ligjin nr. 122/2012, datë 20.12.2012, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 177, datë 9.1.2013.).

11. Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përfashtohen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet dhe procedurën që garanton mosndryshimin e destinacionit të tokës së blerë. (Ndryshuar me ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 76, datë 9.5.2013). (Ndryshuar me ligjin nr. 39/2018, datë 9.7.2018. botuar në Fletoren Zyrtare nr. 134, datë 18.9.2018).

12. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribuues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar.

13. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve, gjatë administrimit nga shoqëria administruese. (Ndryshuar me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24 dhjetor 2014).

e, për rrjedhojë, këto shuma monetare të dhëna nga babai të bijës përbëjnë në vetvete një të ardhur nëpërmjet një veprimi në formë dhurimi, sponsorizimi për shtetasen M. K. e, për rrjedhojë, nën dritën e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, që ato të konsiderohen të ardhura të ligjshme nga znj. M. K. duhet të ishin paguar detyrimet tatimore, veprim ky që në fakt nuk rezulton të jetë kryer.

Neni 9

Tarifat tatimore

1. Pagat dhe shpërblimet, në lidhje me marrëdhëniet e punës aktuale, do të taten sipas tarifave të përshkruara në pasqyrën nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huat, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, të ardhurat nga lojërat e fatit, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, taten me 15 për qind. (Ndryshuar me ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)

3. Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, taten me 8 për qind. (Ndryshuar me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 159, datë 3 dhjetor 2010). (Ndryshuar me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 183, datë 21.12.2018).

Neni 13

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave

1. Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale

vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë. [...]

4. Përjashtohen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2 000 000 (dy milionë) lekë.

Neni 13/1

Të dhënat që duhet të përmbajë deklaratat vjetore e të ardhurave

- 1. Deklarata vjetore e të ardhurave plotësohet nga tatimpaguesi që mbart detyrimin për të deklaruar, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji, dhe përmban të dhëna për të ardhurat bruto, për shpenzimet e zbritshme të kryera, si dhe për tatimet e paguara gjatë periudhës tatimore.*

Në udhëzimin nr. 5 datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i Ministrisë së Financave, përcaktohet si më poshtë:

2.3 TË ARDHURAT E TATUESHME

Në zbatim të nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:

[...] 2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g). Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jorezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh., individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional, si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra, nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit.

Nga baza ligjore e mësipërme, konstatohet fare qartë se kjo e ardhur bën pjesë në grupin e të ardhurave të parashikuara nga pika “g”, e nenit 8, e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në grupin e të ardhurave të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, kjo formë e ardhure nuk rezulton të jetë në një nga rastet e të ardhurave të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat, sikurse parashikon neni 8/1 i ligjit të mësipërm; neni 9 përcakton se edhe për të ardhurat e tjera paguhet tatimi në masën 15%; pika 4 e nenit 13 e këtij ligji përcakton qartë se detyrimin për plotësimin e dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave e kanë të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet, në shumën e përgjithshme dy milionë lekë e më shumë.

Në rast se shtetasen M. K. do ta konsiderojmë bashkëpronare në shtëpinë private me 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m², të ndodhur në Q., Tiranë, me argumentin se ajo ka dhënë pëlqimin për shitjen e saj në kontratën e shitblerjes me kusht të vitit 2008 dhe për faktin se ajo e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat e pasurisë në ILDKPKI, argumentoj si më poshtë:

Znj. M. K., në deklaratimet e bëra prej saj në ILDKPKI, ka deklaruar gjithmonë kuotën e pjesëmarrjes së saj në bashkëpronësi për ndërtesën dhe truallin, në masën 25 %.

Kjo do të thotë që edhe shuma monetare që i takon asaj të përfitojë nga shitja e kësaj pasurie i takon të jetë në masën 25 %, e cila, e përkthyer në vlerë monetare përbën 204.000 euro : 4 = 51.000 euro.

Marrë në konsideratë shumat monetare të vëna në dispozicion nga i ati, znj. M. K., që rezultojnë të jenë në shumën totale 111.000 euro, rezulton se ajo ka përfituar e vetme më shumë se gjysmën e vlerës *neto* të përfituar nga shitja e kësaj pasurie, në një kohë kur investimi i saj ka qenë në masën 25 %. Gjithashtu, ajo ka përfituar 60.000 euro më shumë përtej shumës prej 51.000 euro që është konvertimi në euro i kuotës së bashkëpronësisë së saj në shtëpinë private, i deklaruar nga vetë ajo në deklaratat e pasurisë në ILDKPKI, në masën prej 25 %.

Për sa më sipër, duke konsideruar shumën prej 60.000 eurosh, si një të ardhur për znj. M. K. – përtej apo më shumë se e ardhura prej 51.000 eurosh që asaj i takonte në raport me kuotën prej 25% të pjesëmarrjes nëpërmjet kontributit të saj në bashkëpronësi (shumë për të cilën supozojmë se është paguar një herë tatimi) – në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, që kjo shumë (60.000 euro) të konsiderohet e ardhur e ligjshme duhet të ishin paguar detyrimet tatimore nga znj M. K., veprim ky që në fakt nuk rezulton të jetë kryer.

Në përfundim, në lidhje me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, për subjektin dhe personin e lidhur me të:

Pasuria e llojit apartament banimi (*dupleks*) me sip. 205.33 m² dhe trualli me sip. 521.08 m², me adresë: Kompleksi Rezidencial “L.” (buzë plazhit të Gjirit të Lalzit), I., Durrës, blerë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***) , datë 4.6.2012, dhe shitur më pas përmes kontratës së shitjes nr. (***) , datë 20.8.2015; vlera e blerjes së apartamentit 82.132 euro; vlera e blerjes së truallit 956.457 lekë, ku subjekti zotëron 50%, rezulton e blerë me burime financiare jo të ligjshme financiare për arsye se:

- a) Rezulton mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 2.000.000 për blerjen e apartamentit në I, Sh, Lezhë në muajin janar të vitit 2010, për arsye se burimi financiar i ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, konkretisht nga shuma prej 2.900.000 lekësh e përfituar nga subjekti si rezultat i procedurave të divorcit me shtetasen A. Gj. (që me këtë veprim merr statusin e personit tjetër të lidhur), nuk identifikohet dhe nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratat e pasurisë;
- b) Për pasojë, shuma prej 35.000 eurosh, e përfituar nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 48.27 m², sipas kontratës nr. (***) , datë 27.5.2011, i ndodhur në Komunën Sh., Lezhë, dhe që ka shërbyer si burim financiar për blerjen e apartamenti të banimit (*dupleks*) i ndodhur në Gjirin e Lalzit, I., Durrës, nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm, përderisa vetë ajo shumë vjen nga një burim jo i ligjshëm financiar;
- c) Shuma prej 30.000 eurosh, deklaruar nga subjekti si burim financiar për blerjen e apartamentit të banimit në Gjirin e Lalzit, dhënë personit të lidhur me të, bashkëshortes së tij, nga babai i saj, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm të ardhurash, për sa kohë që nga përfituesi i saj, bashkëshortja e subjektit, nuk janë paguar detyrimet tatimore në lidhje me këtë përfitim monetar.
- d) Gjithashtu, edhe një pjesë e shumës prej 60.000 eurosh, sponsorizuar nga babai i personit të lidhur me subjektin për blerjen e një apartamenti për llogari të personi të lidhur te kompania “U.” sh.p.k., konkretisht shuma prej 30.000 eurosh, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm të ardhurash, për sa kohë që nga përfituesi i saj, bashkëshortja e subjektit, nuk janë paguar detyrimet tatimore në lidhje me këtë përfitim monetar.
- e) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit të banimit në Gjirin e Lalzit, Durrës.

II. Në lidhje me çështje të tjera të hetimit – mbi ekzistencën e konfliktit të interesit

Komisioni hetoi dhe mbi rrethanat që,, sipas ligjit, konsiderohen si konflikt interesi, duke kryer verifikime tek të dhënat nga sistemi elektronik i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për informacion mbi çdo proces që ka pasur kjo gjykatë, në të cilin të ketë qenë pjesëmarrës secili person fizik apo juridik që rezulton palë kontraktuese me subjektin e rivlerësimit apo me bashkëshorten e tij, apo me familjarë të tjerë të subjektit, babanë e këtij të fundit dhe bashkëshorten apo raste të tjera.

1. Nga verifikimet e kryera sipas pikës 2.21, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit, kishte gjykuar çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: shoqërinë “K.” sh.p.k., vendimi nr. (*) , datë 15.3.2017.**

2.2 Rezultoi se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë shtetasi Sh. K., administrator i shoqërisë “K.”, sh.p.k., ishte palë blerëse e apartamentit në pronësi të bashkëshortes, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 21.10.2015, në shumën 110.000 euro, të shlyera në llogarinë bankare të noteres.

2.3 Lidhur me këtë çështje, Komisioni kërkoi trajtim të rrethanave sipas ligjit të konflikt të interesit nga Institucionit i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Interesave, i cili pas trajtimit të rastit ka konkluduar se në lidhje me gjykimin dhe vendimmarrjen është vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

2.12 Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe të provave të depozituara në datën 16.4.2019, ndër të tjera ka argumentuar se:

2.12.1 Për procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K.” sh.p.k., ku administratori i saj rezultonte palë blerëse e apartamentit në pronësi të personit të lidhur, në kontratën noteriale nr. (***) , datë 21.10.2015, si një çështje e regjistruar në vitin 2016, e përfunduar me vendimin nr. (***) , datë 15.3.2017, subjekti ka parashtruar një analizë të fakteve dhe rrethanave në raport me dispozitat ligjore të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, “Për rastet për përjashtim të gjyqtarit”, duke arsyetuar se nga çështja në gjykim as subjekti dhe as ndonjë prej personave të lidhur me të nuk mund të kishin dhe as nuk kanë pasur realisht asnjë lloj interesi nga vendimmarrja në rastin konkret. Sipas nenit 72 (*i cili edhe pas ndryshimeve në kuadër të reformës në drejtësi është i pandryshuar në lidhje me nenin 72 të tij*), pika 3 e tij, ka parashikuar vetëm ekzistencën e marrëdhënieve të huas dhe të kredisë (*të cilat duhet të ekzistojnë në kohën e gjyimit të çështjes*) si shkak për mospjesëmarrje në gjykim. Ka parashtruar një analizë të fakteve për veprimin juridik kontratën nr. (***) , datë 21.10.2015, në të cilën janë përmbushur të gjitha detyrimet mes palëve në momentin e lidhjes së kontratës. Kjo pasuri ishte rivlerësuar në vitin 2011 bazuar në një aktekpertimi në një vlerë më të lartë se çmimi i referencës së zonës dhe po ashtu sikurse kishte rezultuar nga provat e hetimit administrativ dhe shkresa e ILDKPKI-së, blerësi e ka rishitur atë pas tre muajsh në shumën 120.000 euro. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës kontrata të ngjashme me çmime thuajse të përafërta, kontratën nr. (***) , datë 3.2.2016, kontratën nr. (***) , datë 7.10.2016, njoftimin për shitje në gazetën “Çelësi”, datë 3.6.2015, sipas të cilit apartamenti ishte njoftuar për shitje në shumën 111.300 euro, me çmim 1050 euro/m².

Në lidhje me themelin e çështjes subjekti ka parashtruar se Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. (***) , datë 15.3.2017, ka pranuar pjesërisht këtë padi, nëpërmjet një vendimi që rezulton praktikë e konsoliduar gjyqësore, duke depozituar 7 vendimet e nxjerra nga Gjykata e Lartë, si dhe nga Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt-padi të njëjtë si në rastin e çështjes me palë shoqërinë “K.” sh.p.k. Lidhur me qëndrimin e ILDKPKI-së subjekti ka shpjeguar se ky institucion nuk ka kompetencë për të gjykuar në lidhje me heqjen dorë nga gjykimi, si dhe mosmarrja në analizë të plotë e të gjitha provave dhe e

fakteve nga ana e tij, të disponuara përmes dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, kanë pasur si rezultat kalimin e plotë të kompetencave, si dhe konkluzione tërësisht të kundërligjshme.

2.30 Trupi gjykues, në vlerësim të të gjithë situatës në kuadër të hetimit të thelluar, dhe të shpjegimeve të subjektit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, arsyeton:

2.30.1 Në lidhje me procesin gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K.” sh.p.k., në konsideratë të fakteve: (i) se në kohën e gjykimit ka rezultuar përmbushja e të drejtave dhe e detyrimeve sipas kontratës noteriale nr. (***), datë 21.10.2015; (ii) se kjo pasuri ishte rivlerësuar dhe po ashtu ishte shitur pas tre muajve nga pala blerëse në një çmim më të lartë; (iii) se nga provat e paraqitura nga subjekti kontratat e ngjashme me çmime të përafërta tregojnë se nuk ka një çmim preferencial; (iv) se në lidhje me vendimmarrjen kjo gjykatë e ka pranuar pjesërisht këtë padi; (v) se provat e paraqitura nga subjekti, vendimet e Gjykatës e Lartë, si dhe Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt padie të njëjti, tregojnë se është mbajtur i njëjti qëndrim.

Për sa më sipër, në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje, trupi gjykues çmon se faktet e rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit.

Në lidhje me trajtimin e rrethanave sipas ligjit të konflikt të interesit, që kanë të bëjnë me procesin gjyqësor, ku njëra nga palët është shoqëria “K.” sh.p.k. me administrator. z. Sh. K. (i cili në datën 21.10.2015 ka blerë me kontratë shitblerjeje një apartament nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja M. K.), në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me relator subjektin e rivlerësimit, paraqes mendimin tim kundër për arsyet e mëposhtme:

Fillimisht e gjej me vend dhe të bazuar kërkesën e Komisionit drejtuar ILDKPKI-së për arsye se:

Në nenin 41, i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, citohet:

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave:

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin “Inspektorati i Lartë”.

Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.

Inspektorati i Lartë, me cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, kryen detyrat dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) drejtimin dhe përmirësimin e politikave dhe të mekanizmave të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave;

b) [...]

gj) verifikimin dhe hetimin administrativ të konfliktit rast për rast të interesave, si dhe të ndalimeve e kufizimeve të interesave të përcaktuar në kreun III të këtij ligji, me kërkesë të institucionit publik a epror, ose kur e gjykon të nevojshme edhe me nismën e tij.

Në nenin 1, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, citohet: “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Qëllimi i këtij ligji është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të*

konfliktit ndërmjet interesave publike dhe atyre privatë të një zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të veta”.

Në neni 3, të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. *“Konflikt i interesit”* është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

2. *“Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive”* është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

3. *“Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive”* është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.

Gjendemi pra, para një vendimmarrjeje gjyqësore të marrë në prani të interesave privatë të zyrtarit, një papajtueshmëri për këtë rast konkret, ndërmjet funksionit publik dhe interesit privat të zyrtarit/gjyqtar, sepse interesi privat i zyrtarit/gjyqtarit në fjalë, rezulton që ka ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësive të tij zyrtare.

Në pikën 1, *“Fusha e zbatimit”*, të nenit 4, përcaktohet:

1. *Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t’u zbatuar nga:*

a) *çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për:*

i) *[...]*

ii) *akte të organeve gjyqësore, noteriale [...]*

Krahas ligjit nr. 9367/2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, për sfera të ndryshme të vendimmarrjes publike, ligje të tjera specifike përcaktojnë lloje interesash, mënyra trajtimi dhe procedurat përkatëse të këtij trajtimi. Nuk duhet harruar që ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, ka fillimisht karakter parandalues dhe zgjidhjet që ofrohen prej tij duhet të zbatohen me mirëbesim nga të gjitha palët dhe në shërbim të realizimit të interesit publik.

Nga kontrata e sipërpërmendur e shitblerjes, konstatohet se personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, znj. M. K., ka pasur marrëdhënie juridiko-civile me natyrë pasurore-monetare me shtetasin Sh. K., i cili është edhe administrator i shoqërisë “K.” sh.p.k. Nëpërmjet kontratës së shitblerjes së datës 21.10.2015 ka lindur dhe është zhvilluar një interes privat, si për personin e lidhur me subjektin, znj. M. K., e cila nga kjo kontratë shitblerjeje ka përfituar shumën 110.000 euro, ashtu edhe për vetë subjektin e rivlerësimit, i cili, së bashku me personin e lidhur me të, e ka zhvilluar interesin pasuror familjar nëpërmjet investimit të shumës prej 110.000 eurosh për blerjen e një apartamenti tjetër në Tiranë me sip. 124.91 m², përkundrejt çmimit 177.370 euro.

Në nenin 5/1, të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, parashikohet se:

“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen me, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:

a) *të drejta dhe burime pasurore të çdo natyre;*

b) *[...];*

dh) marrëdhënie [...]”

duke u provuar kështu ekzistenca e interesit privat në këtë marrëdhënie juridiko-civile.

Në lidhje me ekzistencën ose jo të situatës së konfliktit të interesit për rastin konkret, marrë për bazë faktin se në kuptim të ligjit: *konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari në të cilën ai ka interesa privatë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe të përgjegjësisë të tij publike*, lind nevoja për një analizë të vendimit nr. (***) , datë 15.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në të cilin subjekti i rivlerësimit paraqitet në cilësinë e relatorit në trupin gjykues.

Fillimisht është e rëndësishme të theksojmë se problematika e shoqërisë “K.” sh.p.k. me administrator, z. Sh. K., ka filluar që në muajin nëntor të vitit 2009, për shkak të një urdhër-zhdëmtimi nr. (***) , datë 26.11.2009, nxjerrë nga ish-kryetari i Komunës P., në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja. Ky urdhër-zhdëmtim është shoqëruar më pas me aktin “Njoftim për shlyerje detyrimi”, me nr. (***) prot., datë 9.1.2015, të Bashkisë Kamëz.

Që me njohjen me aktin administrativ, për administratorin e shoqërisë, ka qenë më se e qartë se vetmja rrugë e mbetur për të kundërshtuar këtë akt ka qenë ngritja e padisë në Gjykatën Administrative. Më pas, pas 9 muajve, nga z. K. procedohet me blerjen e apartamentit nga znj. M. K., në datën 21.10.2015. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. (***) , datë 14.4.2016, ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësit shoqëria tregtare “K.” sh.p.k., kurse me vendimin nr. (***) , datë 15.3.2017, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me relator të trupit gjykues, subjektin e rivlerësimit, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. (***) , datë 14.4.2016, pranimin pjesërisht të padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. (***) , datë 26.11.2009, të Bashkisë Kamëz. [...]

Pra, konstatohet se problematika administrative e shoqërisë “K.” sh.p.k., me destinacion të vetëm zgjidhjeje kundërshtimit në Gjykatën Administrative, ka lindur përpara kryerjes së transaksionit me personin e lidhur me subjektin, për shitblerjen e apartamentit dhe është zgjidhur në favor të kësaj shoqërie pikërisht pas kryerjes së transaksionit, në një proces gjyqësor ku relator i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e të cilit dhe, më pas edhe vetë ai, kanë pasur interesa privatë pasurorë.

Për sa më sipër, marrja e një vendimi gjykate nga subjekti, në kushtet e ekzistencës së interesave privatë dhe, për më tepër, në favor të palës me të cilën lidhen interesat privatë, përbën një papajtueshmëri ndërmjet funksionit publik dhe interesit privat të zyrtarit, duke sjellë si pasojë ndodhjen e subjektit në kushtet e konfliktit faktik të interesit.

Subjekti duhet të kishte marrë masa parandaluese, duke u vetëpërgjashtuar paraprakisht nga procesi i vendimmarrjes, sikurse parashikohet në pikën 1/b, të nenit 37, të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Në nenin 72, “Rastet e përjashtimit e gjyqtarit”, të Kodit të Procedurës Civile, parashikohen rastet kur gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete, konkretisht kur:

1. Ka interes në çështje ose në një marrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim.

[...]

6. Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.

Në nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile, “Heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes”, përcaktohet se gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje dhe i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij.

Në lidhje me sa më sipër konstatohet se gjyqtari ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesave dhe të papajtueshmërisë së funksionit, për shkak të mosheqjes dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore, si dhe për shkak të dhënies së një vendimi në favor të palës me të cilën subjekti ka marrëdhënie juridiko-civile me karakter pasuror.

2. Në vijim të hetimit për rrethana të mundshme të konfliktit të interesit Komisioni, nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit, verifikoi të gjitha çështjet e gjykuara me institucionin në të cilin bashkëshortja e subjektit kishte mbajtur dhe mban funksion, duke i kategorizuar sipas funksionit të saj dhe pozicionit¹⁰⁷ të subjektit në këto çështje (reflektuar në detaje sipas Aneksit nr. 1, në rezultatet e hetimit):

- Çështje me palë Komisionin për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore (ku bashkëshortja, në cilësinë e drejtoreshës së Apelimit Tatimor, nga viti 2017 dhe aktualisht, është anëtare *de jure*), ku, sipas të dhënave të faqes *online* të gjykatës, subjekti shfaqej si relator i çështjes; ose ku përbërja e trupit gjykues nuk reflektohej dhe nuk ishte e qartë nëse kishte marrë pjesë në gjykim; nr. rendor 1-11, të Aneksit nr. 1.
- Çështje me palë Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë ku subjekti shfaqej në cilësinë e relatorit, me fokus: (a) akte të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve në kohën kur bashkëshortja kishte qenë drejtoreshë e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (viti 2013 dhe 2015); (b) vendime të gjykatës në kohën kur kjo drejtori drejtohej nga bashkëshortja e subjektit; nr. rendor 11-16, të Aneksit nr. 1.
- Çështje me palë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi akte që ishin nxjerrë në kohën kur bashkëshortja ka pasur funksionin e Zëvendësdrejtore të Përgjithshme të kësaj drejtorie (periudha 2010 – tetor 2013); nr. rendor 17-30, të Aneksit nr. 1.

Duke mos përsëritur shpjegimet dhe konkluzionet e dhëna si nga shumica e trupit gjykues, ashtu edhe nga subjekti i rivlerësimit, çka janë pasqyruar në vendim, jam kundër konkluzionit përfundimtar të shumicës së trupit gjykues se **subjekti i rivlerësimit ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmërinë në gjykim, duke arsyetuar si më poshtë:**

Fillimisht është e rëndësishme të specifikojmë se në bazë të shkresës nr. (***) prot., datë 9.5.2019, personi i lidhur me subjektin, znj. M. K., veç të tjerash ka ushtruar detyrat:

- i) periudha 18.9.2007 – 24.1.2008, emëruar përkohësisht në pozicionin kryetare në Degën e Tatimeve Tiranë;
- ii) periudha 18.2.2008 – 13.7.2009, drejtoreshë e Drejtorisë së Apelimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- iii) periudha 19.3.2010 – 10.10.2013, Zëvendësdrejtore e Përgjithshme e Procedurave dhe e Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Në Aneksin 1 të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, dërguar subjektit të rivlerësimit, janë listuar një sërë subjektesh tregtare, të cilat, si pasojë e procedurave tatimore i janë

¹⁰⁷ Referenca i është përmbytur të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

nënshtuar proceseve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku pjesë e trupit gjyqësor, në cilësinë e kryesuesit/relatorit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit.

Gjatë periudhës që personi i lidhur me subjektin, znj. M. K., ka ushtruar detyrën e kryetares së Degës së Tatimeve Tiranë, subjektet tregtare:

1. “G.” sh.p.k., me NITP (***) (administratore znj. R. G.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
2. “Sh. I.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. Sh. C.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
3. “L.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. S. L.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
4. “K.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. Sh. K.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
5. “A.-R.” sh.p.k., me NIPT (***) (administratore znj. R. K.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
6. “R.L.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. Xh. L.), krijuar në datën 1.2.2008.
7. “C.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. A. K.), periudha shtator 2007 – janar 2008, rezulton aktiv.
8. “D. & S. T.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. A. I.), krijuar në datën 4.12.2008.
9. “A.G.”, me NIPT (***) (administrator z. B. A.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
10. “A.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. Gj. N.), krijuar në datën 31.3.2010.
11. “G. I M.” (shoqëri kursim-kredi), me NIPT (***) (anëtar bordi z. M. B., z. Z. P., z. F. Q., z. E. M., znj. R. B.), krijuar në datën 29.10.2008 (pezulluar në datën 23.5.2016).
12. “A.” sh.p.k., me NIPT K49701305B (administrator z. A. F.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
13. “K.” sh.a., me NIPT (***) (aksioner z. I. B.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
14. “F.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. H. H.), periudha shtator 2007 – janar 2008.
15. “E. A.” sh.p.k., me NIPT (***) (administrator z. N.T.), periudha shtator 2007 – janar 2008

rezultojnë me status aktiv, çka do të thotë se kanë qenë në rrezën e ushtrimit të veprimtarisë të Degës së Tatimeve Tiranë, drejtuese e së cilës ka qenë znj. M. K.. Pra, veprimtaria e këtyre subjekteve tregtare ka qenë objekt kontrolli dhe verifikimi nga kjo drejtori. Kjo do të thotë se znj. M. K., në cilësinë e drejtuesit të këtij institucioni, ka pasur kontakte direkte apo indirekte me këto subjekte tregtare.

Një ndër detyrat e Departamentit të Procedurave dhe Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, që është drejtuar nga znj. M. K., ka qenë edhe administrimi i *database*-s me të dhënat e subjekteve tregtare, duke siguruar një informacion të plotë dhe të saktë mbi tatimpaguesit, duke krijuar kushtet për të rritur efektivitetin, eficientën dhe transparencën e punës së administratës tatimore. Edhe në këtë pozicion pune, znj. K.ka qenë në kontakt direkt apo indirekt me të dhënat në lidhje me veprimtarinë ekonomiko-tregtare të subjekteve të ndryshme tregtare.

Trajtimi i konfliktit të interesit

Përcaktimi i ekzistencës së konfliktit të interesit kërkon të analizohen nëse, për shkak të lidhjeve familjare, njëri nga zyrtarët mund të bierë në konflikt, rast për rast të interesit, qoftë edhe në dukje.

Shfaqja e konfliktit të interesit mund të ndodhë në një numër rastesh të vendimmarrjes së tij të drejtpërdrejtë, për shkak të lidhjes familjare, mund të marrë vendime preferenciale etj.

Por, edhe sikur këto të mos ndodhin, pra, vendimmarrjet e drejtpërdrejta, zyrtari do të ishte të paktën në konflikt në dukje të interesit.

Në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **“Konflikt i interesit”** është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Neni 3/ pika 4

Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) “konflikti faktik i interesit”, është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit, ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij zyrtare;

b) **“konflikt në dukje i interesit”** është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

c) **“konflikti i mundshëm i interesit”** është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit, mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;

ç) “konflikti rast pas rasti i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të vëçantë.

Në lidhje me konceptin e konfliktit rast për rast të interesit duhet të përqendrohemi në dy çështje kryesore:

Së pari, duhet të kemi shfaqjen e një konflikti interesi në formën e konfliktit faktik, **në dukje** apo të mundshëm. Për këtë qëllim, është e nevojshme t’i referohemi konceptit të konfliktit të interesit dhe këtyre tre llojeve të veçanta të tij.

Së dyti, konflikti rast për rast është i lidhur me një apo disa vendimmarrje të veçanta, pra, me fjalë të tjera, rënia në konflikt interesi, mundësia e rënies në të ardhmen apo **edhe dukja e rënies në konflikt interesi** do të gjykohet në bazë të një vendimmarrjeje konkrete dhe rolit të zyrtarit në këtë vendimmarrje.

Sipas nenit 6 të ligjit 9367/ 2005, i ndryshuar, është një detyrim i çdo zyrtari, në çfarëdo lloj detyre që nga niveli më i ulët dhe për çfarëdo lloj interesi që mund të bëhet shkak për të parandaluar dhe zgjidhur çdo konflikt rast për rast të interesave. Ky është njëkohësisht detyrim i çdo eprori.

Për të arritur në përfundimin, nëse ekziston ose jo një konflikt rast për rast i interesit, sipas “Manualit shpjegues dhe trajnimi mbi parandalimin e konfliktit të interesave nr. 1”, botuar në dhjetor 2006, i publikuar në faqen online të ILDKPKI-së, www.hidaa.gov.al, ndiqen hapat e mëposhtëm metodologjikë:

1. Cilat janë detyrat dhe kompetencat konkrete e të detajuara të zyrtarit në fjalë?
2. A ka ai kompetencë thelbësore e përcaktuese në vendimmarrjen për nxjerrjen e akteve normative dhe/ose individuale konkrete?
3. Cila është sfera (hapësira, fusha) e ndikimit të këtij akti?
4. Sa i fortë është ndikimi i këtij akti në këtë sferë?
5. Cilat janë interesat private të zyrtarit në fjalë?
6. Çfarë mundësisht ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?

7. Çfarë mundësisish ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?

8. A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetëm për të, një vendimmarrje e padrejtë?

Edhe nëse nga përgjigjet që do t'u jepen pyetjeve metodologjike të mësipërme 1-8, do të arrihej në përfundimin se nuk ka gjasa që të shfaqet një konflikt faktik apo i mundshëm në një rast të dhënë e konkret vendimmarrjeje, kjo nuk do të thotë se analiza ka përfunduar.

(i) Në këtë rast, analiza duhet të vazhdojë për të parë nëse rrezikojmë të na shfaqet **një konflikt i llojit në dukje të interesit**. Për këtë qëllim, pyetjet 6 deri në 8 duhet të ribëhen jo më nga këndvështrimi i mundësisë së analizuar nga vetë zyrtari ose eprori, por nga këndvështrimi i një perceptimi të mundshëm të publikut.

(ii) Me fjalë të tjera, zyrtari ose eprori që analizon këtë rast duhet ta vendosë veten në pozicionin e një individi çfarëdo nga publiku, normalisht të informuar dhe të arsyeshëm dhe t'i bëjë vetes pyetjen e mëposhtme:

9. A do të kishte ai (individi nga publiku) besim në vendimmarrjen e zyrtarit në fjalë, nëse do të kishte dijeni për interesat privatë dhe ndërthurjen e tyre me detyrën e tij?

Në rast se nga analiza e mësipërme, pasi i japim përgjigje pozitive se ka të ngjarë që të na shfaqet qoftë edhe një rast i konfliktit rast për rast të interesit, bëhet e nevojshme që të analizojmë nëse kjo shfaqje **do të ishte e shpeshtë apo e përsëritur**, e tillë që do të komprometonte vetë kuptimin e kryerjes së atyre detyrave e të ushtrimit të kompetencave nga ky zyrtar.

Në rastin konkret:

- a) ekziston lidhja familjare (burrë – grua) ndërmjet zyrtarit dhe një punonjësi të administratës tatimore, institucion që rezulton të jetë palë ndërgjyqëse, në të cilën zyrtari rezulton të jetë pjesë e trupit gjyqësor;
- b) bashkëshortja e subjektit rezulton të ketë kontakte të drejtpërdrejta apo të tërthorta si dhe akses në të dhënat e subjekteve të ndryshme tregtare, për shkak të pozicioneve të saj të punës në administratën tatimore;
- c) personi i lidhur me subjektin, duke qenë e emëruar në pozicione të larta, padyshim që ka rol aktiv në marrjen e vendimeve madhore, që kanë të bëjnë me përcaktimin e strategjive dhe objektivave në veprimtarinë e institucionit që kanë të bëjnë në mënyrë direkte me veprimtarinë e subjekteve ekonomiko-tregtare.

Për sa më sipër, konflikti rast për rast i interesave mund të shfaqet te çdo zyrtar i çfarëdo niveli, qoftë edhe të ulët dhe për lloje nga më të ndryshme të interesave, për rrjedhojë, çdo zyrtar dhe çdo epror i tij duhet të analizojë çështjen sipas mënyrës së sugjeruar më sipër dhe të marrë çdo masë të përshtatshme të parashikuar nga ligji **për të parandaluar konfliktin, qoftë ky dhe konflikt në dukje i interesit, si një nga format e konfliktit rast për rast të interesit**.

Vetë subjekti/zyrtari duhet të deklarojë interesin, nëse mendon se për shkak të tij mund të bjerë në konflikt dhe, kur është i bindur për mundësinë e ndodhjes në konflikt, të shmanget nga pjesëmarrja në vendimmarrje.

Për pasojë, në çdo proces gjyqësor, në të cilin njëra nga palët është institucioni ku personi i lidhur me subjektin punon, pavarësisht faktit nëse personi i lidhur ka kontakte direkte apo indirekte me subjektet tregtare që janë palë në proces, pavarësisht nëse në këtë proces gjyqësor janë ankimuar akte që mund të mos jenë firmosur nga ajo,

vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është tërësisht e paragjykuar, si në sytë e palës tjetër ndërgjygjëse, ashtu edhe në sytë e publikut, sepse për shkak të lidhjeve familjare me subjektin duket sikur do të anojë nga krahu i palës ndërgjygjëse, në të cilën rezultoi të jetë e punësuar personi i lidhur me subjektin, duke sjellë si pasojë ekzistencën e konfliktit në dukje të interesit për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë zhvilluar procese gjyqësore dhe të ketë marrë vendime në situatën e konfliktit faktik dhe atij në dukje të interesit, në mënyrë të vazhdueshme, duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut të drejtësia.

III. Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Shumica e trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Lidhur me kriterin e pasurisë nën hetimin e thelluar e të gjithanshëm të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë;
- Për kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues në konsideratë të verifikimit dhe konfirmimit nga institucioneve përgjegjëse, për përshtatshmëri në detyrë, edhe pas hetimit të thelluar, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Kastriot Selita, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- Për kriterin profesional, çmon se subjekti ka përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Për këto arsye, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në bazë të germës “a”, pikës 1, të nenit 58, si dhe pika 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” trupi gjykues ka vendosur:

6. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në lidhje me këtë konkluzion dhe me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, duke marrë në konsideratë edhe arsyetimin dhe konkluzionet e mia në lidhje me kriterin e pasurisë dhe atë profesional, konkretisht: për mungesë burimesh financiare të ligjshme dhe balancë financiare negative në vitet kur janë krijuar këto burime, si dhe kur janë kryer investimet me këto burime financiare, si dhe për cenimin e besimit të publikut për shkak të gjykimit në kushtet e konfliktit faktik dhe atij në dukje të interesit, jap votën time kundër, duke votuar për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, me detyrë gjyqtar/kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në bazë të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

ANËTAR/KUNDËR

Olsi KOMICI